



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

“Performanca e Shërbimit të Paraburgimit”



PËRMBAJTJA

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	4
1.1 Konteksti i Problemit Social	4
1.2 Rëndësia e Auditimit të Performancës	6
2. SUBJEKTET NËN AUDITIM.....	6
2.1 Hyrje në Subjektet nën Auditim.....	6
2.2 Baza Ligjore dhe Kriteret që Rregullojnë Çështjen nën Auditim	7
2.3 Rëndësia e Produkteve të Subjektit.....	10
2.4 Peshë në Buxhet	10
2.5 Feedback-u i subjekteve përgjatë auditimit.....	13
3. DETAJET E AUDITIMIT	13
3.1 Vlerësimi i Risqeve të Aktiviteteve të Subjektit	13
3.2 Objektivi i Auditimit	15
3.3 Pyetjet e Auditimit	16
3.4 Fushëveprimi i Auditimit	17
4. SHITJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT	17
4.1.1.1 A është hartuar kuadri ligjor dhe rregullator i nevojshëm me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të personave të paraburgosur?	17
4.1.1.2 A kanë qenë burimet financiare të mjaftueshme, me qëllim sigurimin e kushteve infrastrukturore të nevojshme për personat e paraburgosur?.....	32
4.1.2.1 A ka qenë DPB dhe IEVP-të efektive në mirëadministrimin e sistemit penitenciar?	38
4.1.2.2 A ka bashkëvepruar DPB dhe IEVP-të në mënyrë integrale me DPP/DVP-të dhe aktorë të tjerë të përfshirë në proces, në funksion të garantimit të të drejtave për personat e paraburgosur?	55
5. PËRMBLEDHJA	61
6. SHTOJCAT	64
Shtojca nr. 1	64
Shtojca nr. 2	65

✂ LISTA E SHKURTIMEVE

BE	Bashkim European
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
GJEDNJ	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
GJK	Gjykata Kushtetuese
IEVP	Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
KBGJL	Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë
KE	Komisioni European
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KPT	Komiteti European për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtërues
MD	Ministria e Drejtësisë
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VUGJL	Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i Problemit Social

E drejta për liri dhe siguri, si edhe të drejtat e personave të ndaluar dhe të arrestuar, në pritje të një vendimi gjyqësor, parashikohen në një sërë aktesh ndërkombëtare, si: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të drejtat Civile dhe Politike, Rregullat Minimum Standarde për Trajtimin e të Burgosurve, Rregullat Minimum Standarde mbi Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (*Rregullat Beijing*), Konventa Europiane për të Drejtat të Njeriut dhe Liritë Themelore, etj..


E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut u akordon personave të dyshuar/akuzuar për vepra penale një mbrojtje të veçantë ku, ndër të tjera, ata duhet të gëzojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të prezumohen të pafajshëm, të mbrohen nga tortura, trajtimi mizor, çnjerëzor apo degradues, të kenë mbrojtje të barabartë nga ligji, si edhe të gëzojnë mbrojtje nga ndalimi apo arrestimi arbitrar. Sipas nenit 3 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, kushdo gëzon të drejtën e jetës, lirisë dhe sigurisë personale. Liria dhe siguria personale garantohet edhe nga neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe nga neni 9 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDKP).

Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në këtë nen dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj. Ndër të tjera, kufizimi i lirisë parashikohet kur personi është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale, ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale, ose të largohet pas kryerjes së saj. Sipas Komitetit të të Drejtave të Njeriut, kufizimi i lirisë me arrestim duhet të përmbushë kushtet e ligjshmërisë, arsyetueshmërisë dhe domosdoshmërisë.

Sa kaq, masat e sigurisë parashikohen në Kodin e Procedurës Penale dhe jepen sipas rrezikshmërisë së veprës penale, duke u udhëhequr nga parimi që masa e sigurisë **“arrest me burg”** të përdoret si masa më ekstreme (*ultima ratio*) dhe vetëm në rast se është kryer një vepër penale, që përbën rrezikshmëri të lartë shoqërore, i dyshuari rrezikon të largohet nga vendi për ti shpëtuar gjyqimit, mund të ndërhyjë në organet gjyqësore, ose rrezikon të kryejë një krim tjetër.


Bazuar në të dhënat statistikore të vëna në dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se trendi i të paraburgosurve në vendin tonë është në rritje, krahasuar me të dënuarit me burgim. Aktualisht, deri më datë 07.08.2022 numri i grave në regjim është **67** (30 të dënuara dhe 37 të paraburgosura), numri i të miturve në regjim është **13** (3 të dënuar dhe 10 të paraburgosur) dhe numri i të burgosurve në regjim është **5006**, prej të cilëve **2251** të dënuar dhe **2755** të paraburgosur, ilustruar si mëposhtë.

Infografik nr.1: Përqindja ndaj totalit dhe raporti ndërmjet numrit të të burgosurve me atë të paraburgosurve



Burimi: DPB/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Infografik nr. 2: Përdorimi i kapaciteteve të IEPV-ve, në total të paraburgosur të rritur, të paraburgosura dhe të paraburgosur të mitur



Burimi: DPB/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Përdorimi i zgjeruar i masës së sigurisë **“arrest me burg”** shpesh është një simptomë e mosfunksionimit të sistemit të drejtësisë penale, e cila riskon mbrojtjen e të drejtave të të paraburgosurve. Kjo për shkak se, mund të sjellë trajtimin e tyre çnjerëzor dhe degradues, si rezultat i kushteve të dobëta infrastrukturore që kanë një pjesë e IEPV-ve dhe si rezultat i kapaciteteve të kufizuara për akomodimin e këtyre shtetasve, duke krijuar në jo pak raste mbipopullim shqetësues.¹ Dispozitat procedurale të Kodit të Procedurës Penale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale dhe të hetimit. Bazuar në këto dispozita **“i pandehuri”** prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.² Prezumimi i pafajësisë nënkupton të drejtën e një personi të dyshuar për kryerjen e një veprë penale, për të mos u konsideruar fajtor para se të deklarohet si i tillë me vendim gjyqësor të formës së prerë. Qëllimi i ligjvënësit në këtë rast ka qenë krijimi i një burimi mbrojtjeje të dyfishtë për personin e pandehur, pasi ky parim çliron të akuzuarin nga barra e provës së pafajësisë së tij dhe nga ana tjetër detyron gjykatën që çdo dyshim ta çmojë dhe ta vlerësojë në favor të të dyshuarit.

Nga sa më sipër, të paraburgosurit duhet të trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat procedurale dhe njerëzore të tyre. Monitorimet e kryera nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Avokati i Popullit³ lidhur me sistemin e paraburgimit në vendin tonë evidentojnë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të ndaluar, arrestuar në flagrancë dhe të paraburgosur në sistemin e burgjeve, të tilla si keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit në flagrancë, të ndalimit, të shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje në organet e policisë (në disa raste në mungesë të avokatit), mosnjohje me të drejtat dhe garancitë ligjore, tejkalim i afateve ligjore të ndalimit/arrestimit në flagrancë deri në kontrollin e tyre nga gjykata, etj. Po kështu, edhe në arenën ndërkombëtare, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut pranon gjithashtu një numër gjithnjë në rritje të ankesave nga të burgosurit që pretendojnë se po mbahen në kushte çnjerëzore ose degraduese, duke u dashur të ndajnë qelitë me numër të madh të të burgosurve të tjerë, çka u lë atyre shumë pak hapësirë banimi.

Në përfundim, DPB dhe IEPV-të duhet të mundësojnë nëpërmjet veprimtarisë së tyre institucionale krijimin e kushteve të duhura për implementimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, duke siguruar kështu një trajtim njerëzor të personave me liri të kufizuar.

¹ KPT-ja thekson se, për individin, paraburgimi mund të ketë efekte të rënda psikologjike. Niveli i vetëvrasjeve midis të ndaluarve në paraburgim mund të jetë disa herë më i lartë se ndërmjet të burgosurve të dënuar, referuar Statistikave Vjetore Penale të Këshillit të Evropës;

² Parimi i Prezumimit të Pafajësisë, neni 4 i KPP;

³ Raportet e Avokatit të Popullit dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit 2019-2022;

1.2 Rëndësia e Auditimit të Performancës

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare po veprojnë në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka vendosur auditimin e performancës si një nga shtyllat moderne të zhvillimit institucional. Në Planin Strategjik 2018-2022, KLSH e ndërton misionin e vet si institucion i pavarur kushtetues, duke qenë partner strategjik i Kuvendit, i qytetarit shqiptar dhe palëve të interesit, duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Synimi i KLSH-së në auditimin e performancës është përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit në shërbimet publike që i ofrohen taksapaguesit shqiptar, duke ekonomizuar njëkohësisht përdorimin e fondeve publike. Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet, nga pushteti qendror dhe lokal e nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me direktivat e praktikave me të mira të BE-së dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, duke kontribuar kështu në mirë qeverisje.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në Subjektet nën Auditim

Në kuadër të vlerësimit të zbatimit të politikave dhe ofrimit të shërbimeve të paraburgimit, grupi i auditimit vendosi të përfshijë si subjekte nën auditim:

- Ministrinë e Drejtësisë;
- Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucionet e Paraburgimit; si dhe
- Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe Drejtoritë Vendore të Policisë.

Nga sa më sipër, **Ministria e Drejtësisë** në përmbushje të detyrimeve të diktuar nga kushtetuta dhe aktet ligjore në fuqi ndjek dhe përgjigjet për realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë, si dhe harton projektet e akteve ligjore e nënligjore në fushën e drejtësisë.

Ndërkohë që, **Policia e Shtetit** luan një rol mjaft të rëndësishëm në një shtet demokratik, për shkak se është përgjegjëse për garantimin e sigurisë dhe rendit publik. Ky funksion i saj duhet të udhëhiqet nga parimet e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Që prej vitit 2007, sistemi i paraburgimit ka kaluar në administrim të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Më herët ky sektor ka qenë nën administrimin e Ministrisë së Brendshme. Shpërndarja e të paraburgosurve në Institucionet e Paraburgimit bëhet vetëm sipas juridiksionit penal. **Institucionet penitenciare (IEVP-të)**⁴ kanë për mision krijimin e kushteve të duhura për mbajtjen dhe trajtimin e personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale, ose të dënuar nga gjykata për këtë arsye, me qëllim që të mundësohet dhënia e drejtësisë për ta, ose rehabilitimi shoqëror, në përputhje me rregullimet legjislative në fuqi. Institucionet e paraburgimit janë në varësi të **Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve**, e cila është përgjegjëse për forcimin e sistemit të burgjeve dhe rritjen profesionale të stafit, duke i motivuar për të kryer një shërbim sa më të mirë, gjë e cila ndikon në rritjen e sigurisë në shoqëri dhe ka efekte pozitive në mbarëvajtjen e punës së institucionit.⁵


⁴ Në të cilat përfshihen edhe institucionet e paraburgimit;

⁵ <https://dpbsh.gov.al/misioni/>;

Institucionet e paraburgimit janë institucionet, ku mbahen individët, ndaj të cilëve është dhënë nga gjykata masa e sigurimit “arrest në burg”. Në territorin e RSH ka 17 institucione paraburgimi,⁶ të cilat ndodhen në IEVP, përkatësisht:

1. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale në rrugën “Ali Demi”;
2. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fushë Krujë;
3. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel;
4. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tepelenë;
5. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin;
6. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë;
7. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë;
8. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Jordan Misja”, Tiranë;
9. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Mine Peza”, Tiranë;
10. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë;
11. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës;
12. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë;
13. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fier;
14. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Berat;
15. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës;
16. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan; dhe
17. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Malësi e Madhe (Reç).

Infografik nr.3: Skema për institucionet qendrore dhe atyre të varësisë



Burimi: Grupi i Auditimit

2.2 Baza Ligjore dhe Kriteret që Rregullojnë Çështjen nën Auditim

Burimet e kriterëve të politikës

- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, ndryshuar me Protokollet nr. 11, 14, 15 dhe shoqëruar nga Protokollet nr. 1, 4, 6, 7, 12, 13, 16;
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga asambleja e përgjithshme me rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966;

⁶ Nëpërmjet Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr. 551, datë 10.10.2022 IEVP Tropojë dhe Sarandë, të cilat ofronin edhe shërbim paraburgimi janë mbyllur;

- Rregullat e Pekinit – Version OSBE (Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Të Miturve, të cilëve u është hequr liria Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, datë 14 dhjetor 1990);
- Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese.
- VKM nr. 823, datë 24.12.2021 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit”.

Burimet e kriterëve të monitorimit dhe raportimit

- Raport për të Drejtat e Njeriut – Shqipëria, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE);
- Raport - Të Drejtat e Njeriut në Mjediset e Privimit të Lirisë përgjatë Pandemisë Covid-19 – Rasti i Shqipërisë, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE);
- Raport monitorimi mbi situatën e respektimit të të drejtave dhe lirive të personave të ndaluar, shoqëruar dhe arrestuar në Komisaritet e Policisë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit;
- Raport i Avokatit të Popullit (AP) drejtuar DPB-së – 2021;
- Raport i AP mbi sistemin e Paraburgimeve në Shqipëri 2021;
- Raport i AP mbi sistemin e Paraburgimeve në Shqipëri 2020;
- Raport i AP mbi paraburgimin në Shqipëri -2019;
- Raport i AP drejtuar DPB-së – 2019;
- Raporte të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (DPP) lidhur me zbatimin e rregullave dhe procedurave standarde, për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, në ambientet e njëjësive vendore të policisë;
- Raporti i Komitetit të CPT-së, për respektimin dhe garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, në ambientet e Policisë së Shtetit;
- Raporte të AP për shoqërimin e personave, respektimin dhe garantimin e të drejtave të tyre në ambientet e Policisë së Shtetit, në bazë dhe për zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Raporte të AP për transferimin dhe dorëzimin në IEVP të arrestuarve/ndaluarve me masën e sigurisë “arrest me burg” që sigurohen dhe trajtohen në institucionet e specializuara mjekësore;
- Raporte të AP për respektimin dhe garantimin në praktikë të të drejtës për mbrojtjen me avokat të shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar;
- Raporte të Komitetit të Helsinkit në fushën e sistemit penitenciar dhe gjendjen e IEVP-ve 2019-2021;
- Raportet e Vlerësimit të Performancës nga DPP për DVP-të dhe Komisaritet në varësi, lidhur me zbatimin e procedurave standarde të punës për trajtimin dhe sigurimin e personave të shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar në ambientet e Policisë së Shtetit.

Burimet e kriterëve teknike

- Ligji nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;
- Ligj nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;
- Ligj nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i azhurnuar me ndryshimet e ligjit nr. 133/2020;
- VKM nr. 606, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”;
- VKM nr. 280, datë 29.4.2022 “Për përcaktimin e rregullave dhe kriterëve të detajuara për kushtet teknike, sigurinë, përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë nga personat me aftësi të kufizuara, që duhet të plotësojnë ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”;
- Rregullore e Përgjithshme e Burgjeve;
- Urdhër nr. 116, datë 30.03.2022 i Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”;

- Urdhër nr. 925, datë 18.07. 2019 “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”;
- Urdhër nr. 1010, datë 14.08.2019 i DPP-së “Për ndalimin e mbajtjes dhe trajtimit të personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar në ambiente/dhoma që janë me sipërfaqe dhe kubaturë të pamjaftueshme dhe që nuk plotësojnë kushtet e kërkuara;
- Urdhër nr. 171, datë 10.02.2020 i DPP-së Për vënien në funksion të dhomave të sigurisë, në Komisaratin e Policisë Tropojë, në D.V.P Kukës;
- Urdhër nr. 811, datë 31.08.2021 i DPP-së Për vënien në funksion të dhomave të sigurisë, në Komisaratin e Policisë Shkodër, në D.V.P Shkodër;
- Urdhër nr. 341, datë 29.03.2022 i DPP-së Për mbylljen e mosfunksionimit të dhomave të sigurisë në Komisaratin e Policisë nr. 5, në D.V.P Tiranë;
- Urdhër nr. 90 datë 09.03.2020 “Ngritjen e strukturës së posaçme për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e emergjencave dhe mbrojtjes civile”;
- Urdhër nr. 91 datë 09.03.2020 “Marrjen e masave në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për parandalim të përhapjes së Covid-19”;
- Urdhër nr. 92, datë 09.03.2020 “Marrjen e masave në DPB dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për parandalimin e përhapjes së Covid-19”;
- Urdhër nr. 96, datë 10.03.2020 “Për ngritjen e Task Forcës për përballimin e situatës së krijuar nga virusi Covid-19”, I ndryshuar;
- Urdhër nr. 99, datë 14.03.2020 “Për marrjen e masave të menjëhershme për ngritjen e infrastrukturës në nivel karantine, me qëllim trajtimin e rasteve të dyshuara me Covid-19 në Qendrën Spitalore të Burgjeve”;
- Udhëzim nr. 6, datë 19.03.2020 “Për marrjen e masave për shërbimin e karantinës me qëllim trajtimin e rasteve të dyshuara me Covid -19, në Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”;
- Urdhër nr. 372, datë 11.06.2021 ndryshuar me Urdhër nr. 372/1, datë 08.07.2021 “Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid -19 në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”.

Burimet e kriterëve të tjera/ Praktikave më të mira

- Rregullat Europiane të Burgut, të miratuara nga Komiteti i Ministrave të Shteteve që janë anëtarë të Këshillit të Europës
- <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>;
- Direktiva e BE 2016/343 “Në forcimin e disa aspekteve të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim gjatë një procedimi penal”;
- Raport Auditimi Performance i SAI-t të Britanisë së Madhe “Një auditim mbi kushtet dhe programet e institucioneve të paraburgimit për të rritur”
https://www.bcauditor.com/sites/default/files/OAGBC_Adult-Custody-Division_RPT.pdf;
- Raport Auditimi Performance i SAI-t Suedez “Eficienca në sistemin suedez të burgjeve dhe institucionet e paraburgimit”
<https://www.riksrevisionen.se/en/audit-reports/audit-reports/2020/efficiency-at-swedish-prison-and-probation-service-prisons.html>.
- Jurisprudencë e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut:
 - Çështja “Minelli kundër Zvicrës”, “Telfner kundër Austrisë”, 20.06.2001;
 - Çështja “Maslarova kundër Bullgarisë”, 31.01.2019; dhe
 - Përmbledhje e Vendimeve të GJEDNJ lidhur me të drejtat e lidhura me shëndetin mendor
https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Prisoners_health_SQL.pdf.
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4 datë 27.02.2004, nr. 9, datë 28.04.2004 dhe nr. 19, datë 18.09.2008.

2.3 Rëndësia e Produkteve të Subjektit

“Vritet faji, jo njeriu”

Të drejtat e të paraburgosurve parashikohen në Ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Akti ligjor i cituar nuk bën asnjë diferencim ndërmjet kategorive “i dënuar” dhe “i paraburgosur”, sa i përket programeve individuale të trajtimit, punësimit, procedurave disiplinore etj.

Përveç të drejtave të karakterit procedural, personat e paraburgosur gëzojnë të drejta si: e drejta e ushtrimit të votës, nëse nuk janë akuzuar për një vepër të parashikuar nga Ligji nr. 138/2015 (dekriminalizimit); e drejta e vizitave nga familjarët; të drejta të trajtimit në bazë të normave të miratuara, të ajrosjes, aktiviteteve arsimore, edukative, sportive; të drejtën për ankesa/kërkesa; etj..

Parimet e përgjithshme dhe politikat kombëtare lidhur me trajtimin e personave të paraburgosur hartohen nga Ministria e Drejtësisë. Si pasojë, MD është institucioni qendror përgjegjës për hartimin Strategjive Kombëtare në fushën e Drejtësisë dhe sistemin penitenciar, si dhe nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Ndalimi i të dyshuarit për kryerjen e një vepre penale bëhet nga Policia e Shtetit, e cila është përgjegjëse për: ndalimet/ arrestimet në flagrancë; mbajtjen deri në 72 orë në ambientet e dhomave të sigurisë të personave të dyshuar⁷ dhe transferimin e tyre më pas në IEVP.

Ndërkohë që, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është institucioni që ndjek e realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit, të ekzekutimit të vendimeve penale, të kryerjes së dënimit dhe të trajtimit të të ndaluarve, të arrestuarve e të dënuarve me burgim. Produktet që dalin nga DPB janë: akte nënligjore për rregullimin e veprimtarive të ndryshme institucionale (si psh. Rregullore); planet e inspektimit në institucionet e paraburgimit; ndjekja e implementimit të rekomandimeve të lëna nga AP apo KSHH, me qëllim përmirësimin e sistemit të paraburgimit dhe burgimit; raportimet në MD, Kuvend dhe organizma ndërkombëtarë, etj.

2.4 Peshë në Buxhet

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Në këtë pikë të raportit, grupi i auditimit ka trajtuar buxhetin e angazhuar për të paraburgosurit. Fokusi u vendos tek Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP-të, duke qenë se këto institucione janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejt me shërbimet që i ofrohen personave të paraburgosur, dhe efektet e politikave dhe aktiviteve të ndërmarra në këtë drejtim janë evidente.

Për analizimin e buxhetit të parashikuar dhe alokuar për periudhën 01.01.2019-30.06.2022, grupi i auditimit, mbështetur në të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, është fokusuar jo vetëm tek IEVP-të të cilat janë të dedikuara vetëm për shërbimin e paraburgimit, por edhe tek IEVP-të e tjera, të cilat trajtojnë si të paraburgosurit, ashtu edhe personat e dënuar.


Referuar të dhënave të përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në vitin 2021 numri i të paraburgosurve në Shqipëri ishte 2793 persona, krahasuar me 2263 persona që ishin në vitin 2019.

Në periudhën 2019-2020, IEVP-të Kukës, Sarandë dhe Elbasan kanë trajtuar vetëm të paraburgosur. Ndërsa, për periudhën 2021- Qershor 2022, kanë trajtuar vetëm të paraburgosur: IEVP-të Kukës (30 të paraburgosur); IEVP Sarandë (44 të paraburgosur); IEVP “Mine Peza” (149 të paraburgosur); IEVP Elbasan (171 të paraburgosur); IEVP Vlorë (176 të paraburgosur).

Në vitin 2021, IEVP-të të cilat kanë trajtuar numrin më të lartë të të paraburgosurve kundrejt totalit të të paraburgosurve për vitin, paraqiten si më poshtë:

⁷ Deri në marrjen e vendimit nga gjykata lidhur me masën e sigurisë. Procesi kryhet në përputhje me urdhërin nr. 925, datë 18.07.2019 “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”;

Infografik nr. 4: Shpërndarja e të paraburgosurve sipas IEVP-ve që trajtojnë të paraburgosurit në Shqipëri



Numrin më lartë i të paraburgosurve për vitin 2021 ishte në: IEVP-të Jordan Misja në Tiranë (434 të paraburgosur); IEVP Fushë Krujë (308 të paraburgosur); IEVP Fier (264 të paraburgosur); IEVP Korçë (243 të paraburgosur); etj..

Në kushtet kur, një numër i lartë të paraburgosurve trajtohet në IEVP të cilat nuk janë të dedikuara vetëm për të paraburgosurit, por shërbejnë edhe për të dënuarit, analizimi i buxhetit u shtri në të gjitha IEVP-të e vendit. Fokusi u vendos tek ato IEVP që kanë numrin më të lartë të paraburgosurve.

Tabela nr. 1: Të dhënat e buxhetit për IEVP-të që trajtojnë të paraburgosurit në Shqipëri

Zërat	2019	2020	2021	07.2022 ⁸
Sistemi i Burgjeve buxheti⁹:	5,625,543	5,387,256	5,813,739	3,220,332
Sisitemi shpz. personeli & operative) 000/ lekë	5,255,654	5,119,217	5,509,759	3,167,545
Sisitemi (shpz. kapitale) 000/lekë	369,889	268,039	303,980	52,787
% e ndryshimit të buxhet të sistemit		-4%	8%	
DPB (buxh.total)/000 lek¹⁰:	1,472,769	1,165,295	1,214,415	630,648
DPB (shpz. personeli & operative) 000/ lekë	1,102,880	897,256	907,808	577,861
DPB (shpz. kapitale) 000/lekë	369,889	268,039	306,607	52,787
IEVP (buxheti total):	3,539,513	3,587,962	3,803,684	2,104,958
IEVP (shpz. personeli & operative) 000/ lekë	3,534,113	3,587,962	3,803,684	2,104,958
IEVP (shpz. kapitale) 000/lekë	5,400	-	-	-
% e ndryshimit të buxhet të IEVP-ve		1%	6%	
Nr. i të burgosur total në IEVP¹¹	4,533	4,262	4,497	4,589
% e ndryshimit të numrit të burgosurve		-6%	6%	
Nr. i të paraburgosurve total në IEVP¹²	2,263	2,354	2,793	2,816
% e ndryshimit të numrit të paraburgosurve		4%	19%	
Buxheti fakt për të paraburgosurit¹³ 000/lek	2,039,752	2,086,027	2,447,376	1,402,869
Pesha e sektorit të paraburgimit në sistem	36%	39%	42%	36%

Burimi: DPB/ Përpunoi: Grupi i auditimit

⁸ Duke qenë se, buxheti për vitin 2022 nuk është mbyllur ende, vlerat për këtë vit janë paraqitur me qëllim transparencën, por ato nuk do të analizohen në mënyrë të detajuar nga grupi i auditimit;

⁹ Në cdo rast në vijim në këtë tabelë, buxheti i paraqitur është ai faktik;

¹⁰ Në zërat e buxheti është përfshirë buxheti faktik i realizuar për vitin respektiv;

¹¹ Numri total i të paraburgosurve dhe i të dënuarve në IEVP-të të cilat trajtojnë të paraburgosur;

¹² Numri total i të paraburgosurve në IEVP-të të cilat trajtojnë të paraburgosur;

¹³ Buxheti faktik vjetor për të paraburgosurit është përlllogaritur si shumë e buxhetit të dedikuar të paraburgosurve për çdo IEVP. Buxheti i dedikuar të paraburgosurve në çdo IEVP është përlllogaritur në përputhje me përqindjen që zënë të paraburgosurit kundrejt totalit të të burgosurve në çdo IEVP, vetëm për shpenzimet e personelit dhe shpenzimet operative, duke mos përfshirë shpenzimet kapitale;

Nga analizimi i tabelës së mësipërme konstatohet se, buxheti faktik i total sistemit të burgjeve ka pësuar ulje në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, ndërsa është rritur me 8% në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. Buxheti faktik për aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të burgjeve ka pësuar rënie në vitet 2020 dhe 2021 krahasuar me vitin 2019. Ndërsa buxheti për IEVP-të që trajtojnë të paraburgosurit ka qenë thuajse i njëjtë në vitet 2019-2020 dhe ka pësuar rritje me 6% në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. Gjatë kësaj periudhe, numri i të paraburgosurve që trajtohet në këto IEVP ka pësuar rritje, ku në vitin 2021 kanë qenë 19% të paraburgosur më shumë se në vitin 2020.

Pesha e buxhetit të sektorit të paraburgimeve në total sistemin e burgjeve ishte 36% në vitin 2019, e cila është ndjekur nga një rritje graduale gjatë periudhës nën auditim, për të arritur 42% në vitin 2021. Peshën kryesore në këtë përqindje e zënë shpenzimet e personelit dhe ato operative, pasi për periudhën në auditim, pesha që zënë investimet për sektorin e paraburgimit në totalin e investimeve në sistemin e burgjeve është thuajse 0.

Duke qenë se IEVP të ndryshme kanë buxhete në vlera të ndryshme dhe trajtojnë numra të ndryshëm të të paraburgosurve, nxjerrja e një kostoje mesatare për të paraburgosurit në nivel sistemi nuk do të përfaqësonte në mënyrë plotësisht të drejtë koston për të paraburgosurit për çdo IEVP. Për këtë arsye, grupi i auditimit ka përllogaritur shpenzimet ditore për 1 të paraburgosur në nivel IEVP-je.

Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet faktike për 1 ditë për 1 të paraburgosur për çdo IEVP, për periudhën nën auditim.

Tabela nr. 2: Shpenzimet ditore për 1 të paraburgosur për periudhën në auditim, sipas IEVP-ve.

lekë

IEVP-të	2019 ¹⁴	2020	2021
I.E.V.P Durrës	1,794	2,043	2,031
I.E.V.P VAQARR	313,022 ¹⁵		
I.E.V.P PEQIN	2,286	2,465	2,424
I.E.V.P LEZHE	7,578	6,412	5,093
Paraburgimi Tropoje	7,971	6,518	5,587
I.E.V.P TEPELENE	3,211	2,809	2,518
I.E.V.P BURREL	2,337	2,653	3,183
Paraburgimi Kukes	6,173	3,648	4,956
I.E.V.P KORCE	1,706	1,398	1,631
I.E.V.P ALI DEMI	3,212	4,944	4,775
I.E.V.P VLORE	2,631	2,284	2,289
I.E.V.P BERAT	3,304	2,940	2,890
Paraburgimi Mine Peza	1,958	2,078	2,384
Paraburgimi Jordan Misja	1,357	1,641	1,895
I.E.V.P FUSHE KRUJE	1,771	1,822	1,968
Paraburgimi Sarande	3,175	3,648	3,606
I.E.V.P KAVAJE	8,387	9,682	10,796
I.E.V.P ELBASAN	2,722	2,698	2,506
I.E.V.P FIER	1,404	1,570	1,466
I.E.V.P SHKODER	1,426	2,008	2,063
Total	2,469	2,428	2,401

Burimi: DPB/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Sikurse mund të vërehet nga tabela e mësipërme, në vitin 2021 vendi ynë shpenzoi mesatarisht 2,401 lekë në ditë për çdo të paraburgosur. Kjo vlerë nuk paraqet në mënyrë të drejtë shpenzimin për çdo të paraburgosur, pasi në IEVP të ndryshme vlera e shpenzuar paraqitet e ndryshme.

Nga tabela e mësipërme vlerësohet se në vitin 2021 IEVP Kavajë ka shpenzuar përafërsisht 10,796 lekë në ditë për çdo të paraburgosur. Ndër IEVP-të të cilat kanë shpenzuar më shumë para në ditë për të paraburgosur paraqiten IEVP Tropojë (5,587 lekë) dhe IEVP Lezhë (5,093 lekë)

¹⁴ Shpenzimet faktike për 1 të paraburgosur në ditë, është përllogaritur duke gjetur buxhetin faktik vjetor për 1 të paraburgosur në cdo IEVP. Ndërsa viti është përllogaritur me 365 ditë;

¹⁵ Gjatë këtij viti në IEVP Vaqarr është trajtuar vetëm një i burgosur gjithsej;

Ndërsa, ndër IEVP që kanë shpenzuar më pak para në ditë për 1 të paraburgosur në vitin 2021, paraqiten IEVP Korçë (1,631 lekë), IEVP Fier (1,466 lekë), etj.

Referuar të dhënave të përcjella nga DPB, gjatë periudhës 2020-korrik 2022 nuk janë kryer investime për sektorin e paraburgimit. Për periudhën nën auditim është kryer vetëm 1 investim në vitin 2019 për IEVP “Jordan Misja” në vlerën 5,400,000 lekë.

2.5 Feedback-u i subjekteve përgjatë auditimit

Gjatë fazës studimore, grupi i auditimit bashkëpunoi me subjektet nën auditim, me qëllim vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar. MD, DPB dhe IEVP-të, si dhe DPP dhe DVP-të i janë përgjigjur në kohë takimeve konsultuese dhe intervistave paraprake, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji 154/ 2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, me qëllim adresimin e problematikave reale të performancës së subjektit dhe përmirësimit të tyre pas rekomandimeve që do të japë KLSH.

Gjatë fazës së terrenit, grupi i auditimit dërgoi pranë MD-së, DPB-së, IEVP-ve, si dhe DPP-së intervistat për konfirmimin e të dhënave zyrtare, në përputhje me nenin 15, pika (dh) dhe (e) si dhe me nenin 26 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Intervista iu dërgua subjekteve nën auditim në mënyrë elektronike. Përgjigjet e gjeneruara nga subjektet u përcollën kryesisht në kohë dhe u trajtuan nga grupi i auditimit, me qëllim gjenerimin e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve në përfundim të punës audituese.

3. DETAJET E AUDITIMIT


3.1 Vlerësimi i Risqeve të Aktiviteteve të Subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjektit të përfshirë në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ai has në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, grupi i auditimit u mbështet në analizën SWOT.

Analiza SWOT paraqet fuqitë dhe dobësitë e institucionit që janë faktorë “brenda kontrollit menaxherial”, si dhe shanset dhe kërcënimet që janë faktorë “jashtë kontrollit menaxherial” ose të klasifikuara si risqe nga faktorë të brendshëm dhe risqe nga faktorë të jashtëm.

Kur risqet vijnë nga faktorë të brendshëm, institucioni duhet të mbështetet në fuqitë dhe të minimizojë dobësitë, ndërsa kur risqet vijnë nga faktorë të jashtëm institucioni duhet të shfrytëzojë shanset dhe të shmangë kërcënimet. Disa nga dobësitë institucionale që cenojnë menaxhimin me efektivitet të shërbimeve të ofruara ndaj personave të paraburgosur, janë:

- Mungesa e investimeve infrastrukturore në ambientet e institucioneve të paraburgimit;
- Vakancat në strukturën organizative të IEVP-ve, të cilat sjellin për pasojë mungesë stafi, duke rrezikuar kështu realizimin e objektivave institucionale;
- Mungesa e programeve të personalizuar të trajtimit, duke vlerësuar nevojat individuale, psikologjike, shoqërore, gjinore, të moshës, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar më herët personi i paraburgosur, faktorët e riskut dhe motivimin për t’u përfshirë në veprimtaritë që organizohen në institucion.



Burim: Grupi i auditimit

Pasi u paraqitën risqet e mjedisit të jashtëm dhe risqet e mjedisit të brendshëm që cenojnë ofrimin e shërbimeve kah personave të paraburgosur, më poshtë është paraqitur klasifikimi i tyre në risk strategjik, financiar, juridik, taktik dhe operacional.

Infografik nr. 6: Klasifikimi i risqeve strategjike, financiare, ligjore, taktike, operationale

	Ulët	Mesatare	Lartë
Strategjike		-Mungesa e ndarjes së praktikave të mira ndërmjet IEVP-ve.	
Teknike			- Mungesa e programeve të personalizuara për personat e paraburgosur. - Vakanca në strukturat organizative.
Operative			- Sektori nuk është tërheqës, me qëllim rekrutimin e stafit të ri.
Financiare			- Mungesa e investimeve infrastrukturore.
Legale		-Perceptim paragjykes ndaj kësaj kategorie individësh.	

Burimi: Grupi i Auditimit


3.2 Objektivi i Auditimit

Auditimi me temë “Performanca e Shërbimit të Paraburgimit” kishte si objektiv kryesor vlerësimin e politikave dhe efektivitetin e tyre në funksion të mbrojtjes dhe garantimit të shërbimeve efektive ndaj personave të paraburgosur, duke u fokusuar kështu kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë dhe realizimin e objektivave të tyre institucionale. Në këtë mënyrë, u synua të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëse institucionet përgjegjëse kanë prodhuar struktura dhe politika të përshtatshme në drejtim të ofrimit të shërbimeve të paraburgimit dhe garantimit të të drejtave që kjo kategori individësh gëzon.

Sa kaq, grupi i auditimit vlerësoj:

1. Efektivitetin e sistemit të paraburgimit në ofrimin e kushteve dhe garantimin e të drejtave për të paraburgosurit;
2. Sigurimin e kushteve të përshtatshme për personat e paraburgosur, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
3. Efektivitetin e strukturave përgjegjëse në realizimin e objektivave të tyre, duke treguar kështu një qasje bashkëpunuese dhe proaktive në garantimin e të drejtave për personat e paraburgosur dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri.

3.3 Pyetjet e Auditimit



Burimi: Grupi i auditimit

Pyetja kryesore: A është efektiv sistemi i paraburgimit në ofrimin e kushteve dhe garantimin e të drejtave të personave të paraburgosur?

Pyetjet e nivelit të parë:

1.1 A janë hartuar politika dhe a sigurohen kushte të përshtatshme për të paraburgosurit, në përputhje me standartet ndërkombëtare?

1.2 A kanë qenë strukturat përgjegjëse efektive në realizimin e objektivave, duke treguar kështu rol proaktiv dhe qasje bashkëpunuese midis tyre?

Pyetjet e nivelit të dytë:

1.1.1 A është hartuar kuadri ligjor dhe rregullator i nevojshëm me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të personave të paraburgosur?

1.1.2 A kanë qenë burimet financiare të mjaftueshme, me qëllim sigurimin e kushteve infrastrukturore të nevojshme për personat e paraburgosur?

1.2.1 A ka qenë DPB dhe IEVP-të efektive në mirë administrimin e sistemit penitenciar?

1.2.2 A ka bashkëvepruar DPB dhe IEVP-të në mënyrë integrale me DPP/DVP-të dhe aktorë të tjerë të përfshirë në proces, në funksion të garantimit të të drejtave për personat e paraburgosur?

3.4 Fushëveprimi i Auditimit

Ky auditim u fokusua në realizimin e objektivave të sistemit penitenciar, përse i përket kushteve të ofruara për të paraburgosurit dhe garantimin e të drejtave të tyre. Periudha objekt auditimi ishin vitet 2019-2022.

Nxitja për ndërmarrjen e këtij auditimi performance erdhi si pasojë e problematikave të evidentuara në këtë sektor. E drejta e trajtimit njerëzor dhe respektimit të dinjitetit të personit të cilit i është kufizuar liria është parim demokratik e Kushtetues.¹⁶ Ofrimi i kushteve dhe shërbimeve me qëllim garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut realizohet nëpërmjet politikave shtetërore, akteve strategjike, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Këto akte duhet të jenë të plota dhe të shoqëruara me plane operacionale konkrete, me qëllim realizimin e objektivave institucionale të strukturave përgjegjëse dhe harmonizimin ndërinstitutional të tyre në mënyrë efektive.

Nga sa më sipër, rrjedhimisht, paradigma e këtij auditimi merr formën: *“Trajtimi dinjitoz i kategorisë shoqërore me të drejta njerëzore të privuara të drejtuar kah orientimeve ndërkombëtare, në harmoni me mirëqeverisjen e institucioneve të paraburgimit, është instrument thelbësor për të ofruar rritjen e sigurisë shoqërore”*.

4. SHITJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT

4.1 A është efektiv sistemi i paraburgimit në ofrimin e kushteve dhe garantimin e të drejtave të personave të paraburgosur?

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, fokusimit të problemit, përcaktimit të objektivave në fazën studimore, analizimit dhe testimit të evidencave gjatë fazës analitike, grupi i auditimit arriti në këtë **MESAZH AUDITIMI:**

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale duhet të luajnë një rol proaktiv në garantimin e të drejtave të shtetasve të paraburgosur, nëpërmjet krijimit të një qasje të re, me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre, vetë respektit dhe dinjitetit njerëzor. Sistemi penitenciar ka nevojë edhe për një bashkëveprim më dinamik ndërmjet institucioneve shtetërore përgjegjëse, veçanërisht midis Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

4.1.1.1 A është hartuar kuadri ligjor dhe rregullator i nevojshëm me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të personave të paraburgosur?

Të gjithë njerëzit lindin të barabartë dhe trajtohen si të tillë përpara ligjit. Respekti i të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë.¹⁷ Bazuar në parimin e shtetit të së drejtës, çdo shoqëri ka për detyrë të ndërtojë strukturat kushtetuese dhe ligjore, që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave themelore të shtetasve. Pavarësisht nga rrethanat, çdo qenie njerëzore gëzon të drejtat dhe liritë themelore, të cilat janë të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.¹⁸

E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut u akordon personave të dyshuar/akuzuar për vepra penale një mbrojtje të veçantë ku, ndër të tjera, ata duhet të gëzojnë të drejtën për një proces të rregullt, të prezumohen të pafajshëm, të mbrohen nga tortura, trajtimi apo dënimi çnjerëzor, të kenë mbrojtje të barabartë nga ligji, si edhe të gëzojnë gjithashtu të drejtën për liri nga ndalimi apo arrestimi arbitrar.¹⁹ Këto parime gjenden të sanksionuara jo vetëm në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga

¹⁶ Neni 28, pika 5 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

¹⁷ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 15 paragrafi 1;

¹⁹ Deklarata Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtarë mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore Çnjerëzore ose Poshtëruese.

shteti jonë, por njëkohësisht janë integruar edhe në legjislacionin kombëtar dhe kanë shërbyer si bazë për organizimin e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri.

Parimet e Drejtësisë Penale

Parimet kryesore të procedimit penal sanksionohen qysh në aktin themeltar të organizimit dhe funksionimit të shtetit, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në pjesën e dytë të Kushtetutës (neni 15- 44) përcaktohen parimet e përgjithshme si dhe liritë dhe të drejtat dhe vetjake që gëzon çdo individ, të cilat kanë shërbyer njëkohësisht si parime bazë edhe në ndërtimin e ligjit penal dhe politikës kriminale²⁰ në vendin tonë. Parimet procedurale janë rregullat themelore që përcaktojnë karakterin dhe përmbajtjen e mënyrës së procedimit penal. Këto parime, përveçse në Kushtetutë i gjejmë të sanksionuara njëkohësisht edhe në Kodin e Procedurës Penale.

Sa kaq, disa nga parimet kryesore procedurale janë:

- Parimi i sigurisë së lirisë;
- Parimi i prezumimit të pafajësisë;
- Parimi i sigurimit të mbrojtjes; etj.

• “Parimi i Sigurisë së Lirisë”

Liria e personit është e drejtë e mbrojtur në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut²¹ dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë²², që mund të kufizohet vetëm me ligj. Në zbatim të parimeve dhe dispozitave të Kushtetutës e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Kodi i Procedurës Penale, parashikon rregulla të hollësishme për masat e sigurimit personal, kushtet, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre.

Sipas nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale, “*arresti me burg*” konsiderohet masa e fundit (*ultima ratio*) e cila mund të caktohet nga gjykata vetëm kur çdo masë tjetër sigurimi është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veprës dhe të pandehurit.

Gjykata e Lartë, përmes një vendimi unifikues, ka konkluduar se masa e sigurimit “*arrest me burg*”, mund të zbatohet vetëm kur i pandehuri procedohet për vepra penale për të cilat ligji cakton dënimin me burgim më të lartë se një vit, si dhe për efekt parandalimi.

Për të qenë i ligjshëm caktimi i masës së sigurimit personal “*arrest me burg*”, duhet të ekzistojë në ngarkim të personit në fjalë një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova që personi ka kryer një vepër penale; të ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; të ekzistojë risku se i pandehuri mund të largohet; të ekzistojë rreziku që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.²³

Në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë është analizuar se, në kuptim të nenit 228/1 të Kodit të Procedurës Penale, dyshimi i arsyeshëm duhet të mbështetet në prova dhe të mos jetë i supozuar. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në vendimarrjen e saj, e cila ka vlerësuar se për çdo periudhë paraburgimi, pavarësisht sa e shkurtër është caktuar ajo, organi i akuzës duhet të parashtrij motive të besueshme që e justifikojnë këtë periudhë. Arsyetimi i përdorur për caktimin e masës së sigurimit “*arrest me burg*” nuk duhet të jetë

²⁰ Politika kriminale përfshin politikën e luftimit të kriminalitetit dhe me të kuptojmë organizmin e planifikuar të aktiviteteve të ndryshme të shoqërisë të drejtuar drejt luftimit të kriminalitetit. Andaj në tërësi politika kriminale kuptohet si sistem i masave preventive dhe represive më të cilat mbrohet shoqëria nga krimi duke pasur parasysh edhe respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;

²¹ Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 5;

²² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 27 dhe 28;

²³ Kodi i Procedurës Penale, neni 228;

i përgjithshëm dhe abstrakt dhe vetëm fakti i dyshimit se është kryer një vepër penale nuk është shkak i mjaftueshëm për të vendosur “*arrestin me burg*”.²⁴

Ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Penale përcaktojnë disa garanci më specifike për respektimin e të kësaj të drejte procedurale, konkretisht:


- Vendimi gjyqësor për caktimin e masës së sigurisë bëhet i pavlefshëm nëse nuk përmban të gjitha elementet e parashikuara në nenin 245 të tij. Një element i ri që është bërë i detyrueshëm në përmbajtjen e këtij vendimi është parashtrimi i fakteve se përse nuk merren parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja, si edhe arsyetimi i papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit kur caktohen masat e sigurimit shtrënguese.

- **Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve jepet i arsyetuar**, në ndryshim nga parashikimi ligjor i mëparshëm ku vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve nuk jepej detyrimisht i arsyetuar.

Megjithatë, pavarësisht se legjislacioni ynë procedural penal është hartuar në mënyrë të atillë që inkurajon përdorimin fleksibël të masave alternative të sigurimit personal dhe pavarësisht se standardet ndërkombëtare inkurajojnë shprehimisht mospërdorimin e masave shtrënguese të kufizimit të lirisë gjatë hetimit dhe gjykimit, deri në dhënien e vendimit,²⁵ në vendin tonë konstatohet një përdorimi i zgjeruar i masës së sigurisë “*arrest me burg*”, në raport me kërkesat e tjera penale.

Për vitin 2021, kërkesat penale për vendosjen e masës së sigurisë “*arrest me burg*”, përbëjnë 40% të kërkesave penale në total.

Infografik nr. 7: Kërkesa penale për vitin 2021




Burim: Vjetari Statistikor i MD/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Me një trend rritës nga viti në vit paraqitet edhe numri i personave të paraburgosur. Kështu, në vitin 2019 totali i personave të paraburgosur ishte 2202 ndërkohë që aktualisht në sistemin penitenciar ndodhen të akomoduar 2844 të paraburgosur, sikurse paraqitet edhe në grafikun mëposhtë.

²⁴ Vendim GJEDNJ James, Wells dhe Lee kundër Mbretërisë së Bashkuar;

²⁵ Kur kjo është e mundur, pa cënuar sigurinë shoqërore dhe kur masa e sigurimit “*arrest me burg*” nuk konsiderohet e domosdoshme;

Infografik nr. 8: Numri total i personave të paraburgosur në sistemin penitenciar 2019-2022




Burim: Vjetari Statistikor i MD/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Përdorimi i zgjeruar i kësaj mase sigurimi konstatohet edhe nga analiza e të dhënave statistikore dhe krahasimi i përqindjes që zënë personat e paraburgosur në sistemin tonë penitenciar në raport me disa vende të Europës.

Në vendin tonë, personat e paraburgosur përbëjnë 56% të popullimit në sistemin penitenciar. Ndërkohë që, në Bullgari, Kroaci, Hungari, Kosovë, Serbi, Mali i Zi, Bosnje Hercegovinë, Slloveni, Greqi, Itali dhe Maltë përqindja e popullimit të personave të paraburgosur në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale varjon nga 19% - 42%.

Infografik nr. 9: Përqindja e personave të paraburgosur sistemin penitenciar në Europë




Burim: DPB/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Trendi i të paraburgosurve është në rritje edhe krahasuar me të dënuarit me burgim. Aktualisht, numri i grave në regjim është 67 (30 të dënuara dhe 37 të paraburgosura), numri i të miturve është 13 (3 të dënuar dhe 10 të paraburgosur) dhe numri i të burgosurve në sistem është 5006, prej të cilëve: 2251 të dënuar dhe 2797 të paraburgosur.²⁶ Përdorimi i zgjeruar i arrestit me burg (paraburgimit), është një simptomë e cila mund të riskoj mbrojtjen e të drejtave të të paraburgosurve, si rezultat i kushteve të dobëta infrastrukturore që kanë një pjesë e IEVP-ve dhe kapaciteteve të kufizuara për akomodimin e këtyre shtetasve, duke krijuar në jo pak raste mbipopullim shqetësues.

²⁶ Shifrat e cituara i referohen të dhënave të vëna në dispozicion nga DPB gjatë fazës së terrenit të punës audituese;

VITI 2022

■ të paraburgosur ■ të dënuar



Burim: Vjetari Statistikor i MD/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Sa kaq, referuar të dhënave të publikuara në vjetarin statistikor të Ministrisë së Drejtësisë, konstatohet se masa e sigurisë “*arrest me burg*” zbatohet në përqindje të lartë edhe kur të ndaluarit akuzohen për vepra penale që nuk paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Gjithashtu, në referencë të këtyre të dhënave grupi i auditimit konkludoj se përqindja e procedimeve të pushuara dhe pezulluara është më e lartë se përqindja e procedimeve që shkojnë për gjykim në përfundim të hetimeve paraprake.²⁷

Masat e sigurimit ndahen në masa të sigurimit personal dhe masa të sigurimit pasuror. Masat e sigurimit personal ndahen në masa shtrënguese dhe masa ndaluese. Neni 232 i Kodit të Procedurës Penale përcakton llojet e masave shtrënguese, të cilat janë:

- a) ndalimi i daljes jashtë shtetit;
- b) detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore;
- c) ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar;
- ç) garancia pasurore;
- d) arresti në shtëpi;
- dh) arresti në burg;
- e) shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik.**

Referuar pikës “e” të nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale, Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve”, në nenin 16 të tij, parashikon **institucionet mjekësore të posaçme**, si një nga llojet e institucioneve në të cilat do të kryhet ekzekutimi i vendimeve penale.

Ndërkohë që, Rregullorja Europiane e Burgjeve përcakton që: “*Personat që vuajnë nga sëmundje mendore dhe ata që për shkak të gjendjes së shëndetit të tyre mendor mendohet se nuk do ta përballojnë mjedisin e burgut, duhet të dërgohen në një mjedis të ngritur posaçërisht për këtë qëllim. Nëse persona të tillë mbahen në burg, pavarësisht kësaj rregulle, atëherë duhet të ekzistojnë rregullore që marrin parasysh statusin dhe nevojat e tyre*”.²⁸

²⁷ Shtojca nr. 1;

²⁸ Rregullorja Europiane e Burgjeve, rregulli 12.1 dhe 12.2;


Nga vizitat në terren, grupi i auditimit konstatoi se në IEVP Lezhë (Shënkoll) ishin të akomoduar 369 pacientë, për të cilët gjykata kishte vendosur masën “mjekim i detyruar”.²⁹ Këta individ ndodheshin të akomoduar në dy godina, përkatësisht në godinën 4 dhe 5, në kushte të papërshtatshme për pacientë me çrregullime mendore që kanë nevojë për trajtim të specializuar. Si pasojë e mbipopullimit, shpeshherë këta individë ishin të vendosur në dhoma të mbingarkuara, me pacientë të cilët kanë sindroma psikosomatike,³⁰ model sjelljeje dhe çrregullime mendore nga më të ndryshmet dhe të përshkallëzuar. Stafi mjekësor në dispozicion të tyre përbëhej vetëm nga dy mjekë dhe trajtimi i tyre nuk ishte i diferencuar nga të burgosurit e tjerë, duke marrë në konsideratë statusin dhe nevojat e tyre. Për rrjedhojë, ky trajtim joadekuat i këtij target grupi, jo vetëm që bie ndesh me standardet ndërkombëtare dhe jurisprudencën e GJEDNJ, por ndikon negativisht në përkeqësimin e shëndetit mendor të këtyre individëve dhe mirëqenien e tyre.

Lidhur me këtë fakt, në çështjen Dybeku kundër Shqipërisë, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës, duke gjetur në veçanti se natyra e gjendjes psikologjike të parashtruesit e kishte bërë atë më të ndjeshëm se të ndaluarit e rëndomtë dhe se ndalimi i tij mund t'i ketë acaruar ndjenjat e tij të shqetësimit, ankthit dhe frikës. Fakti që qeveria shqiptare pranoi që i pandehuri ishte trajtuar si të burgosurit e tjerë, pavarësisht gjendjes së tij të veçantë të shëndetit, po ashtu tregoi dështimin në përmbushjen e rekomandimeve të Këshillit të Evropës për trajtimin e të burgosurve me sëmundje mendore.³¹

Nga ana tjetër, në nenin 230 të Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohen kriteret e veçanta për caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”, ligjvënësi ka parashikuar që: “2. Nuk mund të vendoset arresti në burg ndaj një personi toksikoman apo të alkoolizuar, për të cilin zbatohet një program terapeutik në një institucion të posaçëm”.

Kjo për faktin se, alkoli dhe droga ndikojnë në sjelljen e përdoruesit dhe ato mund të shkaktojnë sjellje të pakontrolluara dhe varësi. Në disa vende ky target grup konsiderohen pacientë që kanë nevojë për kujdes, pasi sjellja e tyre e kundër ligjshme diktohet nga stimuli që mund t’ju jap përdorimi i substancave të ndryshme dhe nëse ata nuk mjekohen mund t’u rikthehen sjelljeve të agresive dhe të kryejnë sërish krime.

Infografik nr. 11: Trendi i të paraburgosurve toksikoman 2019-2021



Burim: DPB/ Përpunoi: Grupi i auditimit

²⁹ Shumica e këtyre pacientëve ishin transferuar pas mbylljes së IEVP Krujë (Zahari);

³⁰ Çrregullime psiqike (mendore) qee manifestohen me simptoma fizike (trupore);

³¹ https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Prisoners_health_SQI.pdf, fq. 20;

Përcaktimi ligjor i nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale bën një diskriminim pozitiv vetëm për personat të cilët janë në proces rehabilitimi në një institucion të posaçëm. Ndërkohë që, sjelljet agresive reflektohen kryesisht tek ata persona të cilët janë përdorues të lëndëve narkotike gjatë kohës që ata janë nën efektin e këtyre substancave. Pavarësisht frymës së ligjvënësit dhe përcaktimit të sipërcituar, nga një vështrim krahasues, grupi i auditimit konstatoi se numri i personave toksikoman të paraburgosur nga viti 2019 deri në vitin 2021 ka ardhur në rritje.

• “Parimi i Prezumimit të Pafajësisë”

Në aspektin procedural ky parim sanksionohet në nenin 4 të ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995, i ndryshuar “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin përcaktohet se: “*i pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë*”. Parimi i prezumimit të pafajësisë u integrua për herë të parë në vendin tonë në Kodin e Procedurës Penale të vitit 1953.³² Në vitin 1979 ky parim u hoq me arsyetimin se është një parim borgjez dhe u rivendos sërish në vitin 1991, me Ligjin nr. 7536, datë 17.12.1991 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”.

Prezumimi i pafajësisë është një parim kushtetues, i parashikuar gjithashtu edhe në nenin 30 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe përbën një ndër elementët thelbësor të procesit të rregullt ligjor³³ në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Në thelb të këtij parimi është mbrojtja reale e të pandehurit dhe ndalimi i gjyqimit të një çështje me bindjen se i akuzuari e ka kryer veprën penale që i është atribuuar.

Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të njeriut (GJEDNJ), në argumentet e përdorura në vendimet e saj shprehet gjithashtu se prezumimi i pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që procesi mos të inicioj me idenë e paracaktuar se personi nën hetim e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Barra e provës i takon organit të akuzës (prokurorit) dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të personit të akuzuar.³⁴

Pavarësisht rëndësisë që paraqet ky parim në zhvillimin e proceseve hetimore, shfaqja e personave me imazhe dhe të prangosur në media në momentet e “*arrestit në flagrancë*” dhe “*ndalimit si të dyshuar për një krim*”, përdorimi i epiteteve të ndryshme me qëllim krijimin e lajmeve “atraktive”, si dhe referimi me emër të plotë i tyre, krijojnë risk potencial për cënim të respektimit të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe mund të ndikoj negativisht në imazhin publik të një individi. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe GJEDNJ nëpërmjet vendimmarrjes së saj.³⁵

Me qëllim vlerësimin e impaktit publik lidhur me rolin e medias në çështjet penale, grupi auditimit hartoi një pyetësor për qytetarët, të cilit ju përgjigjën 261 të anketuar. Sa më lart parashtruar, 80.3% e personave të anketuar mendojnë se publikimi i rasteve të personave të arrestuar/ndaluar në media cenon imazhin e tyre dhe mund të ketë impakt negativ në rehabilitimin dhe ri-integrimin e këtyre individëve sërish në shoqëri dhe tregun e punës, duke ndikuar kështu direkt në cilësinë e jetës së tyre, pavarësisht faktit nëse në përfundim të hetimeve do të shpallen të pafajshëm apo do të dënohen për veprën penale të ngarkuar.



³² Neni 12- “I pandehuri konsiderohet i pafajshëm gjersa nuk provohet fajësia e tij”;

³³ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4 datë 27.02.2004, nr. 9, datë 28.04.2004 dhe nr. 19, datë 18.09.2008;


³⁴ Vendim GJEDNJ “Minelli kundër Zvicrës”, “Telfner kundër Austrisë”, 20.06.2001;

³⁵ Vendim GJEDNJ “Maslarova kundër Bullgarisë”, 31.01.2019;

Infografik nr. 12: Cënimi i imazhit si pasojë e publikimit në media e arrestimit/ndalimit
Burim: Studim i Grupit të auditimit, 2022

A mendoni se publikimi i rasteve të personave të arrestuar/ndaluar në media cenon imazhin e këtyre personave?

261 responses




Ndërkohë që, 68.3% e personave të anketuar mendojnë se publikimi i personave në rastet e arrestimit me imazhe në media nuk ju duket i drejtë. Përqindja e personave të cilët shprehen se publikimi me imazhe i rasteve të arrestimit është i padrejtë, është ndjeshëm më e lartë se përqindja e personave të cilët e konsiderojnë të drejtë këtë veprim. Sa kaq, prezantimi në media i të dhënave personale të individëve, si fotografi apo filmime ku shfaqen të prangosur duke dalë nga një furgon policie për tu futur në DVP, apo referimi i tyre si fajtorë të një krimi, qysh në momentin e ndalimit/ arrestimit, duhet të vlerësohet në dy drejtime: së pari në të drejtën e këtyre personave për tu prezumuar të pafajshëm deri në përfundim të hetimeve dhe së dyti në kuadër të ruajtjes së të dhënave personale.

Infografik nr. 13: Impakti publik lidhur me faktin nëse është i drejtë apo jo publikimi i rasteve të arrestit dhe shfaqja e imazheve në televizionet kombëtare

A ju duket i drejtë ky publikimi i rasteve të arrestimit dhe shfaqja e imazheve në televizionet kombëtare?

261 responses



Burim: Studim i Grupit të auditimit, 2022

Me qëllim zbatimin me efektivitet të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe ruajtjen e imazhit publik të personave nën hetim deri në momentin e marrjes së vendimit nga Gjykata dhe shpalljen e tyre “të pafajshëm” ose “të dënuar” për veprën penale që ju atribuohet, Komisioni Europian ka hartuar Direktivën e (BE) 2016/343 “Në forcimin e disa aspekteve të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim gjatë një procedimi penal”.

Në bazë dhe për zbatim të direktivës së sipërcituar, çdo shtet anëtar i BE-së duhet të marrë masat e duhura për të siguruar që, kur japin informacion për mediat, autoritetet publike të mos i referohen të dyshuarve ose të akuzuarve si fajtorë për aq kohë sa këta persona nuk janë vërtetuar fajtorë sipas ligjit. Gjatë përcjelljes së informacioneve në media, autoritetet publike dhe shtetërore duhet ti kushtojnë vëmendje të posaçme respektimit të parimit të prezumimit të pafajësisë, duke respektuar në të njëjtën kohë ligjin kombëtar që mbron lirinë e shtypit dhe mediave.

Autoritetet kompetente duhet të përmbahen nga prezantimi i të dyshuarve ose të akuzuarve si fajtorë, në gjykatë ose publikisht, nëpërmjet përdorimit të masave të kufizimit fizik, si pranga, përveç rasteve kur përdorimi i këtyre masave është i nevojshëm. Njëkohësisht, edhe Agjencia Europiane e të

Drejtave Themelore, në botimin e saj lidhur me “Parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të drejtave që lidhen me këtë parim”, përcakton se: “Duke respektuar lirinë e shtypit, Shtetet Anëtare të BE duhet të krijojnë rregulla të sakta për autoritetet publike dhe komunikimin me mediat rreth çështjet penale, duke mbajtur në konsideratë respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë. Informacioni i përcjellë nuk duhet përfshi të dhëna ose detaje personale për jetën private të personave të pandehur”. Sa kaq, duke e vënë theksin në respektimin dhe garantimin e të drejtave themelore të njeriut, si dhe duke marrë në konsideratë praktikën e mira, përcjellja e lajmeve në media duhet të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e mos diskriminimit, etikën profesionale, dinjitetin e personave dhe përcaktimet e diktura nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.

• **“Parimi i Sigurimit të Mbrojtjes”**

E drejta për të pasur një mbrojtës ligjor, është një nga të drejtat procedurale thelbësore në një gjykim penal, pasi vetëm në këtë mënyrë respektohet në mënyrë efektive parimi i kontradiktoritetit dhe i pandehuri është në pozita të barabarta me organin e akuzës. Për shkak të rëndësisë specifike të tij, ky parim sanksionohet në Kushtetutë dhe njëkohësisht edhe në Konventën Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Në ndryshimet e pësura rishtazi, Kodi i Procedurës Penale reflekton disa nga standardet europiane³⁶ mbi të drejtën e të pandehurit për t'u njohur me akuzën ndaj tij dhe të drejtat që ai gëzon³⁷ gjatë procesit të procedimit penal, kur ai ka pozitën e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime.

Kodi i Procedurës Penale sanksionon dy koncepte të mbrojtjes gjatë zhvillimit të një procesi penal: “mbrojtjen e detyrueshme”³⁸ dhe “mbrojtjen për shkak të pamjaftueshmërisë financiare”.³⁹

Në rastin e mbrojtjes së detyrueshme, ligjvënësi bën një përcaktim eksplicit të grupeve që legjitimohen të përfitojnë mbrojtjen e detyrueshme nga shteti. Ndërkohë që, në rastin e mbrojtjes për shkak të pamjaftueshmërisë financiare, organi i akuzës vihet në lëvizje me kërkesën e personit të pandehur dhe vetëm pasi vërtetohet se plotësohet kushti i pamjaftueshmërisë financiare. Konkretisht, në nenin 12 të Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përcaktohet se: “2. **Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.** 3. **Të ardhurat e një personi, i cili nuk jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi**”.

Sa më sipër, grupi i auditimit kërkoj nga MD vënien në dispozicion të analizës së kryer gjatë hartimit të Ligjit nr. 111/2017, me qëllim përcaktimin e këtij limiti për përfitimin e ndihmës juridike. MD nuk kishte kryer ndonjë analizë apo hartuar ndonjë metodologji për përcaktimin e këtij kufiri ligjor, por i ishte referuar modelit Slloven dhe përcaktimeve ligjore që ky vend parashikon lidhur me përfitimin e ndihmës juridike dytësore për shkak të pamjaftueshmërisë financiare.

Sa më sipër, transpozimi i këtij përcaktimi ligjor është i cunguar, pasi Sllovenia, në ndryshim nga vendi jonë ka të përcaktuar minimumin jetik, i cili reflektohet edhe në përcaktimin e pagës minimale. Në kushtet kur, Shqipëria nuk ka të miratuar një ligj për përcaktimin e minimumit jetik dhe nga ana tjetër rritja e inflacionit sipas të dhënave statistikore të INSTAT, shënon rekordin më të lartë të 20 viteve të fundit⁴⁰, në përlllogaritjen e kufirit të pamjaftueshmërisë financiare nuk duhet të mbahen në konsideratë vetëm të ardhurat e një personi por njëkohësisht edhe shpenzimet e nevojshme dhe të

³⁶ Direktiva e Bashkimit Europian për të Drejtën e Informimit, neni 4;

³⁷ Risi përbën neni 34/b i këtij Kodi, për njohjen e të ndaluarit me të drejtat e tij nëpërmjet “letrës së të drejtave” në formë të shkruar, e cila duhet t’i jepet personit të ndaluar kundrejt nënshkrimit;

³⁸ Kodi i Procedurës Penale, neni 49;

³⁹ Kodi i Procedurës Penale, neni 49/a;

⁴⁰ INSTAT- inflacioni në muajin shtator 2022 ishte 7,9%;

detyrueshme për jetesë. Për rrjedhojë, MD duhet të kryej një analizë të mirëfilltë, me qëllim përcaktimin e kriterit të pamjaftueshmërisë financiare dhe përfitimit të ndihmës juridike dytësore falas.

Lidhur me procesin e caktimit të mbrojtësit për të pandehurin pa mjete të mjaftueshme financiare, në nenin 21 të Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përcaktohet se: “1. Në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet nga i pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare, **organi procedues që fillon hetimet** shqyrton menjëherë nëse përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji. 2. Nëse organi procedues që fillon hetimet vlerëson se kriteret janë përmbushur, **cakton menjëherë një avokat mbrojtës** nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe njofton menjëherë personin, të cilit i ofrohet ndihmë juridike dytësore, si dhe avokatin e caktuar mbrojtës”.

Ndërkohë që, në nenin 22 të këtij ligji, paragrafi i parë përcaktohet se: “1. **Gjykata** shqyrton kërkesën për ndihmën juridike dytësore në përputhje me parashikimet në legjislacionin procedural dhe, për aq sa është e mundur, me dispozitat e këtij ligji”.

Nga përcaktimet e parashtruara në nenin 21 dhe 22 konstatojmë se në fazën e procedimit penal, e drejta për caktimin e avokatit mbrojtës i njihet organit procedues që fillon hetimet, pra, prokurorit. Ndërsa, në fazën e dërgimit të çështjes për gjykim, është gjykata ajo që shqyrton kërkesën për ndihmë juridike dytësore dhe vendos për përfitimin ose jo të saj, duke ja përcjelle më pas këtë vendim Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Dhomës Vendore të Avokatisë (e cila cakton një avokat nga lista e avokatëve që japin ndihmë dytësore dhe ja përcjell vendimin gjykatës). Në bazë dhe për zbatim të parimit të një mbrojtjes efektive, si dhe në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, dispozita 21 dhe 22 duhet të trajtohen të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. KEDNJ dhe Kodi i Procedurës Penale flasin për “ndihmë” juridike dhe jo për “emërim” të një përfaqësuesi ligjor. Çka nënkupton rëndësinë e mundësisë për tu mbrojtur në mënyrë reale dhe efektive. Garantimi i të drejtave procedurale duhet të jetë praktik dhe efektiv dhe jo teorik apo formal.⁴¹

Për rrjedhojë, në kushtet kur kërkesa për përfitimin e ndihmës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare është paraqitur nga i pandehuri që në fazën fillestare të hetimit dhe ai ka përmbushur kushtet për përfitimin e saj, ligjvënësi duhet ti ofrojë atij mundësinë që edhe gjatë procesit të gjykimit personi i pandehur të përfaqësohet me po të njëjtin avokat, që i është caktuar nga prokurori në fazën e hetimeve paraprake.

Ndër ndryshimet pozitive që ka pësuar sistemi i drejtësisë penale, është hartimi i një Kodi Penal të Drejtësisë për të Mitur, i cili për herë të parë parashikon në një kuadër të vetëm ligjor rregullat procedurale dhe të drejtat që duhet të zbatohen në rastet kur kemi një të mitur në konflikt me ligjin. Ndryshe nga i pandehuri i rritur, i cili ka të drejtën të zgjedhë të ketë një mbrojtës ose ka të drejtën të mbrohet vetë, në rastin e të pandehurit të mitur, në çdo fazë të drejtësisë penale, çdo i mitur në konflikt me ligjin duhet të përfaqësohet nga një mbrojtës ligjor dhe në rastet kur është në pamundësi, ndihma i garantohet falas nga shteti.⁴² Mungesa e mbrojtësit ligjor të të miturit gjatë një faze të procedimit penal, e bën procesin gjyqësor të parregullt. Ky parim parashikohet si në Kodin e Procedurës Penale ashtu edhe në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Neni 31 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, përcakton gjithashtu se: “I mituri në konflikt me ligjin ose viktimë **mbrohet nga avokatë të specializuar në drejtësinë për të mitur**, me përjashtim të rasteve kur i mituri ose përfaqësuesi i tij ligjor përzgjedh një avokat tjetër”. Gjatë vitit 2022 nga 13 të mitur të vendosur në Institucionin e të Miturve Kavajë, 2 prej tyre janë trajtuar me ndihmë juridike falas.

⁴¹<https://www.osfa.al/sites/default/files/efektiviteti-i-ndihmes-juridike-ne-procesin-penal-ne-shqiperi-res-publica-mars-2016.pdf>;

⁴² Kodi i Drejtësisë Penale Për të Mitur, neni 20 dhe Kodi i Procedurës Penale, neni 49;

Aktualisht, Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk harton një listë të posaçme të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur. Me qëllim implementimin efektiv të këtij përcaktimi ligjor, Ministria e Drejtësisë nëpërmjet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, duket ti kërkoj Dhomës Kombëtare të Avokatisë të përgatisë lista të veçanta për avokatët kryesisht, të cilët janë specializuar në mbrojtjen e të drejtave të të miturve, si dhe të kryejë trajnime periodike të avokatëve, duke miratuar kurrikula të posaçme në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e të miturve në konflikt me ligjin.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë në cilësinë e Ministrisë përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e drejtësisë ka hartuar Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë, ku pjesë e institucioneve bashkëpërgjegjëse është edhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Ky vizion është jetësuar nëpërmjet 4 qëllimeve të politikës. Një nga qëllimet e politikës të parashikuar në këtë strategji (respektivisht qëllimi i 3-të) është: *“Krijimi i një drejtësie penale të mbështetur në parimet moderne europiane të drejtësisë, e cila garanton risocializimin, ri-integrimin, rehabilitimin, respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar e me praktika solide të parandalimit të krimit”*.

Disa nga rezultatet e arritura me qëllim implementimin e kësaj strategjie, sa i përket kuadrit ligjor që rregullon sistemin penitenciar dhe përmirësimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, janë:

- Rishikimi i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale dhe amendimet e reflektuara në këto kode në vitin 2021;
- Hartimi i paketës ligjore të sistemit penitenciar dhe miratimi i 4 akteve ligjore, përkatësisht ligji: “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve”, “Për Policinë e Burgjeve”, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”;
- Aktet nënligjore të hartuara dhe miratuara me qëllim implementimin efektiv të parashikimeve ligjore.

Më tej, në objektivin 3.5 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë përcaktohet: *“Zhvillimi i sistemit penitenciar bazuar në standardet europiane, që siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane zhvillimi individuale”*.

Me qëllim implementimin e këtij objekti, ndër të tjera, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka parashikuar si masë: hartimin dhe miratimin e skemës dhe standardeve për (i) mbikëqyrjen e rregullt psikologjike për të gjithë stafin (ii) vlerësimin e performancës për IEVP-të.

Referuar planit të masave të miratuar me Vendim nr. 823, datë 24.12.2021 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimtimit”, hartimi i standardeve për mbikëqyrjen e rregullt psikologjike për të gjithë stafin dhe hartimi i metodologjisë për vlerësimin e performancës në IEVP, si dhe pilotimi i këtij procesi në 4 IEVP duhet të ishte konkluduar në vitin 2021.

Sa më sipër, DPB ende nuk ka konkluduar gjenerimin e këtyre akteve. Mungesa e përcaktimit të standardeve për mbikëqyrje të rregullt psikologjike të stafit të angazhuar në IEVP, si dhe mungesa e hartimit të metodologjisë për vlerësimin e performancës së IEVP-ve, ndikon negativisht në qasjen për zhvillim të sistemit penitenciar bazuar në standardet europiane. Këto janë dy mekanizma esencial për vlerësimin real të IEVP-ve, me qëllim garantimin e të drejtave personave të paraburgosur dhe të dënuar. Për rrjedhojë, DPB duhet të marrë masa për finalizimin e hartimit dhe miratimit të metodologjisë që do të përdoret, si dhe pilotimin e këtij procesi vlerësimi në IEVP.

Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve” & Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve

Përveç të drejtave të karakterit procedural, personat e paraburgosur gëzojnë edhe të drejta të tjera. Këto të drejta që personat e paraburgosur gëzojnë, parashikohen në Ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Ky ligj është ligji bazë për organizimin e sistemit penitenciar në Republikën e Shqipërisë dhe ka në fokus garantimin e rehabilitimit social dhe të ri-integrimit në jetën familjare, shoqërore e ekonomike të të paraburgosurve dhe të dënuarve madhor e të mitur.

Ligji nr. 81/2020 nuk bën asnjë diferencim ndërmjet kategorive “*i dënuar*” dhe “*i paraburgosur*”, sa i përket të drejtave që ju njihen këtyre personave gjatë qëndrimit në IEVP. I vetmi dallim ndërmjet këtyre dy kategorive që ligjvënësi ka parashikuar është përfitimi i benefiteve ligjore si lejet, uljet e dënimit dhe lirimi me kusht, të cilat të paraburgosurit nuk mund ti përfitojnë, për shkak se natyra e këtyre të drejtave lidhet me marrjen e dënimit të formës së prerë nga ana e gjykatës.

Një akt tjetër thelbësor në ushtrimin e veprimtarisë nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale është edhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 209, datë 06.04.2022 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”. Kjo rregullore është hartuar në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 81/2020 dhe ka për qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e sistemit të burgjeve, disiplinën e brendshme, trajtimin me dinjitet dhe respektimin e të drejtave themelore të të burgosurve, kushtet e jetesës në institucion, mjediset, normat e sjelljes së të burgosurve me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre si dhe çdo element që lidhet me ekzekutimin e vendimeve penale, në përputhje me parashikimet ligjore dhe standardet ndërkombëtare.

Ndër të drejtat që ju njihen personave të paraburgosur, kujdes i veçantë në aktet e sipërcituara i kushtohet ruajtjes, përmirësimit ose rivendosjes së lidhjeve të të paraburgosurit dhe të të dënuarve me familjen, takimeve dhe vizitave.⁴³

Ndërkohë, neni 40 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, përcakton që: ***“2. Takimet e zgjatura lejohen deri në 5 orë për të dënuarit e martuar ose bashkëjetues, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kodin e Familjes”.***

Sa më sipër, pavarësisht se ligji i barazon në të drejta personat e dënuar dhe të paraburgosur, Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, në kundërshtim me ligjin, i njeh të drejtën për takime të zgjatura vetëm personave “*të dënuar*” në mënyrë eksplicite. Lidhur me këtë fakt, pavarësisht se në hierarkinë e burimeve të së drejtës, akti ligjor prevalon në raport me aktet nënligjore, aktualisht, në të gjitha IEVP-të e drejta për takim të zgjatur ju mundësohet vetëm personave “*të dënuar*” dhe jo personave “*të paraburgosur*”.

Zbatimi i këtij përcaktimi ligjor të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, i cili bie ndesh edhe me Ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve”, u mohan një të drejtë esenciale personave të paraburgosur, në kuadër të ruajtjes së lidhjeve me familjen. Për individin, paraburgimi ka efekte të rënda psikologjike. Për rrjedhojë niveli i vetëvrasjeve midis të ndaluarve në paraburgim është disa herë më i lartë se të burgosurit e dënuar. Arrestimi dhe më pas vendosja në paraburgim, shpëpusin në mënyrë të menjëhershme, dhe në shumicën e rasteve dhe të papritur, komunikimin e individit me mjedisin social në të cilin ai zhvillon jetën e tij të natyrshme. Mjedisi social i tij përbëhet së pari nga familja e tij. Për rrjedhojë, qëllimi i ligjvënësit në përcaktimin dhe mundësimin e takimeve të zgjatura është ruajtja e marrëdhënieve bashkëshortore/bashkëjetuese dhe familjare.

Nga sa më sipër, bazuar në faktin se ligji nuk bën një trajtim të diferencuar të statusit të personit “*të paraburgosur*” me personin “*e dënuar*” sa i përket të drejtave të garantuara, si dhe duke marrë në

⁴³Ligji 81/2020 nr. “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 48;

konsideratë faktin se kohëzgjatja e një procesi hetimor mund të shkoj deri në 3 vjet, e drejta për takime të zgjatura duhet ti mundësohet çdo personi të legjitimuar për përfitimin e kësaj të drejte, pavarësisht faktit nëse është “i dënuar” apo “i paraburgosur”.

Ligji për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve përcaktojnë gjithashtu edhe të drejtën e çdo personi të dënuar apo paraburgosur për të hartuar kërkesa dhe ankesa. Në bazë dhe për zbatim të nenit 58 të ligjit, i burgosuri ka të drejtë të paraqesë kërkesë ose ankesë drejtuar IEVP-së, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ministrit të Drejtësisë, Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare, organizatave jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, prokurorit ose gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit penal, si dhe personave që sipas nenit 51 të këtij ligji kanë të drejtë të vizitojnë institucionin. Në vijimësi, në nenin 59 të ligjit nr.81/2020 ligjvënësi ka përcaktuar afatet e shqyrtimit të ankesës dhe të kërkesës. Konkretisht, në pikën 1 të kësaj dispozite ligjvënësi ka përcaktuar se: “1. *Organet kompetente, sipas këtij ligji, shqyrtojnë ankesën dhe kërkesën sa më parë, por jo më vonë se 14 ditë nga paraqitja, përveç rasteve kur ky ligj parashikon afate të posaçme për shqyrtimin e tyre*”.

Nga sa më sipër, ligjvënësi ka përcaktuar një afat të përgjithshëm për shqyrtimin e ankesave/kërkesave, pavarësisht institucionit që ato i drejtohen. Një përcaktim më i detajuar i këtyre afateve nuk parashikohet as në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Për rrjedhojë, DPB duhet të marrë masa për të përcaktuar saktësisht dhe në mënyrë të posaçme afatet e trajtimit të një kërkesë/ankese nga vet IEVP-të dhe afatet e trajtimit të kërkesave/ankesave nga ana e DPB-së.

Një e drejtë tjetër që ju njihet personave të paraburgosur është edhe mundësia e punësimit të tyre pranë IEVP-ve, deri në përfundimin e hetimeve. Kjo marrëdhënie ndërmjet të paraburgosurit dhe IEVP-së përkatëse rregullohet nëpërmjet VKM-së nr. 602, datë 13.10.2021, “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e punës”. Ky vendim shfuqizoj vendimin e mëparshëm që rregullonte këtë marrëdhënie pune, të vitit 1993.

Bazuar në VKM për caktimin e rregullave të posaçme të punësimit, ndërmjet të paraburgosurit të punësuar dhe IEVP-së nënshkruhet një kontratë dypalëshe që përcakton të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella, si dhe masën e shpërblimit për punën e kryer. Nga shqyrtimi i kontratave të nënshkruara, grupi auditimit konstaton pasaktësi në përpilimin dhe nënshkrimin e tyre. Në disa raste, në këto kontrata mungonte data e fillimit të fuqisë juridike të tyre, si dhe numri i llogarisë bankare ku do të kalojnë të ardhurat e fituara nga punësimi i të paraburgosurit. Të dyja këto kushte (afati i fillimit të fuqisë juridike të kontratës dhe përcaktimi i numrit të llogarisë në të cilin do të kaloj shpërblimi për punë), janë kushte thelbësore të përcaktuara në kontratën e punës, mungesa e të cilave mund të cenojë interesat të paraburgosurit punëmarrës. Për rrjedhojë, në vijimësi çdo IEVP duhet të marrë masa nëpërmjet sektorit juridik, që kontratat të përmbajnë të gjitha përcaktimet e nevojshme që garantojnë respektimin e të drejtave që lindin nga marrëdhënia e punësimit, si: koha e fillimit të efektit juridik të tyre dhe llogaria bankare në të cilën do të kaloj shpërblimi. Vetëm pasi të jenë përcaktuar qartësisht kushtet thelbësore të marrëdhënies kontraktore, atëherë mund të kërkohet nënshkrimi i këtij akti nga ana e të paraburgosurit të punësuar.

Gjetje:

1. Në IEVP Lezhë (Shënkoll), krahas personave “të paraburgosur” dhe “të dënuar”, janë të akomoduar edhe 369 pacientë me çrregullime të shëndetit mendor, për të cilët gjykata ka vendosur masën “mjekim i detyruar”. Këta individ ndodhen të akomoduar në dy godina, në kushte të papërshtatshme për pacientë me çrregullime mendore që kanë nevojë për trajtim të specializuar. Stafi mjekësor në dispozicion të tyre përbëhet vetëm nga dy mjekë dhe trajtimi i tyre nuk është i diferencuar nga të burgosurit e tjerë, duke marrë në konsideratë statusin dhe nevojat e tyre.

2. Në kriteret e përfitimit të ndihmës juridike falas, të garantuar nga shteti ndaj personave që konsiderohen në kushtet e pamjaftueshmërisë financiare, merren në konsideratë vetëm të ardhurat e një personi por jo shpenzimet e detyrueshme dhe të nevojshme për jetesë.
3. Referuar legjislacionit në fuqi, në faza të ndryshme të procedimit penal procesi i caktimit të avokatit mbrojtës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare bëhet nga organe proceduese të ndryshme. Kështu, në fazën e hetimit paraprak, e drejta për caktimin e avokatit mbrojtës i njihet organit procedues që fillon hetimet, pra, prokurorit. Ndërsa, në fazën e dërgimit të çështjes për gjykim, është gjykata ajo që shqyrton kërkesën për ndihmë juridike dytësore dhe vendos për përfitimin ose jo të saj.
4. Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk harton një listë të posaçme të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur dhe përfaqësimin e tyre, sikurse diktohet nga neni 31 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
5. DPB ende nuk ka konkluduar hartimin dhe miratimin e skemës dhe standardeve për mbikëqyrjen e rregullt psikologjike për të gjithë stafin dhe vlerësimin e performancës për IEVP-të.
6. Takimet e zgjatura nuk zbatohen në asnjë rast për personat e paraburgosur. Referuar Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, këto takime ju mundësohen vetëm personave “të dënuar”.
7. Ligji nr. 81/2020 dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve nuk përcaktojnë afate të posaçme për trajtimin e ankesave të të paraburgosurve, kur ato shqyrtohen nga IEVP-të dhe kur shqyrtohen nga DPB.
8. Nga shqyrtimi i kontratave të punës midis “të paraburgosurve” dhe IEVP-së, grupi auditimit konstatoi pasaktësi në përpilimin dhe nënshkrimin e tyre. Në 6 nga 17 kontratat e shqyrtuara nga grupi i auditimit, mungonte data e fillimit të fuqisë juridike të tyre, si dhe numri i llogarisë bankare ku do të kalojnë të ardhurat e fituara nga punësimi i të paraburgosurit.

Konkluzione:

- Trajtimi jo i përshtatshëm i pacientëve me çrregullime të shëndetit mendor, për të cilët gjykata ka vendosur masën “mjekim i detyruar”, jo vetëm që bie ndesh me standardet ndërkombëtare dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, por ndikon negativisht në përkeqësimin e shëndetit mendor të këtyre individëve dhe mirëqenien e tyre.
- E drejta për të pasur një mbrojtës ligjor, është një nga të drejtat procedurale thelbësore në një gjykim penal. Në kuadër të parimit të mbrojtjes efektive, sa i përket përcaktimit të pamjaftueshmërisë financiare, Ministria e Drejtësisë i është referuar modelit Slloven dhe përcaktimeve ligjore që ky vend parashikon. Megjithatë, transpozimi i këtij përcaktimi ligjor është i cunguar, pasi Sllovenia, në ndryshim nga vendi jonë ka të përcaktuar minimumin jetik, i cili reflektohet edhe në përcaktimin e pagës minimale. Në kushtet kur, Shqipëria nuk ka të miratuar një ligj për përcaktimin e minimumit jetik, përlllogaritja e kufirit të pamjaftueshmërisë financiare duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e një personi por jo shpenzimet e nevojshme dhe të detyrueshme për jetesë është e cunguar dhe rrezikon të përjashtoj nga skema individ, të cilët kanë realisht nevojë për ndihmë juridike falas. Njëkohësisht, edhe mungesa e hartimit të listave të posaçme për përfaqësimin ligjor të të miturve dhe përcaktimi i përfaqësuesve ligjor të ndryshëm në faza të ndryshme të procesit penal, si për të miturit ashtu edhe tek personat madhor, ndikon negativisht në efektivitetin e procesit të mbrojtjes së tyre.
- Mungesa e përcaktimit të standardeve për mbikëqyrje të rregullt psikologjike të stafit të angazhuar në IEVP, si dhe mungesa e hartimit të metodologjisë për vlerësimin e performancës së IEVP-ve, ndikon negativisht në qasjen për zhvillim të sistemit penitenciar bazuar në standardet europiane. Këto janë dy mekanizma esencial për vlerësimin real të IEVP-ve, me qëllim garantimin e të drejtave personave të paraburgosur dhe të dënuar.
- Pavarësisht se ligji nr. 81/2020 i barazon në të drejta personat “e dënuar” dhe “të paraburgosur”, asnjë prej personave të paraburgosur nuk përfiton takime të zgjatura. Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, në kundërshtim me ligjin, i njeh të drejtën për takime të zgjatura vetëm personave të

dënuar në mënyrë eksplicite. Zbatimi i këtij përcaktimi ligjor të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, u mohon një të drejtë esenciale personave të paraburgosur, në kuadër të ruajtjes së lidhjeve me familjen.

- Mungesa e përcaktimit të afateve të arsyeshme dhe të posaçme për trajtimin e kërkesë/ankesave, sipas institucionin përgjegjës për trajtimin e tyre, ndikon në zgjatje të pajustificuara dhe cenimin e të drejtave të personave të paraburgosur.
- Të dyja këto kushte (afati i fillimit të fuqisë juridike të kontratës dhe përcaktimi i numrit të llogarisë në të cilin do të kaloj shpërblimi për punë), janë kushte thelbësore të përcaktuara në kontratën e punës, mungesa e të cilave mund të cenojë interesat të paraburgosurit punëmarrës.

Rekomandim nr. 1:

Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrin masa për ngritjen e një Institucioni Mjekësor të Posaçëm, duke ofruar kushte dhe një shërbim mjekësor të denjë për pacientë me çrregullime mendore.

Në vijimësi

Rekomandim nr. 2:

Ministria e Drejtësisë të kryejë një analizë të mirëfilltë, për përcaktimin e kriterit të pamjaftueshmërisë financiare dhe përfitimit të ndihmës juridike dytësore falas.

Menjëherë

Rekomandim nr. 3:

Ministria e Drejtësisë të propozojë rishikimin e përcaktimeve ligjore në Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që: “*në rastet kur kërkesa për përfitimin e ndihmës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare paraqitet nga i pandehuri që në fazën fillestare të hetimit dhe ai ka përmbushur kushtet për përfitimin e saj, atij ti ofrohet mundësia që edhe gjatë procesit të gjyqimit të përfaqësohet me po të njëjtin avokat, që i është caktuar nga prokurori në fazën e hetimeve paraprake, kur është e mundur*”.

Në vijimësi

Rekomandim nr. 4:

Ministria e Drejtësisë të kërkojë nëpërmjet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, që Dhoma Kombëtare e Avokatisë të hartojë lista të veçanta të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur dhe përfaqësimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandim nr. 5:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për hartimin dhe miratimin e skemës dhe standardeve për mbikëqyrjen e rregullt psikologjike për të gjithë stafin dhe vlerësimin e performancës për IEVP.

Qershor 2023

Rekomandim nr. 6:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për amendimin Rregullores së Përgjithshme e Burgjeve. Përkatësisht, të rishikohet neni 40 i kësaj rregulloreje në përputhje me ligjin nr. 81/2020. Gjithashtu, DPB të marrë masa që në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve të përcaktohen afate të posaçme për trajtimin e kërkesave/ankesave të personave të paraburgosur, në rastet kur ajo do të shqyrtohet nga vet IEVP dhe përcaktimin e afateve të trajtimit të tyre nga ana e DPB-së.

Menjëherë

Rekomandim nr. 7:

IEVP-të të marrin masa për nënshkrimin e saktë dhe të rregullt të kontratave të punës ndërmjet personave të paraburgosur dhe IEVP-së. Kontratat të përmbajnë të gjitha përcaktimet e nevojshme që garantojnë respektimin e të drejtave që lindin nga marrëdhënia e punësimit, si: koha e fillimit të efektit juridik të tyre dhe llogaria bankare në të cilën do të kaloj shpërblimi.

Në vijimësi

4.1.1.2 A kanë qenë burimet financiare të mjaftueshme, me qëllim sigurimin e kushteve infrastrukturore të nevojshme për personat e paraburgosur?

Burimet financiare dhe investimet kanë rëndësi thelbësore për përmirësimin e kushteve dhe shërbimit për të paraburgosurit, por edhe për zhvillimin e sistemit të burgjeve në përgjithësi. Investimet në infrastrukturë janë pjesa më e dukshme dhe e prekshme nga personat që qëndrojnë në këto institucione. DPB dhe të gjitha IEVP-të në varësi të saj financohen nga buxheti i shtetit. Kështu, përjashtuar investimet që mund të realizohen me mbështetjen e një donatori, zhvillimi i sistemit penitenciar varet tërësisht nga fondet publike të alokuara për të.

Në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 objektivi 4.3 parashikon zhvillimin e kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe rritjen e mbështetjes së saj për institucionet e varësisë, nëpërmjet kryerjes së analizës së situatës së kontrollit të brendshëm financiar në shërbimin e burgut, përfshirë kontrollin e brendshëm të MD-së për mbikëqyrjen e njësisë dhe përgatitja e një vlerësimi të detajuar të risku në lidhje me administrimin financiar në burgje (nën objektivi 4.3.4). Në përfundim të punës audituese, grupi i auditimit konstatoi se në lidhje me këtë pikë edhe pse dokumenti strategjik ndodhet në vitin e dytë të zbatimit të tij, nuk është bërë asnjë progres dhe nuk është gjeneruar asnjë nga produktet e kërkuara.

Më tej, fondet e alokuara nga buxheti i shtetit në favor të sistemit të burgjeve janë ndjeshëm më të ulta se planifikimi i kryer dhe kërkesat e bëra nga IEVP-të dhe DPB. Pësia e buxhetit të sektorit të paraburgimeve në sistemin e burgjeve në vitin 2019 total ishte 36%, e cila është ndjekur nga një rritje graduale +6% gjatë periudhës nën auditim, për të arritur 42% në vitin 2021. Peshën kryesore e zënë shpenzimet e personelit dhe ato operative, pasi për periudhën nën auditim, pesha që zënë investimet për sektorin e paraburgimit në totalin e investimeve në sistemin e burgjeve është thuhetse zero.

Tabela nr. 3: Të dhënat e buxhetit për IEVP-të që trajtojnë të paraburgosurit në Shqipëri

000/lekë

Zërat	2019	2020	2021	01.07.2022 ⁴⁴
Sistemi i Burgjeve buxheti:	5,625,543	5,387,256	5,813,739	3,220,332
% e ndryshimit të buxhet të sistemit		-4%	8%	
DPB (buxh.total)/000 lekë ⁴⁵ :	1,472,769	1,165,295	1,214,415	630,648
IEVP (buxheti total):	3,539,513	3,587,962	3,803,684	2,104,958
% e ndryshimit të buxhet të IEVP-ve		1%	+6%	
Nr. i të burgosur total në IEVP ⁴⁶	4,533	4,262	4,497	4,589
% e ndryshimit të numrit të burgosurve		-6%	+6%	
Nr. i të paraburgosurve total në IEVP ⁴⁷	2,263	2,354	2,793	2,816
% e ndryshimit të numrit të paraburgosurve		+4%	+19%	
Buxheti fakt për të paraburgosurit ⁴⁸ 000/lek	2,039,752	2,086,027	2,447,376	1,402,869
Pesha e sektorit të paraburgimit në sistem	36%	39%	42%	36%

Burimi: DPB/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga analizimi i tabelës së mësipërme konstatohet se, buxheti faktik total i sistemit të burgjeve ka pësuar ulje në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, ndërsa në vitin 2021 është rritur me +8% krahasuar me vitin 2020. Buxheti faktik për aparatin e DPB ka pësuar rënie në vitet 2020 dhe 2021 krahasuar me vitin 2019. Ndërsa buxheti për IEVP-të që trajtojnë të paraburgosurit ka qenë thuhetse i njëjtë në vitet 2019-2020 dhe ka pësuar rritje me +6% në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. Gjatë kësaj

⁴⁴ Duke qenë se, buxheti për vitin 2022 nuk është mbyllur ende, vlerat për këtë vit janë paraqitur me qëllim transparencën, por ato nuk do të analizohen në mënyrë të detajuar nga grupi i auditimit;

⁴⁵ Në zërat e buxheti është përfshirë buxheti faktik i realizuar për vitin respektiv;

⁴⁶ Numri total i të paraburgosurve dhe i të dënuarve në IEVP-të të cilat trajtojnë të paraburgosur;

⁴⁷ Numri total i të paraburgosurve në IEVP-të të cilat trajtojnë të paraburgosur;

⁴⁸ Buxheti faktik vjetor për të paraburgosurit është përllogaritur si shumë e buxhetit të dedikuar të paraburgosurve për çdo IEVP. Buxheti i dedikuar të paraburgosurve në çdo IEVP është përllogaritur në përputhje me përqindjen që zënë të paraburgosurit kundrejt totalit të të burgosurve në çdo IEVP, vetëm për shpenzimet e personelit dhe shpenzimet operative, duke mos përfshirë shpenzimet kapitale;

periudhe, numri i të paraburgosurve që trajtohet në këto I EVP ka pësuar rritje, ku në vitin 2021 kanë qenë +19% të paraburgosur më shumë se në vitin 2020.

Bazuar në materialet e audituara nga grupi i auditimit mbi dokumentacionin e hartuar për përgatitjen e PBA-së së DPB-së, e cila bazohet kryesisht në paraqitjen e kërkesave nga I EVP-të (që zënë 65% të buxhetit total të DPB-së), **konstatohet se nuk ka një përafrim të nevojave të paraqitura për fonde të destinuara veçanërisht për artikullin 602 “Shpenzime operative”**. Pjesën më të madhe e zë trajtimi me ushqime, veshmbathje, mirëmbajtja godinës dhe ambienteve të trajtimit të dënuarve dhe paraburgosurve, si dhe shpenzimet e tjera, si ujë i pijshëm, energji elektrike, etj.

Fakti që gjatë vitit buxhetor, bëhen alokime të fondeve (shitesa/pakësime) me vlera të konsiderueshme, tregon qartë se hartimi i PBA-së nuk e ka arritur qëllimin. Ky fakt, në njërin anë tregon për mungesë argumentimi, por nga ana tjetër dhe për mungesë fondesh të akorduara. Pamundësia e financimit të DPB dhe I EVP-vë sipas nevojave të tyre shpesh herë është përkthyer edhe në vështirësi financiare në shërbimet parësore për personat e paraburgosur e të dënuar.

E gjithë analiza e përgatitjes së PBA-së nga I EVP-të, duhet të mbështetet e referohet në kostot faktike të vitit mëparshëm dhe në raport me numrin e të dënuarve dhe paraburgosurve, duke argumentuar analitikisht dhe nevojën e vlerës së financimit nga buxheti i shtetit. Këtu për zërin “Investime kapitale” PBA-ja është hartuar mbështetur në propozimet e I EVP-ve, por dhe në strategjinë që ka DPB për rritjen e kapaciteteve të trajtimit të dënuarve dhe paraburgosurve e përmirësimin dhe përafrimin e kushteve të tyre me kërkesat e kohës dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Parlamenti për këtë qëllim. Më qartësisht, problematikat e konstatuara sa i përket financimit të I EVP-ve me fonde buxhetore pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur edhe në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 4: Pasqyra e analizës buxhetore të PBA-së (kërkesave buxhetore dhe realizimi në fakt për vitet 2019-2021)

mijë/lekë

Nr	Art.	Emërtimi	Viti 2019		Viti 2020		Viti 2022	
			PBA	Fakti	PBA	Fakti	PBA	Fakti
1								
2	600/601	Paga +sig sh,	5.874.691	3.951.068	5.868.916	3.363.326	5.827.000	4.208.192
3	602	Shpenz. operative	1.434.574	1.479.951	1.413.574	1.193.451	1.471.658	1.169.200
Totali			7.309.265	5.431.109	7.282.490	4.556.777	7.298.658	5.377.392
Mos financimi në vlerë e %			-1.878.246 ose 74.3%		-2.725.713 ose 62.6 %		-1.921.266 ose 73.7%	

Burim: DPB/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga kërkesat buxhetore të bëra vetëm për këto dy zëra të buxhetit në tre vite, konstatohet se financimi më i ulët ka qenë në vitin 2020 në vlerë – 2.725.713 mijë lekë ose 62.6% të kërkesave buxhetore bërë nëpërmjet PBA-së dhe në dy vitet e tjera 2019 e 2021 mos financimi ka qenë në të njëjtat nivele, përkatësisht në vlerën -1.878.246 mijë lekë ose dhe në vlerën – 1.921.266 mijë lekë ose 73.7 % të nevojave. Ky fakt ka sjellë mungesë burimesh njerëzore dhe mungesë të infrastrukturës së nevojshme për të përmbushur detyrimet ligjore në shërbim të trajtimit të paraburgosurve dhe të dënuarve.

Mbështetur në dokumentacionin dhe të dhënat e vëna në dispozicion nga DPB, grupi i auditimit analizon nëpërmjet metodës krahasimore të dhënat e I EVP-ve të cilat janë të dedikuara vetëm për ofrimin e shërbimit të paraburgimit, si dhe të dhënat e I EVP-ve të tjera, të cilat trajtojnë si personat e paraburgosur ashtu edhe të dënuarit, për të vlerësuar në mënyrë objektive peshën që zënë shpenzimet dhe investimet e kryera në sektorin e paraburgimit në raport me investimet në total.

Sa kaq, numri më i lartë i të paraburgosurve për vitin 2021 ishte në I EVP-të “Jordan Misja” në Tiranë (434 të paraburgosur), I EVP Fushë Krujë (308 të paraburgosur), I EVP Fier (264 të paraburgosur), I EVP Korçë (243 të paraburgosur), etj.

Në IEVP të tilla si Kukësi, Tropoja dhe Kavaja, megjithëse kapacitetet mbajtëse dhe infrastruktura e ngritur (ku bëjnë pjesë ambientet dhe burimet njerëzore) kanë qenë më të larta në numër, në fakt numri i paraburgosurve është më i ulët. Kjo ka sjellë rritjen e kostos për një të paraburgosur, ku sipas treguesve të marrë në analizë në këto IEVP kemi kosto më të larta, krahasuar me koston mesatare 2,401 lekë në ditë për çdo të paraburgosur, gjë që tregon për mungesë të theksuar analize dhe efektiviteti të administrimit dhe shfrytëzimit të kapaciteteve të IEVP-ve.

Duke qenë se IEVP të ndryshme kanë buxhete në vlera të ndryshme dhe trajtojnë numra të ndryshëm të paraburgosurve, nxjerrja e një kostoje mesatare për të paraburgosurit në nivel sistemi, nuk do të përfaqësonte në mënyrë plotësisht të drejtë koston për të paraburgosurit për çdo IEVP. Për këtë arsye, grupi i auditimit ka përllogaritur shpenzimet ditore për 1 të paraburgosur në nivel IEVP-je (trajtuar më hollësisht në seksionin “Pesha në Buxhet”).

Analiza e Buxhetit të DPB-së për vitin 2019

Për vitin vitit 2019 Fondet buxhetore 12-mujore janë realizuar në masën 102 % nga Plani i miratuar me datë 01.01.2019 në vlerë 5.746.174 mijë lekë dhe realizimi është 5.857.919 mijë lekë. Vlerë kjo e realizuar pozitivisht dhe nga ri-alokimet e mirë studiuar nga sektori i financës ku kemi pasur shtesa në vlerën +346.940 mijë lekë dhe pakësim -235.095 mijë lekë. Peshën më të madhe e zënë fondi i pagave me + 60.000 mijë lekë dhe shpenzimet operative në vlerë ndryshuese +45.375 mijë lekë. Në “Shpenzimet kapitale” kemi një vlerë të vogël ndryshueshmërie negative -3.000 mijë lekë.

Analiza e Buxhetit të DPB-së për vitin 2020

Për vitin vitit 2020 Fondet buxhetore 12-mujore janë realizuar në masën 95.81%, tregues ky i nxjerrë në analizë me raportin e pakësimeve nga Plani i miratuar me datë 01.01.2019 në vlerë 5.637.290 mijë lekë dhe realizimi është 5.621.093 mijë lekë. Vlerë kjo e realizuar pozitivisht dhe nga ri-alokimet, ku kemi pasur shtesa në vlerën +242.188 mijë lekë dhe pakësime – 258.385 mijë lekë. Peshën më të madhe e zënë “Shpenzimet operative” në vlerë ndryshuese +131.438 mijë lekë dhe pakësime në vlerën 125.439 mijë lekë dhe “Shpenzimet kapitale(investime)” me shtesa në vlerë +71.393 mijë lekë dhe pakësime – 91.393 mijë lekë. Në “Shpenzime personeli” kemi një vlerë të vogël ndryshueshmërie negative -20.000 mijë lekë.

Diferenca e mos realizimit të përdorimit të buxhetit, ka ardhur nga mos realizimi i kontratave që janë në varësi të AKSH-it. Mungesa e fondeve tek shpenzimet korrente për vitin 2020 (viti pandemik Covid 19) janë përballuar duke planifikuar dhe miratuar nevojat sipas prioriteteve dhe shërbimeve jetike për sigurimin e nevojave në shërbimin e trajtimit të të dënuarve dhe janë kryer ri-alokime të fondeve buxhetore në DPB. Nuk u konstatuan mangësi në dinamikën e procesit për ri-alokimin e fondeve sipas nevojave dhe kërkesave të paraqitura nga IEVP-të në DPB dhe në Ministrinë e Drejtësisë.

Analiza e Buxhetit të DPB-së për vitin 2021

Fondet buxhetore si 12-mujor janë realizuar në masën 96.41%. Mungesa e realizimit të buxhetit këtë vit ka ardhur nga mos kryerja e pagesës në kohë të situacioneve për investimet e kryera në IEVP Lezhë, pasi vonesat kanë qenë në marrjen në dorëzim të rikonstruksionit të kryer nga grupi i punës, të cilët kanë monitoruar realizimin e punimeve sipas kushteve të kontratave.

Në analizën e përdorimit të buxhetit është konstatuar se gjatë vitit ka pasur mungesë të fondeve në artikullin 602 “Shpenzime operative” sipas planit të miratuar në fillim të vitit 2021, ku ky problem është kaluar me mirë menaxhimin e fondeve që ka pasur në dispozicion institucioni.

Është hartuar dokumenti i PBA-së 2022-2024 dhe janë respektuara afatet kohore për dërgimin në Ministrinë e Drejtësisë në të dy fazat e saj, në zbatim të kërkesave të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

Për vitin 2022 bazuar dhe në situatën që të dhënat nuk janë të plota dhe nuk është mbyllur viti ushtrimor, grupi i auditimit të KLSH trajtoj vetëm ato probleme që kanë rëndësi specifike dhe në mënyrë statistikore.

Mbështetur në Ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, fondet buxhetore të miratuara për vitin 2022 për DPB janë gjithsej 6.277.100 mijë lekë të ndara sipas shpenzimeve.

- Shpenzime personeli page dhe sigurime (art.600+601) në vlerën 4.489.000 mijë lekë.
- Shpenzime operative (art.602-606) në vlerën 1.357.200 mijë lekë.
- Shpenzime kapitale (art.230-231) në vlerën 430.900 mijë lekë.

Në zbatim të Aktit Normativ nr.3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.115/2021 Për Buxhetin e vitit 2022” është kryer pakësim buxheti për sistemin e burgjeve për vitin 2022 në shumën 308.925 mijë lekë, kryesisht janë pakësuar shpenzimet korente dhe ato kapitale si vijon:

Pakësimi i fondeve tek zëri “ Shpenzimet operative” për sistemin e burgjeve ka rezultuar me risk të lartë për vitin buxhetor në vazhdim, kjo për faktin se 45% e vlerës së miratuar të buxhetit për vitin 2022 janë kontrata të detyruara në sistemin e thesarit dhe likuidimi i tyre realizohet çdo muaj për mallin e furnizuar me ushqimet e të dënuarve, furnizimin me gaz për gatim dhe larje për të dënuarit, furnizimin me karburant, mirëmbajtjen e sistemit të Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore etj. Këto shpenzime janë të planifikuara në buxhetin e njësisë shpenzuese të D. P. Burgjeve. Gjatë muajit korrik janë pritur edhe kontrata të reja për furnizimet me ushqime të freskëta (loti bukë e bulmet vezë) dhe furnizimin me gaz për gatim për 6 mujorin e dytë të vitit, pasi kontratat e nënshkruara janë deri në datë 01 Korrik 2022, pas kësaj date nuk mbulohet furnizimin për këto artikuj. Pakësimi i fondeve nga Qeveria, ka sjellë përballje edhe me pamundësinë e regjistrimit/likuidimit të kontratave, duke vështirësuar plotësimin e kërkesave jetike të dënuarve dhe paraburgosurve.

Gjithashtu, shpenzimet mujore të furnizimit me energji elektrike, ujë për Sistemin e Burgjeve zënë **38%** të planit total të shpenzimeve dhe fondi është i pamjaftueshëm. Fondi i këtyre shpenzimeve për këtë vit buxhetor rezulton i pamjaftueshëm, kjo edhe për faktin se është rritur çmimi i energjisë nga muaji Janar 2022 e në vazhdim, e cila rezulton me rritje mesatarisht prej +10 lekë/kw (Energjia Aktive është rritur nga 11 lekë/kw në 18.80 lekë/kw dhe Energjia Pik nga 12.65 lekë/kw në 21.62 lekë/kw). Mungesa e fondeve dhe mos pagesa e faturave mujore ndaj FSHU rrit riskun e ndërprerjes së energjisë në IEVP-të, gjë që i vendos këto institucione në kushtet e cenimit të rëndë të sigurisë dhe aktivitetit të sistemit të burgjeve si institucion shtetëror i rëndësisë së veçantë.

Sa kaq, realizimi i fondeve buxhetore për 6-mujorin e parë të vitit 2022, për programin e Sistemin e Burgjeve është në masën 47.09%, sipas të dhënave tabelare të pasqyruara më poshtë.

Infografik nr. 14: Realizimi i Fondeve të Programit



në mijë lekë

Burimi: Grupi i auditimit

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për vitin buxhetor të rishikuar, për programin e burgjeve janë në shumën prej 360.900 mijë lekë. Realizimi/likuidimi rezulton me 16.53% për 6 mujorin. Projektet e planifikuara për vitin 2022, për programin e burgjeve janë:

“Blerje automjesh për sistemin e burgjeve”, buxhet i rishikuar 99.350 mijë lekë, planifikuar për blerjen e auto burgjeve dhe autoambulancës për D. P. Burgjeve dhe blerjen e një automjeti për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve. Vlera është në proces tenderimi për projektet të planifikuara për vitin 2022 tek Njësia e prokurimit të DPB dhe tek Njësia e Përqendruar ABP për automjetin e SHKBB-se. Bazuar në të dhënat e situatës financiare ecurisë së plan-fakt si 6 mujor për vitin 2022, kryesisht për investimet dhe shpenzimet operative, konstatohet se ka problematika në kuadër të shpenzimeve operative në programin e burgjeve, për periudhën në vazhdim të vitit 2022, duke i vënë në mungesë likuiditeti për shërbimet që priten të prokurohen sipas nevojave të planifikimit, konkretisht:

- Miratimi i buxhetit më të ulët me ligjin e buxhetit në raport me tavanin e fazës së dytë të PBA-së, ku është miratuar më pak në shumën prej 150.000 mijë lekë për programin buxhetor të burgjeve.

- Pakësimi me Aktin Normativ Nr.3, datë 12.03.2022 në vlerën 126.970 mijë lekë për programin e burgjeve.

- Përballja me rritjen e çmimit të energjisë elektrike me +10 lekë/kw

- Përballja me rritjen e çmimit të naftës, benzinës për mjete transporti dhe gazit për gatim, etj.

Për përballimin e nevojave dhe sigurimin e shërbimeve e mallrave në funksion të të dënuarve për sistemin e burgjeve nevojiten fonde shtesë nga Qeveria. Referuar të dhënave të përcjella nga DPB, gjatë periudhës 2020-Korrik 2022, nuk janë kryer investime për sektorin e paraburgimit, pra nuk kemi investime me destinacion e cilësim “Paraburgimi”, kjo për faktin që siç e kemi theksuar edhe më lart nuk kemi një ndarje të veçantë të fondeve që përdoren për paraburgimin dhe veçmas për të dënuarit. Kjo ka vështirësuar punën audituese pasi mungon gjurma e auditimit. Trajtimet që kemi bërë më lartë si për buxhetin dhe për kostot janë llogaritur nga jashtë, pra në mënyrë analitike.

Për periudhën objekt auditimi është kryer vetëm një investim në vitin 2019, kjo në IEVP “Jordan Misja”, Tiranë në vlerën 5,400 mijë lekë. Ky tregues evidentohet lehtas dhe në Shtojcën nr. 2 “Tabela me të dhënat për buxhetin e paraburgimeve për vitet 2019-2022” bashkëlidhur këtij dokumenti.

Mungesa e gjurmëve të auditimit për regjistrimin dhe dokumentimin e përdorimit të buxhetit në sistemin e burgjeve, kryesisht në ndarjen e buxhetit të shpenzimeve që kryhen veçmas për sektorin e paraburgimit, në matjen analitike për çdo IEVP dhe në Sektorin e financës në DPB, ka sjellë mungesën e një pasqyre analitike të shpenzimeve që kryhen dhe pamundësimin e stafit drejtues e menaxhues si në IEVP-të dhe në DPB për të kryer analiza e vlerësime për përmirësimin e menaxhimit dhe rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në sistemin e paraburgimit. Mbajtja në mënyrë analitike e të dhënave ekonomiko financiare për sistemin e burgjeve do të lehtësonte punën e të gjithë stafit për orientim të bazuar në të dhëna të sakta dhe do të evidentonte më lehtësisht se sa para janë përdorur për trajtimin e të paraburgosurve dhe sa janë nevojat. Mungesa e kësaj gjurme auditimi ka treguar se DPB nuk ka arritur të sigurojë dokumentimin e plotë të operacioneve në formë të tillë që t’u mundësonte audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptonin mjedisin e kontrollit në sistemin e paraburgimit.

Njëkohësisht, nga Sektori i Financës është kryer një evidencë për vlerësimin e kostove të ndara e llogaritura me koeficient shpërndarje, por mundësitë janë për të hartuar një dokumentacion sa më të plotë analitik. Sqarojmë se nuk kontestojmë punën e këtij sektori si në cilësi dhe në volum, por metodat e reja bashkëkohore kërkojnë plotësimin analitik të regjistrimit e dokumentimit të aktivitetit të DP Burgjeve e njësive vartëse, për sektorin e paraburgimit në sistemin e burgjeve, duke ndikuar në rritjen e nivelit të trajtimit të tyre me dinjitet dhe në përputhje me të drejtën kushtetuese e kërkesat e Konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

Gjetje:

9. DPB dhe IEVP-të nuk kanë kryer një analizë dhe shpërndarje proporcionale të të paraburgosurve, sipas kapaciteteve dhe infrastrukturës së ngritur.
10. Në analizën e shpenzimeve të kryera për realizimin e përdorimit të fondeve buxhetore të planifikuara, është konstatuar se nuk ka patur bashkëpunim të organizuar e koordinuar me Agjencinë e Prokurimeve të Përqendruara për kryerjen e prokurimeve në kohë dhe lëvrimin e tyre, për blerjen e 4 auto burgjeve, një autoambulancë, blerje uniforme policie dhe material kazermimi për të dënuarit dhe paraburgosurit dhe shërbime të tjera.
11. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka mbajtur e dokumentuar në mënyrë analitike të dhënat ekonomiko financiare të sektorit të paraburgimit (veçmas) për të pasur një pasqyrë të saktë analitike të shpenzimeve e kostos faktike për një të paraburgosur dhe ndarë sipas IEVP-ve.
12. Në lidhje me realizimin e nën objektivit 4.3.4 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 nuk është bërë asnjë progres dhe nuk është gjeneruar asnjë nga produktet e kërkuara, edhe pse dokumenti strategjik ndodhet në vitin e dytë të zbatimit të tij.

Konkluzione:

- Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet DPB dhe Agjencisë së Prokurimeve të Përqendruara për respektimin e afateve ligjore dhe mundësive të paraqitjes së nevojave, ka sjellë për pasojë, që lëvrimi i mallrave dhe kryerja e shërbimeve mos të bëhet në kohën e duhur, duke cenuar shërbimet ndaj të dënuarve dhe paraburgosurve. Këto mangësi kanë ndikuar në mos përmbushjen e detyrimeve ndaj të dënuarve dhe paraburgosurve, duke i privuar nga të drejtat e tyre ligjore.
- Mungesa e gjurmës së auditimit ka sjellë si pasojë mungesën e gjurmës së auditimit, duke bërë që audituesit të mos kuptojnë drejt mjedisin e kontrollit dhe stafit drejtues e menaxherial të njësive publike të mos ngrejë një sistem kontrolli (hierarki/vertikal) në mënyrë efikase e mbështetur në të dhëna e tregues sa më të besueshëm, pasi treguesit e gjeneruar manualisht nga sektori i financës janë të njëanshme.
- Mungesa e progresit në lidhje me analizën e situatës së kontrollit të brendshëm financiar në shërbimin e burgut, jo vetëm që cenon realizimin e një objekti strategjik, por pengon edhe institucionet e përfshira të krijojnë një panoramë të mirëfilltë dhe vlerësim të detajuar të situatës.

Rekomandim nr. 8:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, të kryejnë analiza të llogaritjes së kostove të trajtimit të paraburgosurve dhe të programojë shpërndarjen e tyre.

Brenda Qershorit 2023

Rekomandim nr. 9:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të hartojnë regjistra dokumentimi të treguesve ekonomiko financiar veçmas për sektorin e paraburgimit dhe për trajtimin e të burgosurve, duke siguruar kështu të dhëna të plota e të besueshme për menaxhimin e sektorit të paraburgimit, si dhe të bashkëpunojë me Agjencinë së Prokurimeve të Përqendruara, për zhvillimin e procedurave të prokurimit brenda afateve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi nr. 10:

Ministria e Drejtësisë të marrë masa për kryerjen e një analize, në lidhje me mbikëqyrjen dhe kontrollin e brendshëm financiar në shërbimin e burgut, duke hartuar kështu regjistra risku, në zbatim detyrimeve që burojnë nga Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1.2.1 A ka qenë DPB dhe IEVP-të efektive në mirë administrimin e sistemit penitenciar?


Sistemi i burgjeve dhe i paraburgimit (sistemi penitenciar) është pjesë e rëndësishme e sistemit të drejtësisë penale. Në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 79/2020 “Për ekzekutimet e vendimeve penale”, në paraburgim vendosen personat që kanë marrë masën e sigurisë “*arrest me burg*”⁴⁹ dhe janë në pritje të gjyqimit.

Sistemi penitenciar në Shqipëri ka për mision të kontribuojë për një shoqëri të sigurt, nëpërmjet zbatimit efektiv e në mënyrë humane të masave të sigurisë e dënimeve penale, me qëllim krijimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues dhe garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Çdo shoqëri demokratike ka për detyrë të ndërtojë strukturat kushtetuese, ligjore dhe shoqërore që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave themelore të shtetasve.⁵⁰ Nga fillimi i proceseve demokratike e deri në ditët e sotme vihet re një rritje e shërbimeve të ofruara për personat e paraburgosur dhe përmirësim i standardeve të trajtimit të tyre.

Në vitin 2007 sistemi i paraburgimit kaloi në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, sistem ky, i cili deri në këtë vit ishte në varësinë e Ministrisë së Brendshme. Konkludimi i këtij procesi dhe kalimi i sistemit të paraburgimeve dhe burgjeve nën varësinë e MD-së, solli përmbushjen e një nga rekomandimeve më të rëndësishme të institucioneve ndërkombëtare.⁵¹

Drejtimin e sistemit penitenciar Ministria e Drejtësisë e realizon nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. DPB ndjek dhe realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit penitenciar dhe trajtimin e personave që ju është kufizuar liria, me qëllim sigurimin e një trajtim njerëzor të këtyre personave. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është organ qendror, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, e cila organizon, drejton dhe kontrollon të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP-të).



Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP-të), mbi bazën e kategorisë së subjekteve ndaj të cilave ekzekutohen vendimet penale, ndahen në:⁵²

- a) institucione për të dënuarit e rritur;
- b) institucione për të dënuarit e mitur;**
- c) institucione për gratë;**
- ç) institucione të paraburgimit;**
- d) institucione të kujdesit shëndetësor për të burgosurit.

⁴⁹ Ligji nr. 81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”, neni 21 - “Institucionet e paraburgimit janë institucionet ku mbahen individët ndaj të cilëve gjykata ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”;

⁵⁰ “Qeveritë demokratike nuk duhet të kenë si mision njohjen e të drejtave të shtetasve të saj, por mbrojtjen e tyre”- Tomas Xheferson;

⁵¹ Kujtojmë se në faza të hershme, sistemi i burgjeve dhe paraburgimit ka qenë në varësi të Ministrisë së Brendshme. Të gjitha stukturat që nga momenti i arrestimit, hetimit e deri në ekzekutimin e dënimeve ishin brenda një piramide hierarkike, në krye të së cilës ishte MB;

⁵² Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 15;

Nga sa më sipër, si dhe referuar praktikave e standardeve ndërkombëtare të përcaktuara, fëmijët nën moshën 18 vjeç nuk duhet të mbahen në të njëjtat ambiente me të rriturit, por në mjedise të ngritura posaçërisht për trajtimin e tyre. Për këtë qëllim, në tetor të vitit 2009 u hap Institucioni i të Miturve Kavajë, i cili shërben si një qendër rehabilitimi, këshillimi dhe shkolle për të miturit në konflikt me ligjin.

Gjithashtu edhe gratë mbahen në institucion të posaçëm. Lidhur me këtë fakt, nëpërmjet urdhërit të Ministrit të Drejtësisë "Për kategorizimin e Institucioneve të Ekzekutimeve Penale", IEVP "Ali Demi" është kategorizuar si burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion për gratë e dënuara dhe një seksion për gratë e paraburgosura me fëmijë deri në moshën 3 vjeç.

Krijimi, klasifikimi dhe mbyllja e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim ose seksioneve të veçanta në këto institucione bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Referuar Urdhërit nr. 8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë "Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale", i ndryshuar, seksione paraburgimi kanë IEVP-të e mëposhtme:

1. IEVP "Ali Demi";
2. IEVP Fushë Krujë;
3. IEVP Burrel;
4. IEVP Tepelenë;
5. IEVP Sarandë;
6. IEVP Tepelenë;
7. IEVP Peqin;
8. IEVP Lezhë;
9. IEVP Korçë;
10. IEVP Vlorë;
11. IEVP Durrës;
12. IM Kavajë;⁵³
13. IEVP Fier;
14. IEVP Berat; dhe
15. IEVP Shkodër – Reç.

Ndërkohë që IEVP e mëposhtme janë institucione vetëm paraburgimi:

1. IEVP "Jordan Misja";
2. IEVP "Mine Peza";
3. IEVP Kukës; dhe
4. IEVP Elbasan.

Përcaktimi i IEVP-ve, në rastin konkret i institucioneve të paraburgimit, bëhet në përputhje me pozicionimin e Komisariateve të Policisë dhe të Gjykatave pranë të cilave do të gjykojnë të paraburgosurit, me qëllim për të garantuar të drejtën e vendqëndrimit të tyre në një IEVP sa më afër vendbanimit, për të plotësuar nevojat e realizimit të procedurës së hetimit penal dhe gjyqimit me kosto sa më të ulët (kohë dhe shpenzime) dhe për ofrimin e një sigurie sa më të lartë.

Metodologjia kryesore në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për këtë nënpyetje auditimi ishte zhvillimi i intervistave dhe pyetësorëve në të gjitha IEVP-të që ofrojnë shërbim paraburgimi dhe DPB, si dhe vëzhgimi i regjime të brendshme të IEVP-vë, në sektorët e paraburgimit.

Nëpërmjet Urdhërit nr. 551, datë 10.10.2022 "Për një shtesë dhe disa ndryshime në Urdhrin nr. 8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë, "Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale", i ndryshuar, IEVP Tropojë dhe Sarandë, të cilat ofronin edhe shërbim paraburgimi, janë mbyllur. Për rrjedhojë, pavarësisht faktit se grupi i auditimit ka kryer vizita

⁵³ Institucioni i të Miturve;

vëzhguese edhe në këto institucione gjatë fazës studimore, problematikat e konstatuara në to nuk janë trajtuar në këtë raport.

Kriteret dhe standardet e paraburgimit dhe të burgjeve, të cilat duhet të shërbejnë si mision kryesor në përmbushjen e detyrimeve ligjore të IEVP-ve, janë tre:

- Garantim i sigurisë;
- Kushtet e trajtimit; dhe
- Kushtet për ofrimin e programeve rehabilituese aktivitete, shkollim, workshope, etj.

1. Garantimi i Sigurisë

Një nga aspektet me të cilat bëhet vlerësimi i situatave dhe garantohet siguria në sistemin penitenciar është monitorimi.

Të vëzhguarit është aftësia për të vërejtur dhe për të kuptuar paraqitjen e të burgosurit, sjelljen dhe mjedisin. Vëzhgimet kanë impakt jo vetëm në garantimin e sigurisë e ofruar në institucion, por njëkohësisht vëzhgimi i kujdesshëm i veprimeve flet rreth asaj që kemi nevojë të dimë lidhur me personat e burgosur, karakteristikat dhe problematikat që ata paraqesin.

Mënyra si sillen një individ është një shenjë jo verbale, që personi të cilit i është kufizuar liria jep teksa është i ndërgjegjshëm dhe aktiv. Marrja në analizë e të gjitha shenjat vizuale që lidhen me paraqitjen dhe sjelljen, ndikon pozitivisht në parandalimin e situatave në mjediset e burgut.

Me qëllim monitorimin e ambienteve, grupi auditimit konstaton se IEVP-të kishin marrë masa për vendosjen e kamerave në çdo ambient të brendshëm dhe të jashtëm të IEVP-së, duke mundur kështu një mbulim të plotë për një mbikëqyrje në kohë reale, me qëllim parandalimin dhe zgjidhjen e situatave të ndryshme që mund të cenojnë sigurinë e brendshme nga punonjësit e sigurisë.

Nga analiza e kryer në lidhje me funksionimin dhe efektivitetin e sistemit të kamerave, grupi i auditimit konstaton se:

- Rojet e sigurisë që kryejnë shërbim në çdo katë të godinave me vendqëndrime statike (tavinë, karrige) dhe me 2 sektorë shërbimi, nuk kanë monitorë që tu ofrohen pamjet e kamerave që monitorojnë sektorët e tyre të shërbimit, duke bërë të pamundur përmbushjen e plotë të detyrës, nga ana e personelit të shërbimit, në lidhje me vëzhgimin e pandërprerë dhe konstatimin e situatave në kohë reale në sektorët e tyre të shërbimit.

- Në sallat operative ishin të vendosur monitorët të cilët ofronin pamje të kamerave. Pavarësisht numrit të lartë të monitorëve, grupi i auditimit konstaton se çdo monitor ishte ndarë në ikona duke ofruar pamje të nëntë kamerave në kohë reale, kur në total çdo monitor ishte i lidhur me gjashtëmbëdhjetë kamera.⁵⁴ Për rrjedhojë, pamjet e shtatë kamerave të tjera, shikoheshin vetëm në mënyre manuale dhe shikimi i tyre zhvendoste pamjet e nëntë kamerave të tjera. Faktor tjetër, që ndikonte në efektivitetin e sistemit monitorues ishte edhe fakti se në sallën operative ishin vetëm dy operatorë. Numri i madh i kamerave për monitorim, monitorimi i tyre vetëm nga dy operatorë brenda një turni dhe qëndrimi me orare të zgjatura vëzhgimi nga ana e operatorëve, ul vigjilencën dhe cenon efektivitetin e procesit monitorues.

Problematikë tjetër e konstatuar gjatë punës audituese ishin edhe vakancat në stafin policor të angazhuar në IEVP (Shkodër 85 vakanca; Fier 69; Peqin 52; Elbasan 11; Burrel 8; Korçë 32; Durrës 15; Lezhë 18; etj.). Neni 29 i ligjit nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”, përcakton kriteret për pranimin në Policinë e Burgjeve, ku ndër të tjera në pikën “ë” të tij parashikohet se: *“Ka të drejtë të konkurrojë për t’u pranuar në Policinë e Burgjeve çdo person që është nën moshën 35 vjeç”*.

Përcaktimi i një kriteri të tillë përjashtues, i cili vendos një tavan lidhur me moshën e kandidatëve që konkurrojnë në Policinë e Burgjeve ka reflektuar një numër shumë të madh vakancash në këtë sistem,

⁵⁴ Rasti i referuar- IEVP “Jordan Misja”;

duke sjellë për pasojë mungesë eficiencë dhe efektiviteti në përmbushje të detyrave institucionale të IEVP-ve, të cilat reflektohen në cenim të të drejtave të personave të paraburgosur, si edhe në mbingarkesa të stafeve ekzistuese me qëllim mbulimin e sektorëve. Lidhur me këtë fakt, me qëllim realizimin me efektivitet dhe eficiencë të objektivave institucional, DPB të marrë masa për shfuqizimin e pikës që parashikon kriterin “nën moshën 35 vjeç”, për pranim në Policinë e Burgjeve.

2. Kushtet e Trajtimit

Shtetet dhe institucionet shtetërore (pjesë e të cilave është dhe DPB dhe IEVP-të) duhet të përmbushin detyrimet e tyre ndërkombëtare dhe kombëtare, me qëllim që të çojnë përpara dhe të garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Të drejtat e personave që ju është kufizuar liria nuk janë privilegje që mund të hiqen apo të mohohen. Qëllimi i trajtimit të personave në paraburgim është ruajtja e shëndetit të tyre, vetë respektit, dinjitetit, zhvillimi i ndjenjës së përgjegjësisë si dhe nxitja e aftësive që mund t'i ndihmojë ata të rikthehen në shoqëri pas lirimit me mundësi të larta për të jetuar duke respektuar ligjin.

• *E drejta për jetën, integritetin e personit dhe respektin e dinjitetit njerëzor* - *Mbipopullimi*

*“Mjediset që u ofrohen të burgosurve dhe në veçanti mjediset e fjetjes duhet të respektojnë dinjitetin njerëzor dhe, sa më shumë të jetë e mundur, privatësinë, si dhe plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës, hapësirës së nevojshme, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit”.*⁵⁵

Në këtë drejtim, standardet e KPT-së specifikojnë se për çdo individ të paraburgosur duhet të respektohen hapësirat, si më poshtë:

- 6m² hapësirë jetese për një qelizë me strehim të vetëm; dhe
- 4m² hapësirë jetese për çdo të burgosur në një qeli me strehim të shumëfishtë.⁵⁶

Standardi minimal i hapësirës së jetesës duhet të përjashtojë ambientet sanitare brenda një qelie. Rregullorja Europiane e Burgjeve, në rregullin 18.5 të saj, thekson se: *“Të burgosurit normalisht duhet të vendosen gjatë natës nëpër qeli të veçanta, përveç rasteve kur është e preferueshme për ata që ta ndajnë ambientin e fjetjes”.*

Gjatë periudhës objekt auditimi, numri i të paraburgosurve ka pësuar rritje, ku në vitin 2021 kanë qenë 19% të paraburgosur më shumë se në vitin 2020. Për shkak të numrit të madh të caktimit të masës së sigurisë “*arrest me burg*”, sistemi i paraburgimit në Shqipëri ka vuajtur gjithmonë nga mbipopullimi. Mbipopullim, së pari do të thotë vështirësi për respektimin e kriterëve të detyrueshme ligjore për ndarjen e personave të paraburgosur dhe respektimin e hapësirës së nevojshme për banim.

Pavarësisht faktit se nga të dhënat e vëna në dispozicion, MD dhe DPB shprehen se aktualisht sistemi i paraburgimit është nën kapacitet, nga vëzhgimet e kryera në terren, grupi i auditimi konstaton mbipopullim në shifra alarmante dhe problematike të sektorëve të paraburgimit pothuajse në të gjitha IEVP-të që ofrojnë shërbim paraburgimi. Vetëm IM Kavajë, IEVP Reç dhe “Ali Demi” ndodheshin nën kapacitet. Ndërkohë që, IEVP Burrel, Kukës dhe Korçë kishin një diferencë shumë të vogël në numrin e personave të akomoduar në paraburgim krahasuar me kapacitetet institucionale. Të gjitha IEVP-të e tjera, sikurse paraqiten edhe në tabelën e mëposhtme ishin të mbipopulluara, me numër të paraburgosurish të akomoduar përtej kapaciteteve institucionale. Numri i personave në çdo dhomë banimi në sektorët e paraburgimit varioonte nga 4-10 persona.

⁵⁵ Ligji nr. 81/2020, neni 33 pika 1;

⁵⁶ KPT më 1990 zhvilloi një standard bazë për përmasat minimale të hapësirës së jetesës që një të burgosuri duhet t'i jepet në një qeli;

Tabelë nr. 7: Mbipopullimi në IEVP-të që ofrojnë shërbim paraburgimi

	Kapacitet	Aktualisht ⁵⁷
1. Kavajë	40	17
2. Durrës	224	280
3. Lezhë	126	137
4. Peqin	144	191
5. Burrel	78	72
6. Ali Demi	138	60
7. Jordan Misja	420	460
8. Elbasan	144	161
9. Fier	180 ⁵⁸	250
10. Vlorë	154	168
11. Berat	71	94
12. Mine Peza	170	175
13. Korçë	202	201
14. Reç	800	558
15. Tepelenë	75	109
16. Fushë Krujë	312	380
17. Kukës	30	32

Burimi: Grupi i auditimit

Kjo problematikë e konstatuar, cenon gjithashtu respektimin e rregullit, që vendosja e të paraburgosurit në IEVP bëhet duke mbajtur parasysh kriterin e afërsisë së vendbanimit⁵⁹, duke shkaktuar kështu vështirësi jo vetëm për personat e paraburgosur por njëkohësisht edhe kosto për familjarët e tyre.

Njëkohësisht, pavarësisht të drejtës që gëzon çdo person që i është kufizuar liria për tu pajisur me një krevat dhe shtresat, mbulesat për fjetje, si pasojë e mbipopullimit në disa IEVP si Durrës dhe Kukës u konstatua fjetja në tokë, me batanije e personave të paraburgosur dhe mungesa e ofrimit të shtretërve nga ana e IEVP-ve.

Ndërkohë që, në IEVP Lezhë përveç krevateve marinarë (me dy shtretër) u konstatuan edhe krevate me tre shtretër fjetjeje, të cilët rriskojnë jetën e personave që i përdorin dhe nuk janë në përputhje me standardet e diktuar nga rregullat kombëtare e ndërkombëtare.

Në IEVP Fushë-Krujë, situata e rënduar për shkak të mbipopullimit përtej kapaciteteve institucionale, kishte sjellë për pasojë edhe përdorimin e shtretërve të ndodhur në infermieri, duke vështirësuar kështu dhe bërë të pamundur akomodimin në ambientet e infermierisë, në rastet e nevojës për personat e paraburgosur.



- Dhomat e Observimit:

I paraburgosuri apo i dënuari qëndron në dhomën e pranimit jo më shumë se 10 ditë, me qëllim vlerësimin e riskut dhe nevojave personale e kriminogjene të tij dhe më pas, vendoset në mjedisin e banimit.⁶⁰ KPT shprehet se individët e sapo pranuar duhet të shpërndahen në njësitë e zakonshme të akomodimit sa më shpejt që të jetë e mundur, menjëherë pasi të jetë vlerësimi i rrezikut dhe i

⁵⁷ Në këtë kolonë grupi i auditimit i referohet shifrave të konstatuara gjatë vizitave në terren;

⁵⁸ DPB me urdhër nr. 8785/1 datë 20.08.2021 ka hapur dhe një sektor në godinën A si sektor paraburgimi me një shtesë kapaciteti 36 vënde. Në total kapaciteti i IEVP Fier aktualisht është 216 vende;

⁵⁹ Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, neni 27;


⁶⁰ Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, neni 29;

nevojave. Për më tepër, kushtet për të ndaluarit e sapoardhur nuk duhet të çojnë në regjimin e izolimit për periudha të tej zgjatura kohe.

Në këtë drejtim, gjatë procesit të punës audituese, grupi i auditimit konstaton se ky rregull nuk zbatohet me rigorozitet nga I EVP-të, duke cenuar kështu të drejtat e personave të paraburgosur. Në disa nga I EVP-të që ofrojnë shërbim paraburgimi (psh. Durrës) dhomat e observimit përdoren si dhoma banimi për personat e paraburgosur, duke e kthyer kështu procesin e vlerësimit të riskut në një proces formal dhe duke cenuar në mënyrë të drejtë për drejtë të drejtat që duhet t'ju garantohen personave të paraburgosur, për shkak se kushtet e ofruara në këto ambiente nuk ishin në përputhje me standardet e kërkuara.

- Higjiena personale, dushe

Shërbimet higjienike në I EVP duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë kushtet normale për jetesë. Vendet ku kryhen këto shërbime pajisen me pajisjet hidro-sanitare të nevojshme dhe kanë ujë të rrjedhshëm. Shërbimet higjienike vendosen në mjedise të veçanta, të ndara nga mjediset e tjera ku zhvillohen veprimtari të përbashkëta dhe në raporte të përshtatshme me numrin e të burgosurve.⁶¹ Instalimet sanitare duhet të jenë të përshtatshme, në mënyrë që çdo person i paraburgosur të mund të përmbushë nevojat biologjike sa herë të jetë e nevojshme dhe në mënyrë të pastër e të përshtatshme, duke respektuar dinjitetin njerëzor. Instalimet e banjave dhe dusheve duhet të mundësojnë për çdo individ të drejtën e të bërit dush, sipas temperaturës së klimës si dhe sa herë të jetë e nevojshme për ruajtjen e higjienës së përshtatshme sipas stinës.



Sa më sipër, grupi i auditimit konstaton se në I EVP Fushë-Krujë mungojnë dushet dhe uji i ngrohtë. Ngrohja e ujit me qëllim përmbushjen e nevojave higjieno-sanitare nga personat e paraburgosur bëhet nëpërmjet rezistencave, të cilat në vetvete përbëjnë risk potencial për jetën e personave të akomoduar në paraburgim. E njëjta situatë problematike konstatohet edhe në I EVP Burrel, ku përveç mungesës së dusheve, mungonte edhe furnizimi me ujë, i cili kryhej nëpërmjet një zorre nga një dhomë banimi në tjetrën. Në këtë institucion personave të paraburgosur nuk ju mundësohej uji i ngrohtë, duke cenuar kështu të drejtat e garantuar në aktet ligjore e nënligjore dhe duke vështirësuar plotësimin e nevojave higjieno-sanitare.



Në I EVP Shkodër, Fier, Lezhë, vendosja e dusheve nuk respektonte privatësinë individuale të personave të paraburgosur. Duset ishin të organizuar pa ndarje (psh. në I EVP Shkodër ishin përdorur qese plastike me qëllim ndarjen e dusheve dhe krijimin e privatësisë), duke cenuar kështu dinjitetin njerëzor dhe respektimin e privatësisë së personave të paraburgosur.



⁶¹ Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, neni 82;

Dyert e tualeteve nga një IEVP në tjetrën nuk ishin sipas një modeli të standardizuar. Kështu, në IEVP Vlorë dyert e tualeteve nuk ishin të plota, por ishin të ngritura vetëm një metër nga toka. Në IEVP Tepelenë nuk kishte dyer me qëllim ndarjen e ambientit të tualetit nga ambienti i banimit. Ndërkohë që, në IEVP Elbasan, pavarësisht faktit se është një institucion i cili ka filluar të funksionojë në vitin 2012, dyert e tualeteve për shkak të një defekti teknik në zgavër nuk mund të mbylleshin dhe qëndronin të hapura. Nevoja për riparim të ambienteve të dusheve u konstatua edhe



në IEVP Kavajë.

Të gjitha rastet e parashtruara mësipër nga grupi auditimit, tregojnë trajtim të personave të paraburgosur jo në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi, duke cenuar kështu në mënyrë të drejtë për drejtë dinjitetin njerëzor, që duhet t'ju garantohet.

- Mungesa e sistemeve të ngrohjes


Të gjitha ambientet e strehimit në përdorim të të burgosurve dhe në veçanti të gjitha ambientet e fjetjes, duhet të përmbushin të gjitha kërkesat e nevojshme për jetesë, duke i kushtuar rëndësi të posaçme ngrohjes, ndriçimit dhe ventilimit.

Sa i përket sistemit të ngrohjes, në IEVP Kukës, Burrel, Fier, Elbasan, Fushë-Krujë, Peqin, Durrës, Lezhë, Shkodër, Vlorë, “Ali Demi” dhe “Jordan Misja” ngrohja realizohet me rezistenca individuale në dhomë.

Në IEVP Shkodër, Fier, Elbasan, Fushë-Krujë, Vlorë, Durrës dhe Lezhë, pavarësisht investimit dhe instalimit të sistemeve të ngrohjes me chiller, këto sisteme janë totalisht jashtë funksionit. Në intervistat e zhvilluara pranë IEVP-vë, subjektet parashtrojnë se kostoja e mirëmbajtjes së këtyre sistemeve është shumë e lartë dhe e papërballueshme nga të ardhurat buxhetore që këto institucione kanë të parashikuara në një vit kalendarik për mirëmbajtje. Investimi në sisteme, pa kryer më parë një analizë të kostos dhe mundësive financiare të IEVP-vë për mirëmbajtjen e tyre, jo vetëm ka sjellë jo vetëm mungesë të sistemeve të ngrohjes, duke cenuar kështu një standard kombëtar e ndërkombëtar të përcaktuar se: *“ambientet e strehimit në përdorim të të burgosurve, duhet të përmbushin të gjitha kërkesat e nevojshme për jetesë, duke i kushtuar rëndësi të posaçme ngrohjes...”*, por njëkohësisht zhvlerëson investimin fillestar të instalimit të sistemeve ngrohëse me chiller. Ndërkohë që, në IM Kavajë, IEVP Tepelenë, Berat, “Mine Peza”, Korçë ngrohja realizohet nëpërmjet sistemit të kaldajave në temperatura -5 gradë.

- Mungesa e dritës natyrale dhe ventilimi

Tek të gjitha ambientet në të cilat të paraburgosurit duhet të jetojnë dhe punojnë, dritaret do të jenë aq të mëdha sa të paraburgosurit të mund të lexojnë dhe punojnë me dritë natyrale dhe do të jenë ndërtuar në mënyrë të atillë që të mos pengohet hyrja e ajrit të freskët pavarësisht nëse ka ose jo ventilim



artificial.⁶² Referuar standardeve kombëtare e ndërkombëtare, drita artificiale duhet të jetë e mjaftueshme që personat e paraburgosur të mundën të lexojnë pa dëmtuar shikimin.

Sa kaq, në I EVP Burrel, “Mine Peza”, Kukës, “Jordan Misja”, Fushë Krujë dhe Tepelenë drita artificiale nuk ishte e mjaftueshme. Dritaret në dhomat e banimit dhe/ose klasa ishin jashtë standardeve të përcaktuara, çka vështirësonte jo vetëm hyrjen e ajrit të freskët dhe dritës natyrale por edhe ventilimin artificial.

- Prezenca e lagështirës

Problemet e lagështirës ishin prezente në të gjitha I EVP-të që ofrojnë shërbim paraburgimi, duke përfshirë këtu edhe institucionet e ndërtuara rishtazi sikurse është I EVP Reç (5 vjet) apo I EVP Fier, punimet e zbatimit të projektit e të cilit përfunduan në vitin 2014.

Për shkak të vendosjes së tij në zonën e ish-kënetës, I EVP Durrës, përtej problematikave të konstatuara sa i përket prezencës së madhe të lagështirës, në periudhën e reshjeve intensive të shiut kishte gjithashtu probleme me përmytjen, ku uji shkon rreth 20 centimetra. Kjo problematikë e konstatuar, sjell për pasojë përmytjen e dhomave të vendosura në katin e parë të sektorit të paraburgimit dhe prezencë të lagështirës në nivele alarmante. Nivelet e larta të lagështirës, sidomos nëse personat janë të ekspozuar për një kohë të gjatë, mund të kthehen në një rrezik për shëndetin e të paraburgosurve.

Në I EVP “Kavajë”, “Peqin” dhe “Ali Demi”, grupi i auditimit konstatoi gjithashtu nevojën për hidroizolim të të gjitha ambienteve të institucionit. Ndërkohë që, ndërtimi me mbulesë llamarine në I EVP “Ali Demi” është problematik si për temperaturat e ulta ashtu edhe për temperaturat e larta.



- Ajrimi

Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale duhet të mundësojnë një infrastrukturë të përshtatshme në rastet kur kushtet atmosferike janë jo të favorshme për kryerjen e ajrimit nga të dënuarit.⁶³ Në zbatim të këtij standardi, në I EVP, si: Fier, Berat, Shkodër, Peqin, Elbasan, etj. në korridoret e kateve të sektorit të paraburgimit ishin parashikuar edhe sheshpushime që mund të shfrytëzoheshin nga personat e paraburgosur gjatë orarit të ajrimit, në ditët kur kushtet atmosferike janë jo të favorshme për kryerjen e ajrimit. Ndërkohë që, në I EVP Kukës, “Mine Peza”, Burrel, Durrës dhe Tepelenë ky kriter nuk gjente zbatim. Këto I EVP ofronin vetëm klasë/klasa,



⁶² Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, neni 30;

⁶³ Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, neni 32;

numri i të cilave ishte në disproporcion me numrin e personave të akomoduar në paraburgim për shkak të mbipopullimit.

- Dhoma e Prindërimit në Distançë

Fëmijët e prindërve të burgosur në literaturë përshkruhen shpesh si “viktimat e harruara të burgimit”. Megjithatë, duhet theksuar se efekti negativ që ka tek fëmija burgosja e prindërit nuk është marrëaq në konsideratë në proceset e drejtësisë penale, e cila fokusohet kryesisht në përcaktimin e fajësisë individuale ose të pafajësisë dhe në masat për ndëshkimin e shkelësit të ligjit. Dështimi për të marrë në konsideratë fëmijët e prindërve të burgosur në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale, nga arresti në gjykimin me burg, mund të rezultojë në dëmtim të të drejtave të tyre, të nevojave dhe interesave, duke anashkaluar apo dëmtuar në mënyrë aktive këto subjekte.⁶⁴

Burgimi i prindit, zakonisht, ka një impakt negativ tek fëmijët dhe kushtet e burgut mund ta amplifikojnë këtë impakt. Lidhur me këtë fakt, fëmijët shpeshherë shprehin shqetësim dhe ankth mbi burgosjen e prindërve të tyre.⁶⁵

Programi i “Prindërimit në Distançë”, që çdo IEVP duhet të zhvillojë synon pikërisht forcimin e marrëdhënieve me familjen prind-fëmijë dhe zbutjen e impaktit negativ të kushteve të burgut tek ata.⁶⁶

Sa kaq, IEVP Burrel, Tepelenë dhe Kukës nuk ofrojnë dhomë prindërmë në distancë. Më tej, dhoma në të cilën zhvillohen takime me familjarët në IEVP Kukës, e rrethuar me hekura ndikon negativisht në amplifikimin e ndjesisë së tronditjes së fëmijës.

Në IEVP Fier, përveç ambienteve të brendshme dhe dhomës së prindërimit, në ambientet e jashtme, në hapësirën midis dy godinave të shërbimeve ndihmëse, ishte investuar për ngritjen dhe vënien në funksion të një ambienti për takimet e personave të paraburgosur dhe dënuar me familjarët e tyre, në formën e këndit të lojërave, pajisur me karrige, tavolina dhe lodra të ndryshme për fëmijët, e rrethuar me lule e gjelbërim.



- Ushqimi

Në orare të caktuara, IEVP-të duhet të ofrojnë çdo personi të paraburgosur vakte me vlera të përshtatshme ushqimore për shëndetin dhe fuqinë e tij, në sasi të bollshme dhe të përgatitura e shërbyera mirë.⁶⁷ Që prej vitit 2006, furnizimi i të dënuarve me ushqime realizohej në zbatim të Urdhërit të Përbashkët të Ministrit të Drejtësisë nr. 104/5, datë 19.07.2006 dhe Ministrit të Shëndetësisë nr. 205/3 datë 27.07.2006. Sipas kësaj normative artikujt ushqimorë të përcaktuar dhe menuja përkatëse, mbi bazën e së cilës gatuhet në gazhinat e IEVP-ve janë: bukë, oriz, fasule,

⁶⁴ <https://unitir.edu.al/impakti-i-burgimit-prinderor-tek-adoleshentet-e-grupmoshes-10-18-vjecare/>, fq. 15;

⁶⁵ <https://unitir.edu.al/impakti-i-burgimit-prinderor-tek-adoleshentet-e-grupmoshes-10-18-vjecare/>, fq. 24;

⁶⁶ Rregullore e Përgjithshme e Burgjeve, neni 57;

⁶⁷ Rregullore Europiane e Burgjeve, rregulli 20;

makarona, sheqer, mish, djathë, gjalpë, qumësht, vezë, vaj, zarzavate, fruta, marmalatë, kripë, çaj, salcë.

Nëpërmjet Udhëzimit të Përbashkët nr. 1, datë 22.02.2022 të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, janë rishikuar normat ditore të miratuara në vitin 2006, duke rritur kuotën ditore të ushqimeve. Norma ushqimore ditore e përcaktuar në këtë udhëzim, ndikon në mënyrë të drejtë për drejtë në ushqimin i cili duhet të sigurohet nga institucioni.

Ushqimi i ofruar në I EVP duhet të jetë i shumëllojshëm, i pasur me vlera ushqyese, të ndryshohet të paktën një herë në dy javë dhe t'u përshtatet kushteve klimaterike.

Sa kaq, sipas normativës së re, artikulli fasule do të zëvendësohet në periudhën e verës me artikullin thjerrëza dhe artikulli marmalatë me artikullin reçel. Me qëllim rritjen e larmshmërisë, nëpërmjet udhëzimit të sipërcituar është shtuar edhe artikulli bizele të ngrira. Gjithashtu zbatimi i normativës së re të ushqimit konsiston edhe në faktin se kemi jo vetëm rritje të sasive të disa artikujve, por edhe shtimin e disa asortimenteve.

Më konkretisht:

- Është shtuar sasia e perimeve dhe frutave respektivisht nga 300 gr/ditë në 350 gr/ditë dhe nga 100 gr/ditë në 150 gr/ditë;
- Është shtuar sasia e bukës për të miturit;
- Është shtuar sasia e artikullit fasule nga 40 në 50 gram për të dënuarit dhe të miturit e papunësuar dhe 60 gram për të dënuarit dhe të miturit e punësuar;
- Është shtuar artikulli "gjalpë" për të dënuarit e papunësuar;
- Është zëvendësuar pjesërisht artikulli fasule me artikullin thjerrëza;
- Është shtuar artikulli "kos" për të burgosurit e sëmurë;
- Është zëvendësuar artikulli "marmalatë" me artikullin "reçel"; dhe
- Është shtuar artikulli "Erëza".



Pavarësisht, shtimit të asortimenteve, me qëllim përmirësimin e shijes dhe larmshmërisë ushqimore, disa nga produktet e parashikuara për shtim ende nuk janë shtuar (si: gjalpë për të papunësuarit, kos për diabetikët, reçel, erëza dhe thjerrëza).

Ushqimi i ofruar nga I EVP-të, referuar menuve javore të tyre nuk paraqet shumëllojshmëri dhe as nuk ndryshohet çdo dy javë. Një problematikë kryesore sa i përket ushqimit është mungesa e konsumit të tij. Nga takimet e zhvilluara në regjimet e sektorëve të paraburgimit gjatë fazës së terrenit, grupi i auditimit konkludoj se personat e paraburgosur, në disa raste nuk ishin të kënaqur me ushqimin e ofruar në I EVP (shijen; menu-n; cilësinë) dhe në disa raste të tjera, për shkak se merrnin furnizime ushqimore nga familja ishin indiferent dhe të pa interesuar për të konsumuar ushqimin e ofruar nga I EVP-të. Për rrjedhojë, një sasi e konsiderueshme e ushqimit nuk konsumohej.



Ushqimi i ofruar nga I EVP-të, referuar menuve javore të tyre nuk paraqet shumëllojshmëri dhe as nuk ndryshohet çdo dy javë. Një problematikë kryesore sa i përket ushqimit është mungesa e konsumit të tij. Nga takimet e zhvilluara në regjimet e sektorëve të paraburgimit gjatë fazës së terrenit, grupi i auditimit konkludoj se personat e paraburgosur, në disa raste nuk ishin të kënaqur me ushqimin e ofruar në I EVP (shijen; menu-n; cilësinë) dhe në disa raste të tjera, për shkak se merrnin furnizime ushqimore nga familja ishin indiferent dhe të pa interesuar për të konsumuar ushqimin e ofruar nga I EVP-të. Për rrjedhojë, një sasi e konsiderueshme e ushqimit nuk konsumohej.

Në intervistat e zhvilluara pranë I EVP-vë, disa institucionet e paraburgimit u shprehën se ushqimi i kthyer dhe i pa konsumuar nga personat e paraburgosur ishte në shifra të larta, duke varjuar nga 40%-60%. Ndërkohë që, në pyetësorët e plotësuar me qëllim konfirmimin e të dhënave zyrtare, I EVP-të

janë shprehur se sasia e ushqimit të pa konsumuar është mesatarisht 25%.⁶⁸ Lidhur me këtë fakt, grupi auditimit konstatoj një qëndrim institucional dualist të disa prej subjekteve nën auditim. Sa më sipër, me qëllim vlerësimin e efektit financiar që sjell mungesa e konsumimit të plotë të ushqimit në IEVP, grupi i auditimit kërkoj pranë DPB koston mesatare ditore të ushqimit për një person të paraburgosur. Në përgjigje të intervistës për konfirmimin e të dhënave zyrtare, DPB u shpreh se vlera mesatare/ditë për një të paraburgosur është 266 lekë. Shifra e referuar nga DPB, dëshmon për përdorim të një metodologjie jo të saktë nga ana e saj sa i përket përcaktimit të koston ditore për ushqim të një personi të burgosur. Kostoja e nxjerrë nga ana e DPB nuk mbështetet në çmimet e konsumit të publikuara nga INSTAT.

Në këto kushte, grupi i auditimit, ju referua relacionit të udhëzimit për normën ushqimore, i cili përcakton se: vlera mesatare totale/ ditë për një të burgosur është 1,526 lekë. Duke marrë në konsideratë koston e përcaktuar në këtë relacion, efekti financiar ekonomik i ushqimit të pa konsumuar nga personat e paraburgosur (25%) përllogaritet në një kosto të përafërt prej **1,030,050 lekë në ditë**. Gjatë intervistave të zhvilluara në IEVP, grupi i auditimit konstatoi gjithashtu se menaxhimi i ushqimit të mbetur nga një institucion në tjetrin ndryshonte. Lidhur me këtë fakt, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet të marrë masa për hartimin e një akti normativ për mënyrën e trajtimit dhe menaxhimit të ushqimit që kthehet dhe nuk konsumohet nga të dënuarit.



Gjithashtu, bazuar në përcaktimet e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, të paraburgosurit apo të dënuarit i lejohet furnizimi nga familja me produkte ushqimor. Në funksion të zbatimit të këtij përcaktimi ligjor, çdo IEVP me urdhër të brendshëm duhet të marrë në dorëzim këto artikuj duke zbatuar sigurinë në burgje. Gjatë vëzhgimeve të kryera nga grupi auditimit u konstatua se si pasojë e mungesës së rafteve apo frigoriferit, produktet e marra nga shtëpia mbaheshin jo në përputhje me kushtet higjeno-sanitare, çka mund të përbënte shkak për sëmundje të personave të paraburgosur.

- ***Të drejtën për shëndet***
- Vakanca në staf mjekësor

Institucionet e paraburgimit nuk janë të pajisura gjithmonë me një sistem të kujdesit shëndetësor, i cili është në gjendje të ofrojë trajtim mjekësor (duke përfshirë trajtimin parandalues dhe të specializuar) dhe kujdes infermieror, ose ndihmë psikologjike, në kushte të barasvlershme me shërbimet që gëzojnë pacientët në komunitetin jashtë institucionit. Personat e ndaluar, pavarësisht statusit të tyre ligjor dhe vendit ku mbahen, duhet të kenë qasje efektive në shërbimet mjekësore.

Pas konsultimit me të dhënat zyrtare të administruara nga subjektet nën auditim, grupi i auditimit konstatoj se shpërndarja e stafit mjekësor nuk është bërë në mënyrë proporcionale në raport me numrin e të paraburgosurve që ndodhen në secilën IEVP. Për rrjedhojë, numri i të paraburgosurve që mbulon një mjek nga një IEVP në tjetrën nuk është i njëjtë.

Numri total i mjekëve të angazhuar në një IEVP, referuar organikës së stafit të mjekësisë në sistemin penitenciar, varjon nga 1-4, ku përfshihen mjekët e përgjithshëm dhe mjekët psikiatër. Problemi kryesor që grupi i auditimit konstatoj sa i përket stafit mjekësor ishin vakancat dhe angazhimi i tyre pothuajse në të gjitha rastet me kohë të pjesshme. Kështu, në IEVP Shkodër, Burrel, Fier, Fushë-Krujë, Berat dhe Lezhë kishte nga 1 vakancë për pozicionin mjek, ndërkohë që në IEVP Korçë 3, ndërsa në IEVP “Jordan Misja” dhe Peqin grupi i auditimit konstatoj nga 2 vende vakante.

⁶⁸ Përgjigjet paraqiten të detajuara për secilën IEVP në tabelën nr. 1 të shtojcës nr. 1;

- Autoambulanca

Një problem shqetësues në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale është dhe mungesa e autoambulancave, për transportimin në rast emergjence të të sëmurve për në spital. Me përjashtim, të IEVP Shkodër, Fier, Korçë, Peqin, Lezhë dhe “Jordan Misja”, në asnjë IEVP tjetër që ofron shërbim paraburgimi nuk ka një autoambulancë me qëllim transportimin e personave të sëmure në raste urgjence për në spital. Ky fakt, jo vetëm që dëshmon për një trajtim të diferencuar ndërmjet personave të paraburgosur, në varësi të institucionit ku ata janë të akomoduar, por njëkohësisht cenon të drejtën për shëndet në rate emergjente, me qëllim ofrimin e shërbimit në kohë personave të paraburgosur.

- Rrjeti elektrik

Në pjesën dërmuese të IEVP-ve rrjeti elektrik nuk garantonte sigurinë teknike të nevojshme dhe përbente kërcënim serioz për jetën e personave të paraburgosur. Nga vëzhgimet e zhvilluara brenda regjimeve të sektorëve të paraburgimit, grupi auditimit konstaton shpesh herë pjesë të zhveshura të instalimeve elektrike dhe prizave. Për të garantuar kushte të sigurta për jetën e personave të paraburgosur, nevojitet mbyllja dhe rrethimi këtyre pjesëve të zhveshura të instalimeve elektrike.



- Tharja e rrobave brenda ambienteve të banimit

Shqetësim tjetër i konstatuar në të gjitha IEVP-të që ofrohet shërbim paraburgimi është gjithashtu edhe mungesa e ambienteve të dedikuara për tharjen e rrobave. Grupi i auditimit konstaton se shpeshherë rrobat thaheshin brenda ambienteve të banimit, nëpërmjet varjes së tyre në kordonë apo litarë, fakt ky i cili përbën premisë dhe rrezik për jetën, kryesisht të personave që vuajnë nga problem të shëndetit mendor dhe njëkohësisht edhe për sigurinë e të paraburgosurve të tjerë. Tharja e rrobave në ambiente të mbyllura shkakton probleme serioze me shëndetin dhe shton nivelin e lagështisë me 30%. Prezenca e lagështisë dhe mykut ndikojnë negativisht në organet e frymëmarrjes, duke përberë kështu një risk serioz për shëndetin e personave të paraburgosur.



3. Kushtet për ofrimin e programeve rehabilituese

• Të drejtën e vetëzhvillimit

Përgatitja për ri-integrim fillon në paraburgim, vazhdon gjatë kryerjes së dënimit dhe pas lirimit nga burgu. Për të miturin e dënuar parashikohet ndihmë sociale, edukative, arsimore, psikologjike, mjekësore dhe fizike për ri-integrimin e tij, në përshtatje me nevojat individuale dhe në përputhje me grup moshën, gjininë dhe personalitetin e tij. Personave të dënuar dhe të paraburgosur u garantohej shërbimi mjekësor, kujdesi shëndetësor për kategori të veçanta, punësimin, arsimim, veprimtari kulturore, çlodhëse e sportive, mjedise dhe kushte të përshtatshme.

- Biblioteka

Pavarësisht faktit se në çdo IEVP duhet të funksionoj një bibliotekë për përdorim nga të gjithë të paraburgosurit, për shkak të kufizimeve infrastrukturore, jo të gjitha IEVP-të ishin të pajisura me bibliotekë (psh. IEVP Tepelenë, Lezhë,



etj.). Në IEVP-të të cilat ofronin shërbim biblioteke për personat e paraburgosur, kolana e librave ishte përgjithësisht e dhuruar nga donatorë të ndryshëm. IEVP-të pranonin dhe bënë pjesë të titujve të ofruar në bibliotekë çdo libër të dhuruar, pa i kaluar fillimisht këto botime në një “filtër” të brendshëm institucional, me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së tyre me personat e paraburgosur. Kështu, gjatë vizitave të kryera në IEVP, grupi i auditimit konstaton tituj botimesh, si: “Udha për te vdekja”; “Gropa 67”; “Lexim i Frikshëm”; “Kufoma”; “Ndjenjë e Gjymtuar”; “Krimi i Ndëshkimit”; “Engjëjt Qajnë”; “Zemër e Plagosur”; etj.

Titujt e sipërcituar jo vetëm që nuk ndikojnë pozitivisht në vet zhvillimin e personave të paraburgosur, por njëkohësisht rëndojnë gjendjen e tyre psikologjike. Për rrjedhojë, IEVP-të duhet të bëjnë një përzgjedhje të librave të dhuruar që do të vendosin në përdorim për personat e paraburgosur.

- Arsim

Për realizimin e rehabilitimit social dhe ri-integrimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve, IEVP-ja duhet të vërë në dispozicion të gjitha burimet e përshtatshme, duke realizuar përkrahjen morale, kualifikimin profesional dhe arsimimin e personave të paraburgosur në mënyrë që këtyre individëve t’ju zgjerohet perspektiva e ri-integrimit shoqëror pas lirimit.

Lidhur me këtë fakt, në IEVP Kukës, Shkodër, Burrel, Fier, Elbasan, Tepelenë, Berat dhe Durrës nuk ofrohet arsim i ulët dhe i mesëm. Në IEVP Fushë-Krujë, Mine Peza, Korçë, Peqin dhe Vlorë ofrohet vetëm arsim 9-vjecar.

Mungesa e ofrimit të arsimit, sipas përcaktimeve ligjore cenon procesin e ri-integrimit në shoqëri të personave të paraburgosur, duke sjellë për pasojë edhe mos përmbushje me efektivitet nga ana e IEVP-ve të objektivave institucionale.

- Kurse Profesionale

Administrata e institucionit nxit dhe krijon kushtet për formimin profesional brenda dhe jashtë institucionit. Mësimdhënia në këto kurse realizohet nga profesionistë dhe dhënia e autorizimit përkatës bëhet nga drejtori i IEVP-së. Procesi i rehabilitimit dhe ri-integrimit fillon qysh në periudhën e paraburgimit. Për rrjedhojë, çdo IEVP që ofron shërbim paraburgimi duhet ti mundësojë personave të akomoduar në këtë institucion mundësi për vetëzhvillim nëpërmjet kurseve profesionale.

Lidhur me këtë fakt, IEVP Kukës, Burrel, Elbasan, Tepelenë, “Mine Peza”, “Jordan Misja”, Lezhë dhe Shkodër nuk ofrojnë asnjë kurs të zhvillimit profesional për personat e paraburgosur. Ndërkohë që, IEVP Peqin shprehet se ka marrëveshje për kurse por ato nuk frekuentohen nga të paraburgosurit. Mungesa e ofrimit të kurseve profesionale cenon procesin e vetëzhvillimit të personave të paraburgosur, të drejtat e tyre dhe mundësinë e ri-integrimit në shoqëri.



- Trajtim Individual


Trajtimi i të paraburgosurit dhe i të dënuarve duhet të bëhet sipas kriterit të individualizimit, në përputhje me gjendjen dhe karakteristikat individuale të secilit të dënuar. Për çdo të paraburgosur hartohet plani i ri-integrimit, ndërsa për kategoritë e veçanta të të paraburgosurve programi individual i trajtimit, duke mbajtur parasysh edhe nevojat specifike të tyre dhe një rëndësi e veçantë i kushtohet trajtimit psiko-social të të paraburgosurve. Lidhur me këtë fakt, procesi i programeve të trajnimit për personat e paraburgosur paraqitet i cunguar. Numri i punonjësve social në raport me personat e paraburgosur për trajtim është në disproporcion dhe ndryshon nga një IEVP në tjetrën. Mungesa e hartimit të programeve specifike për secilin të paraburgosur dhe numri i ulët i personelit social të

angazhuar e bën procesin e hartimit të trajtimeve individuale nëpërmjet planeve dhe programeve specifike formal dhe jo efektiv.

- Të drejtën e Lirisë së Besimit Fetar

Çdo person i paraburgosur, për sa kohë që është e mundur, do të lejohet të praktikojë fenë dhe ndjek besimin e tij, duke marrë pjesë në shërbesa apo mbledhje të drejtuara nga përfaqësues fetarë të organizuara nga institucioni, zhvillimin e takimeve me këta përfaqësues pa praninë e personelit të IEVP-së dhe mundësinë e mbajtjes së librave që lidhen me fenë apo besimin.⁶⁹

Lidhur me këtë fakt, grupi i auditimit gjatë vizitave të zhvilluara në IEVP konstaton se në disa institucione paraburgimi dhomat e kultit mungonin. Ndërkohë që, në IEVP të tjera përdorej e njëjta dhomë kultit për besime të ndryshme. Konkretisht, në IEVP Kukës, Tepelenë, Burrel nuk ka dhoma të dedikuara kultit. Ndërkohë që, në IEVP “Mine Peza”, “Ali Demi”, Korçë, Durrës, Lezhë dhe “Jordan Misja” për shkak të mungesës infrastrukture ka vetëm një dhomë kultit, e cila përdoret për besime të ndryshme.



Në IEVP Vlorë, pavarësisht se ka një dhomë kultit për besimin mysliman, ky ambient ka sipërfaqe të vogël, nuk ka asnjë dritare dhe në të nuk hyn drita e as nuk ka mundësi ajrimi. Këto kushte, vështirësojnë personin e paraburgosur në kryerjen e riteve fetare dhe cenojnë të drejtën e tij për praktikimin e fesë së besimit të tij.

Gjetje:

13. Sa i përket garantimit të sigurisë:

- Vendorsja e monitorëve të cilët ofrojnë pamje të kamerave të instaluar në çdo ambient të IEVP-ve vetëm në sallat operative, monitorimi i tyre vetëm nga dy operatorë brenda një turni dhe qëndrimi me orare të zgjatura vëzhgimi nga ana e operatorëve, ndikon negativisht në efektivitetin e procesit monitorues.
- IEVP-të që ofrojnë shërbim paraburgimi kanë numër të lartë vakancash në staf policor.

14. Sa i përket kushteve të trajtimit, mjediset që u ofrohen të burgosurve dhe në veçanti mjediset e fjetjes nuk respektojnë dinjitetin njerëzor dhe as hapësirat e nevojshme për banim. Mbipopullimi në sektorët e paraburgimit paraqitet në shifra problematike pothuajse në të gjitha IEVP-të. Në IEVP Durrës, për shkak të mbipopullimit, dhomat e observimit përdoren si dhoma banimi për personat e paraburgosur.

15. Kushtet që ju ofrohen personave të paraburgosur në IEVP-të në të cilat ata janë akomoduar nuk përmbushin standardet kombëtare e ndërkombëtare, si dhe nuk respektojnë dinjitetin njerëzor. Problematikat kryesore të konstatuara në sektorët e paraburgimit pranë IEVP-ve lidhen me mungesën e sistemeve të ngrohjes, prezencën e lagështirës, mungesën e dritës natyrale dhe ventilimit, mungesën e unifikimit dhe standardizimit të kushteve të ofruara nga një IEVP në tjetrën dhe mungesën e dhomës së prindërimit në distancë.

Sa i përket kushteve higjieno-sanitare, Në IEVP Fushë-Krujë mungojnë dushet dhe uji i ngrohtë. E njëjta situatë problematike konstatohet edhe në IEVP Burrel, ku përveç mungesës së dusheve,

⁶⁹ Rregullore e Përgjithshme e Burgjeve, Neni 62;

mungonte edhe furnizimi me uji. Ndërkohë që, në IEVP Shkodër, Fier, Lezhë, Durrës vendosja e dusheve nuk respektonte privatësinë individuale të personave të paraburgosur.

16. Pavarësisht faktit se, Udhëzimi i Përbashkët nr. 1, datë 22.02.2022 i Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, parashikon shtimë disa produkteve në menu-në ushqimore, me qëllim përmirësimin e shijes dhe larmishmërisë, këto produkte ende nuk janë shtruar. Menu-ja ushqimore në IEVP nuk paraqet shumëllojshmëri dhe nuk ndryshohet çdo dy javë, sikurse pëcaktohet në aktin nën ligjor të sipërcituar.

- Një sasi e konsiderueshme e ushqimit (rreth 25%) nuk konsumohet në IEVP. Nga takimet e zhvilluara në regjimet e sektorëve të paraburgimit gjatë fazës së terrenit, grupi i auditimit kolaudoj se personat e paraburgosur, në disa raste nuk ishin të kënaqur me ushqimin e ofruar në IEVP (shijen; menu-n; cilësinë) dhe në disa raste të tjera, për shkak se merrnin furnizime ushqimore nga familja ishin indiferent dhe të pa interesuar për të konsumuar ushqimin e ofruar nga IEVP-të.

17. Sa i përket garantimit të të drejtës për shëndet, institucionet e paraburgimit nuk janë të pajisura gjithmonë me një sistem të kujdesit shëndetësor. Numri total i mjekëve të angazhuar në një IEVP, referuar organikës së stafit të mjekësisë në sistemin penitenciar, varjon nga 1-4, ku përfshihen mjekët e përgjithshëm dhe mjekët psikiatër. Problemet e konstatuara nga grupi i auditimit, ishin:

- Raporti ndërmjet stafit mjekësor të angazhuar dhe numrit të të paraburgosurve që mbulon një mjek nga një IEVP në tjetrën nuk është i njëjtë.
- Në lidhje me vakancat, në IEVP Shkodër, Burrel, Fier, Fushë-Krujë, Berat dhe Lezhë kishte nga 1 vakancë për pozicionin mjek. Ndërkohë që në IEVP Korçë kishte 3 vakanca për pozicionin mjek, ndërsa në IEVP “Jordan Misja” dhe Peqin grupi i auditimit konstatoj nga 2 vende vakante.
- Problem shqetësues në IEVP është dhe mungesa e autoambulancave, për transportimin në rast emergjence të të sëmurëve për në spital. Në IEVP “Ali Demi”, “Mine Peza”, Vlorë, Kavajë, Berat, Durrës, Burrel, Kukës, Tepelenë, Fushë-Krujë, Elbasan nuk ka autoambulancë me qëllim transportimin e personave të sëmurë në raste urgjence për në spital.

18. IEVP-të nuk kanë krijuar kushte për ofrimin e programeve rehabilituese dhe vetëzhvillimin profesional brenda institucionit. Lidhur me këtë fakt:

- IEVP Tepelenë dhe Lezhë nuk ishin të pajisura me një ambient biblioteke për të paraburgosurit.
- IEVP-të nuk kryejnë një vlerësim paraprak të përshtatshmërisë së titujve dhe përmbajtjes së librave të dhuruara nga donatorët për personat e paraburgosur. Nga auditimi i zhvilluar, grupi i auditimit konstatoj disa botime, të cilat jo vetëm që nuk ndikojnë pozitivisht në vet zhvillimin e personave të paraburgosur, por njëkohësisht mund të rëndojnë gjendjen e tyre psikologjike.
- Në IEVP Kukës, Shkodër, Burrel, Fier, Elbasan, Tepelenë, Berat dhe Durrës nuk ofrohet arsim i ulët dhe i mesëm. Ndërkohë që, në IEVP Fushë-Krujë, Mine Peza, Korçë, Peqin dhe Vlorë ofrohet vetëm arsim 9-vjecar.
- IEVP Kukës, Burrel, Elbasan, Tepelenë, “Mine Peza”, “Jordan Misja”, Lezhë dhe Shkodër nuk ofrojnë asnjë kurs të zhvillimit profesional për personat e paraburgosur. Ndërkohë që, IEVP Peqin shprehet se ka marrëveshje për kurse por ato nuk frekuentohen nga të paraburgosurit.
- Procesi i programeve të trajnimit për personat e paraburgosur paraqitet i cunguar. Numri i punonjësve social në raport me personat e paraburgosur për trajtim është në disproporcion dhe ndryshon nga një IEVP në tjetrën.

19. Në disa institucione paraburgimi mungonin dhomat e kultit. Ky fakt, i vështirëson personit të paraburgosur kryerjen e riteve fetare dhe cenon të drejtën e tij për praktikimin e fesë së besimit të tij.

Konkluzione:

- Marrja në analizë e të gjitha shenjave vizuale që lidhen me paraqitjen dhe sjelljen, ndikon pozitivisht në parandalimin e situatave në mjediset e burgut. Mungesa e monitorimit me efektivitet të pamjeve të ofruara nga kamerat e instaluara, cenon garantimin e sigurisë së institucioneve të paraburgimit.
- Mungesa e stafeve policore ka sjellë mbyllje të sektorëve të paraburgimit në disa IEVP (psh. Shkodër) dhe për rrjedhojë mbipopullim të ambienteve të banimit të personave të paraburgosur. Gjithashtu, mungesa e stafit policor shkakton mbingarkesa të stafeve ekzistuese me qëllim mbulimin e sektorëve, duke riskuar kështu efektivitetin e realizimit të detyrave funksionale të stafit policor.
- Mungesa e kushteve që diktohen nga standardet kombëtare e ndërkombëtare, tregon për një trajtim të personave të paraburgosur jo në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi, duke cenuar kështu në mënyrë të drejtë për drejtë dinjitetin njerëzor, që duhet t'ju garantohet personave të paraburgosur. Si pasojë e mbipopullimit, në shpërndarjen e të paraburgosurve nuk mbahet parasysh që vendosja e të paraburgosurit në IEVP bëhet duke marrë në konsideratë kriterin e afërsisë së vendbanimit. Si pasojë e mbipopullimit në disa IEVP si Durrës dhe Kukës u konstatua fjetja në tokë, me batanije e personave të paraburgosur dhe mungesa e ofrimit të shtretërve nga ana e IEVP-ve. Gjithashtu, si pasojë e përdorimit të dhomave të observimit për akomodimin e personave të paraburgosur, procesi i vlerësimit të riskut në IEVP Durrës ishte kthyer në një proces formal.
- Mungesa e ofrimit të një menu-je ushqimore me shije dhe të larmishme ndikon në mos konsumimin e vakteve nga ana e personave të paraburgosur. Ky fakt, jo vetëm që përkethehet në efekt financiar për IEVP-të, por njëkohësisht rrit kostot e familjeve të personave të paraburgosur, të cilët detyrohen të sjellin ushqim për të afërmit e tyre që ndodhen në paraburgim.
- Personat e ndaluar, pavarësisht statusit të tyre ligjor dhe vendit ku mbahen, duhet të kenë qasje efektive në shërbimet mjekësore. Institucionet e paraburgimit nuk janë të pajisura gjithmonë me një sistem të kujdesit shëndetësor, i cili është në gjendje të ofrojë trajtim mjekësor (duke përfshirë trajtimin parandalues dhe të specializuar) dhe kujdes infermieror, ose ndihmë psikologjike, në kushte të barasvlershme me shërbimet që gëzojnë pacientët në komunitetin jashtë institucionit. Mungesa e autoambulancave, instalimet elektrike të zhveshura apo tharja e rrobave në ambiente të mbyllura, jo vetëm që dëshmon për një trajtim të diferencuar ndërmjet personave të paraburgosur në varësi të institucionit ku ata janë të akomoduar, por njëkohësisht cenon të drejtën për shëndet, duke shkaktuar kështu probleme serioze dhe rriskuar ndërhyrjet efektive të ndihmës së shpejtë në rast nevojë.
- Procesi rehabilitimit dhe ri-integrit fillon qysh në periudhën e paraburgimit. Për rrjedhojë, çdo IEVP që ofron shërbim paraburgimi duhet ti mundësojë personave të akomoduar në këtë institucion mundësi për vetëzhvillimi nëpërmjet arsimit dhe kurseve profesionale. Mungesa e filtrimit të titujve të ofruar për personat e paraburgosur jo vetëm që nuk ndikon pozitivisht në vet zhvillimin e tyre, por njëkohësisht rëndon gjendjen e tyre psikologjike. Mungesa e ofrimit të arsimit dhe kurseve profesionale, sipas përcaktimeve ligjore cenon procesin e ri-integritimit në shoqëri të personave të paraburgosur, duke sjellë për pasojë edhe mos përmbushje me efektivitet nga ana e IEVP-ve të objektivave institucionale. Mungesa e hartimit të programeve specifike për secilin të paraburgosur dhe numri i ulët i personelit social të angazhuar e bën procesin e hartimit të trajtimeve individuale nëpërmjet planeve dhe programeve specifike formal dhe jo efektiv.
- Liria e fesë është një e drejtë kushtetuese që individi gëzon, e sanksionuar edhe në ligjin për trajtimin e personave të dënuar dhe të paraburgosur, si edhe në rregulloren e përgjithshme të

burgjeve. Për rrjedhojë mungesa e dhomave të kultit, cenon një të drejtë të personave të paraburgosur që ligji ju njeh.

Rekomandim nr. 11:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për riorganizimin e punës së procesit të monitorimit. Për këtë qëllim, të mundësohen monitor me kamera në çdo sektor shërbimi.

Në vijimësi

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për rishikimin e pikës “ë” të nenit 29 të Ligjit nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”, i cili parashikon se: “Ka të drejtë të konkurrojë për t’u pranuar në Policinë e Burgjeve çdo person që është nën moshën 35 vjeç”.

Menjëherë

Rekomandim nr. 12:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për problematikën e mbipopullimit të sistemit të paraburgimit, duke hapur më shumë sektorë paraburgimi, si dhe duke bërë një shpërndarje më propocionale të individëve të paraburgosur, në përputhje edhe me përcaktimet ligjore.

Menjëherë

Rekomandim nr. 13:

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të marrin masa për plotësimin të gjitha kushteve që IEVP-të duhet të plotësojnë kah personave të paraburgosur.
- IEVP-të të ndajnë praktika të mira mes njëra tjetrës për trajtimin e problematikave të ndryshme të konstatuara gjatë vijimësisë së punës dhe menaxhimit të sistemeve të paraburgimit.
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të standardizoj kushtet që duhet të plotësojë çdo IEVP, me qëllim unifikimin e tyre dhe trajtimin e barabartë mes të paraburgosurve, pavarësisht institucionit në të cilin janë akomoduar.

Qershor 2023 dhe në vijimësi

Rekomandim nr. 14:

Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të marrin masa për ndryshimin e menu-së ushqimore çdo dy javë. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për shtimin e asortimenteve të parashikuara sipas normës së miratuar për personat e paraburgosur, si dhe për hartimin e një akti normativ për mënyrën e trajtimit dhe menaxhimit të ushqimit që kthehet dhe nuk konsumohet nga të burgosurit.

Mars 2023

Rekomandim nr. 15:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të marrin masa me qëllim plotësimin e vendeve vakante të stafit mjekësor të angazhuar në sistemin penitenciar dhe pajisjen me autoambulanca të të gjitha IEVP-ve, me qëllim ofrimin e një qasje efektive dhe të barabartë në shërbime shëndetësore kah personave të paraburgosur.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandim nr. 16:

Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të marrin masa për mbylljen dhe rrethimin e pjesëve të zhveshura të instalimeve elektrike dhe krijimin e ambienteve të dedikuara për tharjen e rrobave të personave të paraburgosur.

Rekomandim nr. 17:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të marrin masa për ofrimin e arsimit të ulët dhe të mesëm në institucionet që ofrohet shërbim paraburgimi (duke

marrë në konsideratë nevojat dhe kërkesat e të paraburgosurve), ofrimin e programeve të larmishme rehabilituese nëpërmjet kurseve të ndryshme profesionale, si dhe të bëjnë një përzgjedhje të librave të dhuruar që do të vendosin në përdorim për personat e paraburgosur.

Në vijimësi

Rekomandim nr. 18:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP-të, nëpërmjet kushteve infrastrukturore të marrin masa për krijimin e dhomave të kultit në institucionet e paraburgimit.

Në vijimësi

4.1.2.2 A ka bashkëvepruar DPB dhe IEVP-të në mënyrë integrale me DPP/DVP-të dhe aktorë të tjerë të përfshirë në proces, në funksion të garantimit të të drejtave për personat e paraburgosur?

Termi “drejtësi penale” i referohet komponentëve të shtetit për zbatimin e ligjit, gjykimin e personave që kryejnë vepra penale dhe korrigjimin e sjelljes së tyre. Sistemi i drejtësisë penale është në thelb një instrument i kontrollit shoqëror. Policia dhe sistemi i burgjeve janë faktorë thelbësorë të sistemit të drejtësisë penale dhe këta faktorë ndihmojnë në vendosjen dhe ruajtjen e rendit publik. Forca policore është forca që ka autoritetin dhe përgjegjësinë të mbrojtë qytetarët dhe të ndalojë individët që kanë shkelur ligjin. Dërgimi i këtyre individëve në një institucion korrigjues mund të mbrojtë shoqërinë, ndërkohë që u ofron autorëve mundësi për vetë-përmirësim dhe rrit mundësinë që ata të bëhen qytetarë të bindur ndaj ligjit. Edhe pse këto sisteme janë të organizuara mirë në teori, në praktikë hasen shumë pengesa.

Bashkëpunimi ndërinstitutional në zbatimin e ligjit konsiston në një ndarje reciproke të burimeve dhe ideve. Ai ndihmon në koordinimin dhe parandalimin e ngërceve të mundshme ndërmjet aktorëve të sistemit, duke parashikuar rregulla dhe protokolle për situatat ku këta të fundit mund të përfshihen. Nisur nga natyra dhe tipologjia e punës së institucioneve të zbatimit të ligjit, bashkëpunimi ndërinstitutional është i domosdoshëm për funksionimin e të gjithë sistemit, drejt arritjes së qëllimit të përbashkët.

Në rastin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Policisë së Shtetit, ky bashkëpunim duhet të marrë më shumë një qasje proaktive, duke kaluar në një lloj ndërveprimi institucional. Në këtë mënyrë, institucionet planifikojnë situatat e mundshme, ndajnë informacione, ndërtojnë protokolle dhe linja komunikimi, etj. Ndërveprimi aktiv ndërmjet institucioneve sjell shumë përfitime, krahasuar me bashkëpunimin e sforcuar që ndodh vetëm në rastet kur është vërtet e nevojshme.

- Rrit eficiencën e punës së kryer dhe shërbimeve të ofruara;
- Mundëson një rrjedhë më të mirë të shkëmbimit të informacionit, duke ulur mundësitë e keqkuptimeve ndërmjet institucioneve;
- Bashkëpunimi ndërinstitutional ndihmon në planifikim dhe përgatitje, në mënyrë që institucionet t'i përgjigjen situatave të paparashikuara me shpejtësi dhe në mënyrë efektive;
- Mundëson shkëmbimin dhe shfrytëzimin e burimeve logjistike dhe ekspertizës së dy apo më shumë institucioneve.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe në funksion të respektimit dhe garantimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP-të në varësi të saj bashkëpunojnë me Policinë e Shtetit. Ky bashkëpunim konsiston kryesisht në:

- Transferimin e të ndaluarve/arrestuarve nga ambientet e Policisë së Shtetit në IEVP, menjëherë pas caktimit nga gjykata të masës së sigurimit “*arrest me burg*”.
- Transferimin nga ambientet e policisë së Shtetit në IEVP të personave të dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, menjëherë pas zbatimit të urdhrat të prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal.

- Rritjen e sigurisë ndaj të dënuarve dhe të paraburgosurve të sigurisë së lartë kur lëvizin jashtë IEVP-ve.
- Njoftimin e strukturave të Policisë së Shtetit për personat e dënuar që trajtohen me leje para se të jepet leja nga ana e IEVP-ve dhe njoftimet për lirimin e të dënuarve.
- Vlerësimin e situatës së sigurisë publike pra dhe gjatë trajtimit me leje shpërblyese apo të veçantë, të të dënuarve me burgim.
- Marrjen në ruajtje nga ana e strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të personave që janë me masë sigurimi “*arrest me burg*” dhe gjenden për trajtim në qendrat shëndetësore rajonale apo qendrat spitalore universitare.
- Shkëmbimin e informacioneve për veprimtari kriminale me interes të përbashkët, me qëllim garantimin e rendit dhe sigurisë publike brenda dhe jashtë IEVP-ve.

Krahas këtyre çështjeve, bashkëveprimi ndërmjet dy institucioneve shtrihet edhe në drejtim të hartimit të planeve të përbashkëta, shkëmbimit dhe aksesit në informacion, etj. Me qëllim rregullimin dhe koordinimin e këtyre çështjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kanë miratuar Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet tyre. Marrëveshja është përditësuar për herë të fundit në mars të vitit 2019⁷⁰, duke shfuqizuar marrëveshjen e mëparshme të miratuar në 2015.⁷¹

Transferimi i personave të ndaluar/arrestuar drejt IEVP-së është një proces që kërkon angazhimin e të dyja këtyre institucioneve, duke qenë se edhe afatet janë të përcaktuara qartë në Kodin e Procedurës Penale dhe marrëveshjen dypalëshe. Brenda njëzet e katër orëve të para nga ndalimi i një personi, Policia duhet të referojë çështjen pranë organit të akuzës. Në rast se nuk urdhëron lirimin e menjëhershëm, ky i fundit (prokurori), brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e masës në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.⁷² Mosrespektimi i këtij afati bën që arrestimi ose ndalimi të humbasë fuqinë. Gjithashtu, arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinë kur vendimi i gjykatës për vleftësimin nuk është shpallur brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë.⁷³ Kështu, kërkesa për vleftësimin e masës së arrestit nga prokurori dhe shpallja e vendimit të gjykatës në lidhje me të nuk mund të kalojnë afatin maksimal prej 96 orësh. Kur ka përfunduar afati ligjor i qëndrimit të personit si i arrestuar/ndaluar në ambientet e policisë sipas përcaktimit të nenit 259, pika 5 të Kodit të Procedurës Penale, në rast se dhe pas këtij afati gjykata nuk ka kryer shqyrtimin dhe vendosjen e një prej masave të sigurimit, i arrestuari/ndaluari lirohet duke u nxjerrë menjëherë nga ambienti i dhomave të sigurisë. Në këtë rast vihet në dijeni titullari i drejtorisë/komisariatit të policisë, oficeri i policisë gjyqësore që ka kryer arrestimin/ndalimin dhe prokurori i prokurorisë së rrethit gjyqësor.

Në vijim, menjëherë pas shpalljes së vendimit të gjykatës, policia përgatit transferimin nga dhomat e sigurisë për në IEVP të personit për të cilin është vendosur masa e sigurisë “*arrest me burg*”. Ky i fundit transferohet drejt IEVP-së që gjendet në juridiksionin e drejtorisë/komisariatit të policisë apo sipas përcaktimit të bërë nga DPB. Personat e arrestuar/ndaluar dorëzohen pranë IEVP-ve pa kërkesë, por duke e shoqëruar te arrestuarin me dokumentacionin e nevojshëm, ndryshe nga personat e dënuar me vendim të formës së prerë në mungesë, për të cilët bëhet një kërkesë për transferim pranë DPB.

⁷⁰ Marrëveshje Bashkëpunimi nr. 897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019, “Për transferimin në IEVP të arrestuarve/ndaluarve me masën e sigurisë “*arrest me burg*” dhe të dënuarve me burgim me vendim të formës së prerë në mungesë, rritjen e sigurisë të IEVP-ve dhe sigurimin e të burgosurve/paraburgosurve që trajtohen me leje dhe gjatë shoqërimit të tyre”;

⁷¹ Marrëveshje Bashkëpunimi nr. 1054/1, datë 16.03.2015 dhe nr. 2157/1, datë 17.03.2015, “Për rritjen e sigurisë në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, sigurimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve që trajtohen me leje, respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e policisë dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale”;

⁷² Kodit të Procedurës Penale, neni 258/1;


⁷³ Kodit të Procedurës Penale, neni 259/5;

Transferimi dhe dorëzimi i të arrestuarve/ndaluarve me masën e sigurisë “arrest në burg” bëhet brenda orarit zyrtar të pranimeve⁷⁴ dhe i shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:⁷⁵

- Vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”
- Procesverbalin e ndalimit ose arrestimit në flagrancë
- Procesverbalin e kontrollit personal
- Formularin e identifikimit me fotot dhe gjurmët e gishtërinjve
- Dokumentin e identifikimit
- Dokumentin e kontrollit mjekësor (kartela mjekësore e plotësuar nga mjeku i drejtorisë/komisariatit policisë apo mjekë të tjerë të qendrave spitalore)

Dështimi për të plotësuar një nga këto dokumente bën që IEVP të refuzojë pranimin e personit që transferohet. Në figurën e mëposhtme jepet një hartë e gjithë procesit nga ndalimi i personit deri te akomodimi i tij pranë IEVP me statusin e të paraburgosurit, në mënyrë të thjeshtuar:

Infografik nr. 15: Harta e procesit nga momenti i ndalimi i personit deri në akomodimin e tij në IEVP



Burimi: Grupi i auditimit

Problematikat e para të transferimit të të ndaluarve hasen pikërisht në këtë fazë të procesit. Nga intervistat e zhvilluara në DVP të ndryshme është konstatuar se disa të paraburgosur, në pritje të transferimit të tyre në një IEVP janë mbajtur në ambientet e dhomave të sigurisë të ndodhura pranë Drejtorive Vendore të Policisë për periudha të zgjatura, në tejkalim të afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Raste të vonesave të transferimeve në IEVP të personave të arrestuar/ndaluar ka pasur në vijimësi, gjë që sjell si pasojë mos respektimin e të drejtave të këtyre personave, mbipopullim të ambienteve të dhomave të sigurisë, si dhe mos përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve⁷⁶ dhe Procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.⁷⁷ Ky shqetësim është shprehur edhe në raportin e plotë të Komitetit Evropian për parandalimin e torturës dhe të trajtimit ose dënimit çnjerëzor dhe poshtërues (CPT).⁷⁸ Konkretisht, edhe gjatë vitit 2022 janë evidentuar raste të mos transferimit në kohë pranë IEVP-ve të personave të arrestuar/ndaluar që trajtohen në ambientet e Policisë së Shtetit, ndaj të cilëve gjykata ka vendosur masën e sigurisë “arrest me burg”. Nga intervistat e zhvilluara me Drejtorinë e

⁷⁴ Orari shpallet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe është përcaktuar në marrëveshjen e përbashkët;

⁷⁵ Pika 13.4, Kreu V i Procedurës standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhër nr. 925, datë 18.07.2019 të DPPSH;

⁷⁶ VKM nr. 437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”;

⁷⁷ Urdhër nr. 925, datë 18.07.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;

⁷⁸ Raporti i plote i Komitetit Evropian për parandalimin e torturës dhe të trajtimit ose dënimit çnjerëzor dhe poshtërues (CPT), për vizitën/inspektimin e kryer në muajin tetor 2018 në Shqipëri;

Përgjithshme dhe disa Drejtori Vendore të Policisë së Shtetit, u konfirmua se edhe aktualisht vazhdon të ketë vonesa në transferime, vonesa të cilat shkojnë deri në 3-5 ditë pas marrjes së masës së sigurimit të dhënë nga gjykata. Sipas DPPSH, arsyt e vonesës së transferimeve vijnë si rezultat i mospranimit nga IEVP-të të personave me masën e sigurisë “*arrest me burg*” (të paraburgosur), me argumentin se ka mbipopullim dhe mungesë të ambienteve për akomodim në IEVP. Ky fenomen është më i theksuar në IEVP-të e qarkut Tiranë dhe në ndonjë rast në IEVP Elbasan dhe IEVP Korçë. Ky i fundit i është drejtuar DVP Korçë nëpërmjet një shkrese, në të cilën thuhet se deri në një moment të dytë nuk mund të akomodohen të arrestuar/ndaluar nga DVP Korçë për shkak të mbipopullimit në institucion. Policia e Shtetit sqaron se akomodimi i të arrestuarve/ndaluarve të DVP Korçë, aktualisht bëhet në IEVP Elbasan dhe IEVP Peqin. Një situatë të ngjashme, grupi e ka konstatuar edhe në vizitën pranë DVP Durrës, ku për shkak të mungesës së kapaciteteve në IEVP-në e rrethit, personat e paraburgosur janë transportuar drejt IEVP Lezhë. Kujtojmë që transporti i personave të arrestuar/ndaluar nga ambientet e Policisë së Shtetit për në IEVP bëhet nga strukturat e Policisë së Shtetit me mjetet që ka në dispozicion kjo e fundit dhe dërgimi në IEVP-të të largëta përkthehet në kosto të shtuara.

Nga ana tjetër, IEVP-të përballen me vështirësinë e akomodimit të personave paraburgosur, në kushtet e mbipopullimit. Konkretisht, nga vizitat e kryera në IEVP-të ku qëndrojnë individët e paraburgosur, grupi ka konstatuar raste ku numri i personave ishte më i lartë se kapaciteti i përcaktuar. Njëkohësisht ngrihet shqetësimi se në shumë raste ka vështirësi për të akomoduar personat e paraburgosur dhe garantuar kushte të përshtatshme jetese për ta.

Gjithashtu, konstatohen raste kur personat e paraburgosur mbahen përtej afateve në ambientet e policisë, për shkak të mangësive në dokumentacionin shoqërues gjatë dërgimit për në IEVP. Në funksion të këtij problemi DPPSH ka nxjerrë vazhdimisht Letër-porosi drejtuar strukturave përkatëse me qëllim transferimin në kohë të individëve drejt IEVP.⁷⁹

Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet DPB dhe Policisë së Shtetit rregullon edhe pranimin nga IEVP-të të personave me masë sigurie “*arrest me burg*”, të cilët gjenden të shtruar në qendrat shëndetësore rajonale apo qendrat spitalore universitare për trajtim dhe kurim. Në këto raste, Policia përgatit dokumentacionin e përcaktuar në nenin 8 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve,⁸⁰ ndërsa marrja në dorëzim, ruajtja dhe siguri i këtyre personave kryhet nga punonjësit e Policisë së Burgjeve, jo më vonë se 24 orë nga njoftimi zyrtar i bërë nga Policia e Shtetit pranë DPB. Në lidhje me këtë çështje, DPPSH pretendon se në disa raste janë hasur vështirësi dhe se Policia e Burgjeve ka treguar neglizhencë në marrjen në dorëzim të këtyre personave. Ndërkohë, DPB thekson se raste të tilla kanë ndodhur për shkak të vakancave të shumta në radhët e Policisë së Burgjeve ose parregullsive në dokumentacionin e dërguar nga Policia e Shtetit. Për shembull, në një rast është vonuar transferimi i një shtetasi të paraburgosur, i cili ndodhej në ambientet e Spitalit Rajonal drejt IEVP-së Vlorë, për shkak të mos plotësimit në kohë të dokumentacionit dhe konkretisht formularit të identifikimit me gjurmët daktiloskopike dhe fotove bashkëlidhur.⁸¹ Vonesa në transferimin e personave të paraburgosur që marrin trajtim pranë qendrave shëndetësore shkaktohen edhe nga mos plotësimi në kohë i dokumentacionit të gjendjes së pacientit nga ana e personelit mjekësor.⁸²

Një tjetër vështirësi në zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit lidhet me vonesat në nxjerrjen e urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për përcaktimin e IEVP ku do të vuhet dënimi. Neni 4/3 i marrëveshjes përcakton se urdhri duhet të nxirret brenda 48 orëve nga mbërritja e dokumentacionit nga strukturat e Policisë së Shtetit. Megjithatë, duke qenë se ky dokument nuk është

⁷⁹ Letër-porosi nr. 6681/2, datë 16.11.2020 dhe Letër-porosi nr. 1303/2, datë 31.03.2022 e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;

⁸⁰ VKM nr. 437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”;

⁸¹ Adresuar në Letër-porosi nr. 1303/2, datë 31.03.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;

⁸² Adresuar në Letër-porosi nr. 6681/2, datë 16.11.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;

kriter për akomodimin e të paraburgosurve në IEVP, por vetëm për personat e dënuar me vendim të formës së prerë në mungesë, del jashtë objektit dhe fokusit të këtij auditimi.

Pranimi dhe marrja në dorëzim nga IEVP-të e personave të paraburgosur bëhet çdo ditë të javës nga ora 08:00 – 19:00 gjatë muajve Prill-Shtator dhe nga ora 08:00 – 15:00 gjatë muajve Tetor-Mars.⁸³ Nga intervistat e zhvilluara me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe Drejtoritë Vendore përkatëse nuk janë reklamuar shqetësime në lidhje me oraret e pranimi të përcaktuara në marrëveshje, madje as në ditët e festave apo ditët e pushimeve javore.

Siç konstatohet edhe nga parashtrimet e mësipërme, vonesat në transferimin e personave me masën e sigurisë “*arrest me burg*” vijnë si pasojë e neglizhencës në veprime të hallkave të ndryshme të sistemit, por edhe për shkak të kushteve të vështira infrastrukturore dhe mangësive në kapacitete. Pavarësisht shkaqeve që mund të çojnë në vonesa të tilla, duhet theksuar se afatet e shkurtra procedurale për vleftësimin e masës së sigurisë në Kodin e Procedurës Penale tregojnë pikërisht se mbajtja e personave të paraburgosur në ambientet e policisë është një procedurë kalimtare, e cila duhet të pasohet menjëherë nga transferimi drejt IEVP, ku individët gëzojnë të drejtat që lidhen me statusin e të “paraburgosurit”.⁸⁴

Krahas çështjeve të trajtuara më lart, marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet DPB dhe DPPSH përcakton edhe detyrime të tjera të përbashkëta institucionale. Ndër të tjera, palët duhet të informojnë reciprokisht njëra-tjetrën në nivel qendror dhe atë vendor, për problematikat dhe shqetësimet e konstatuara në drejtim të realizimit të bashkëpunimit, me qëllim marrjen e masave për eliminimin e tyre.⁸⁵ Për më tepër, të paktën dy herë në vit, përfaqësuesit e DPB dhe DPPSH duhet të analizojnë zbatimin e detyrave të parashikuara në marrëveshje, duke informuar titullarët respektivë dhe propozuar masa për përmirësimin e gjendjes.⁸⁶ Në këtë drejtim konstatohen mangësi, veçanërisht në dokumentimin e takimeve dhe komunikimeve dypalëshe për trajtimin e problematikave. Komunikimi ka qenë kryesisht në formë verbale dhe grupit nuk i janë vendosur në dispozicion dokumente shkresore apo protokolle të mbledhjeve në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu, nuk janë ngritur grupe të përbashkëta pune apo hartuar plane të përbashkëta veprimi për zbatimin e marrëveshjes dhe rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes. Në këtë situatë duket sikur këto dy institucione punojnë të veçuara dhe veprojnë vetëm për të realizuar detyrat që marrëveshja i ka ngarkuar secilit, ndërsa qasja e ndjekur në komunikim, bashkëveprim dhe iniciativën për të kontribuar aktivisht në përmirësimin e zbatimit të marrëveshjes është më shumë reaktive se sa proaktive.

Sipas marrëveshjes së përbashkët, Policia e Shtetit ka të drejtë të shfrytëzojë të dhënat e sistemit elektronik të DPB-së, në momentin që ky i fundit do të vihej në përdorim.⁸⁷ Në lidhje me këtë, në rastet kur e ka gjykuar të nevojshme, policia ka shfrytëzuar të dhëna të nxjerra nga sistemi elektronik i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat i janë vënë në dispozicion nga ana e personelit të kësaj drejtorie. Kjo mund të konsiderohet një praktikë e mirë në drejtim të zbatimit të marrëveshjes së përbashkët.

Gjetje:

20. Në lidhje me bashkëveprimin e institucioneve në garantimin e të drejtave të personave të paraburgosur janë konstatuar disa mangësi:

- Disa të paraburgosur në pritje të transferimit të tyre në një IEVP janë mbajtur në ambientet e dhomave të sigurisë në DVP për periudha të zgjatura, të cilat shkojnë nga 3-5 ditë pas marrjes së masës së sigurimit të dhënë nga gjykata,

⁸³ Neni 4/4 i Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019;

⁸⁴ Statusi i të dënuarit/paraburgosurit përcaktohet në ligjin 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;

⁸⁵ Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019, neni 6/4 pika i;

⁸⁶ Marrëveshja e Bashkëpunimit, neni 6/6;

⁸⁷ Marrëveshja e Bashkëpunimit, neni 6/3.

- Ka raste të vonësive në transferime si rezultat i mospranimit nga IEVP-të të personave me masën e sigurisë “arrest me burg”, me argumentin se ka mbipopullim dhe mungesë të ambienteve për akomodim, si dhe për shkak të mangësive në dokumentacionin shoqëruar të përgatitur nga ana e Policisë, identifikimit me gjurmët daktiloskopike dhe fotove bashkëlidhur, mos plotësimi në kohë i dokumentacionit të gjendjes së pacientit nga ana e personelit mjekësor, etj.

21. Në drejtim të bashkëveprimit ndërinstytucional me qëllim analizimin e zbatimit të marrëveshjes konstatohen mangësi, veçanërisht në dokumentimin e takimeve dhe komunikimeve dypalëshe për trajtimin e problematikave. Gjithashtu, nuk janë ngritur grupe të përbashkëta pune apo hartuar plane të përbashkëta veprimi për zbatimin e marrëveshjes dhe rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes. Ndërkohë, marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nuk është përditësuar që nga marsi 2019 kur është nënshkruar.

Konkluzione:

- Vonesat në transferimin e personave me masën e sigurisë “*arrest me burg*” vijnë si pasojë e neglizhencës në veprime të hallkave të ndryshme të sistemit, por edhe për shkak të kushteve të vështira infrastrukturore dhe mangësive në kapacitete. Tejkalimi i afateve të mbajtjes së të paraburgosurve në ambientet e policisë ka sjellë si pasojë mos respektimin e të drejtave të këtyre personave, mbipopullim të ambienteve të dhomave të sigurisë, si dhe mos përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në aktet rregullatorë.
- Bashkëpunimi ndërinstytucional është i domosdoshëm për funksionimin e të gjithë sistemit, drejt arritjes së qëllimit të përbashkët, zbatimin e ligjit, ndarjes reciproke të burimeve dhe ideve, koordinimit dhe parandalimit të ngërceve të mundshme ndërmjet aktorëve të sistemit, parashikimit të rregullave e protokolle për përmirësimin e zbatimit të marrëveshjeve dhe iniciativës proaktive për të përmirësuar situatën. Në drejtim të bashkëveprimit dhe komunikimit ndërinstytucional duket sikur këto dy institucione punojnë të veçuara dhe veprojnë vetëm për të realizuar detyrat që marrëveshja i ka ngarkuar secilit, apo të shtyra nga rrethanat dhe faktorët e jashtëm më shumë se sa nga vullneti i palëve për të përmirësuar situatën.

Rekomandim nr. 19:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtoritë Vendore të Policisë, të evitojnë mbajtjen e personave të paraburgosur pranë ambienteve të policisë përtej afateve të përcaktuara, si dhe plotësojnë në kohë sipas kërkesave, dokumentacionin për dërgimin e personave të paraburgosur në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandim nr. 20:

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrin masa për rishikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërinstytucional si dhe të mblidhet të dy herë në vit për të analizuar implementimin e marrëveshjes dhe problematikat që hasen në zbatimin e saj.

Brenda Marsit 2023 dhe në vijimësi

5. PËRMBLEDHJA

Auditimi me temë “Performanca e Shërbimit të Paraburgimit” kishte si objektiv kryesor vlerësimin e politikave dhe efektivitetin e tyre në funksion të mbrojtjes dhe garantimit të shërbimeve ndaj personave të paraburgosur, duke u fokusuar kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë në realizimin e objektivave të tyre institucionale. Sa kaq, grupi i auditimit gjatë fazës së terrenit vlerësoj:

- Efektivitetin e MD dhe DPB në hartimin dhe implementimin e politikave të hartuara për të siguruar kushte të përshtatshme për personat e paraburgosur, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Burimet financiare të alokuara në sistemin e paraburgimit me qëllim kryerjen e investimeve, si dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme për personat e paraburgosur nga DPB dhe IEVP-të respektive që ofrojnë shërbim paraburgimi;
- Bashkëveprimin ndërinstitucional ndërmjet DPB/IEVP me DPP/DVP-të në funksion të garantimit të të drejtave për personat e paraburgosur.

Me qëllim realizimin e objektivave të këtij projekti auditues, grupi i auditimit zhvilloj intervista dhe vizita në terren në të gjitha IEVP-të të cilat ofrojnë shërbim paraburgimi, duke u futur në regjimet e sektorëve të paraburgimit në IEVP me qëllim konstatimin nga afër të kushteve infrastrukturore dhe shërbimeve që ofrohen kah personave të paraburgosur. Pas analizimit të të dhënave të disponuara nga subjektet nën auditim, vizitave dhe intervistave të zhvilluara si me strukturat përgjegjëse ashtu edhe me të paraburgosurit, grupi i auditimit konstaton se:

Në lidhje me vlerësimin e efektivitetit të MD dhe DPB në hartimin dhe implementimin e politikave të hartuara për të siguruar kushte të përshtatshme për personat e paraburgosur, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në IEVP Lezhë (Shënkoll) janë të akomoduar 369 pacientë, për të cilët gjykata ka vendosur masën “mjekim i detyruar”.⁸⁸ Këta individ ndodhen të akomoduar në dy godina, përkatësisht në godinën 4 dhe 5, në kushte të papërshtatshme për pacientë me çrregullime mendore që kanë nevojë për trajtim të specializuar. Stafi mjekësor në dispozicion të tyre përbëhet vetëm nga dy mjekë dhe trajtimi i tyre nuk është i diferencuar nga të burgosurit e tjerë, duke marrë në konsideratë statusin dhe nevojat e tyre. Trajtimi jo i përshtatshëm i këtij target grupi, jo vetëm që bie ndesh me standardet ndërkombëtare dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, por ndikon negativisht në përkeqësimin e shëndetit mendor të këtyre individëve dhe mirëqenien e tyre.

Sa i përket mbrojtjes së të miturve, Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk harton një listë të posaçme të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur dhe përfaqësimin e tyre. Nëpërmjet Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, Ministria e Drejtësisë të kërkoj nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë lista të veçanta për përfaqësimin e të miturve.

DPB ende nuk ka konkluduar hartimin dhe miratimin e skemës dhe standardeve për mbikëqyrjen e rregullt psikologjike për të gjithë stafin dhe vlerësimin e performancës për IEVP-të. Mungesa e përcaktimit të standardeve për mbikëqyrje të rregullt psikologjike të stafit të angazhuar në IEVP, si dhe mungesa e hartimit të metodologjisë për vlerësimin e performancës së IEVP-ve, ndikon negativisht në qasjen për zhvillim të sistemit penitenciar bazuar në standardet europiane. Këto janë dy mekanizma esencial për vlerësimin real të IEVP-ve, me qëllim garantimin e të drejtave personave të paraburgosur dhe të dënuar.

Takimet e zgjatura nuk zbatohen për personat e paraburgosur. Referuar Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, këto takime ju mundësohen vetëm personave “të dënuar”.

Pavarësisht se ligji nr. 81/2020 i barazon në të drejta personat “e dënuar” dhe “të paraburgosur”, Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, në kundërshtim me ligjin, i njeh të drejtën për takime të

⁸⁸ Shumica e këtyre pacientëve ishin transferuar pas mbylljes së IEVP Krujë (Zahari);

zgjatura vetëm personave të dënuar në mënyrë eksplicite. Zbatimi i këtij përcaktimi ligjor të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, u mohon një të drejtë esenciale personave të paraburgosur, në kuadër të ruajtjes së lidhjeve me familjen.

DPB të marrë masa për amendimin e nenit 40 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve në përputhje me ligjin nr. 81/2020. E drejta për takime të zgjatura ti mundësohet çdo personi të legjitimuar për përfitimin e kësaj të drejte, pavarësisht faktit nëse është “i dënuar” apo “i paraburgosur”.

Në lidhje me vlerësimin e burimeve financiare të alokuara në sistemin e paraburgimit me qëllim kryerjen e investimeve, si dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme për personat e paraburgosur nga DPB dhe IEVP-të respektive që ofrojnë shërbim paraburgimi.

Buxheti faktik i total sistemit të burgjeve ka pësuar ulje në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, ndërsa është rritur me 8% në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. Pesha e buxhetit të sektorit të paraburgimeve në total sistemin e burgjeve ishte 36% në vitin 2019, e cila është ndjekur nga një rritje graduale gjatë periudhës nën auditim, për të arritur 42% në vitin 2021. Peshën kryesore në këtë përqindje e zënë shpenzimet e personelit dhe ato operative, pasi për periudhën në auditim, pesha që zënë investimet për sektorin e paraburgimit në totalin e investimeve në sistemin e burgjeve është thuajse 0.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i të dhënave të disponuara nga subjektet nën auditim, grupi i auditimit ka konstatuar se për periudhën objekt auditimi ka munguar analiza dhe shpërndarja në mënyrë proporcionale e të paraburgosurve në IEVP, sipas kapaciteteve dhe infrastrukturës së ngritur.

Gjatë periudhës objekt auditimi, numri i të paraburgosurve ka pësuar rritje, ku në vitin 2021 kanë qenë 19% të paraburgosur më shumë se në vitin 2020. Nga vizitat e zhvilluara në sektorët e paraburgimit në IEVP u konstatuan mbipopullime, duke akomoduar në IEVP më shumë shtetas sesa institucionet kanë kapacitet. Në kushtet kur, neni 33 pika 1 e ligjit 81/2020 përcakton se: “*Mjediset që u ofrohen të burgosurve dhe në veçanti mjediset e fjetjes respektojnë dinjitetin njerëzor dhe, sa më shumë të jetë e mundur, privatësinë, si dhe plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës, hapësirës së nevojshme, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit*”.

Gjithashtu, nga intervistat e kryera e dokumentacioni i shqyrtuar u konstatuan vakanca të stafit mjekësor në disa IEVP apo angazhimi i tyre në disa raste të tjera me kohë të pjesshme (mjek/ ndihmës mjek/ stomatolog). Ndëkohëqë, shërbimi shëndetësor e farmaciutik duhet të jetë i tillë që t’ju përgjigjet nevojave për parandalimin e sëmundjeve dhe ruajtjen e shëndetit të personave të paraburgosur, duke bërë të mundur që personi i paraburgosur ti nënshtrohet të njëjtit trajtim dhe kujdes shëndetësor që zbatohet për shoqërinë në përgjithësi, gjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucionet e paraburgimit.

Disa IEVP nuk ofrojnë programe të arsimit të përgjithshëm apo kurse të formimit profesional, duke cenuar kështu të drejtat që gëzojnë personat e paraburgosur.

Për shkak të mungesës së ambienteve, disa IEVP, si Burrel dhe Tepelenë nuk ofrojnë dhomë prindërimi në distancë dhe as bibliotekë, me botime bashkëkohore dhe periodike. Madje, edhe në IEVP-të në të cilat kanë ambiente bibliotekë, nuk ka një përzgjedhje dhe përditësim të librave që i ofrohen për lexim personave të paraburgosur.

Mungesa e plotësimit të kushteve higjeno-sanitare dhe prezenca e lagështirës kudo, në ambientet e banimit si dhe në ambientet e përbashkëta, në kushte emergjente për tu riparuar. Amortizimi i rrjeteve elektrike, mungesa e sistemeve të ngrohjes, ventilimi si dhe ndriçimi i pamjaftueshëm me dritë natyrale në disa institucione paraburgimi ishin disa problematika të tjera shqetësuese, të cilat cenojnë të drejtat që gëzojnë personat e paraburgosur gjatë qëndrimit në këto institucione.

Mungesa e dusheve dhe ujit të ngrohtë është një tjetër problematikë e identifikuar në institucionet e paraburgimit (IEVP Fushë Krujë; Burrel; etj.), që bie ndesh me përcaktimin e nenit 35 pika 2 të ligjit 81/2020 në të cilin përcaktohet se: “Çdo institucion siguron ujë të ngrohtë për higjienën vetjake...”.

Problematikë tjetër e konstatuar është gjithashtu edhe mungesa e ambienteve të dedikuara për tharjen e rrobave. Shpeshherë rrobat thaheshin brenda ambienteve të banimit, nëpërmjet varjes së tyre në kordonë apo litarë, fakt ky i cili përbën premise dhe rrezik për jetën, kryesisht të personave që vuajnë nga problem të shëndetit mendor dhe njëkohësisht edhe për sigurinë e të paraburgosurve të tjerë.

Në lidhje me vlerësimin e bashkëveprimit ndërinstitutional ndërmjet DPB/IEVP me DPP/DVP-të, në funksion të garantimit të të drejtave për personat e paraburgosur.

Bashkëpunimi dhe koordinimi institucional ndërmjet strukturave të policisë dhe institucioneve të vuajtjes së dënimit rregullohet me marrëveshje të përbashkët të miratuar nga të dyja palët. Konkretisht, marrëveshja aktuale ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2019.

Problemet lidhen e konstatuara kryesisht, janë:

- Mbajtja në ambientet e dhomave të sigurisë pranë DVP-ve për periudha të zgjatura, në tejkalim të afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Konkretisht, edhe gjatë vitit 2022 janë evidentuar raste të mos transferimit në kohë pranë IEVP-ve të personave të arrestuar/ndaluar që trajtohen në ambientet e Policisë së Shtetit, ndaj të cilëve gjykata ka vendosur masën e sigurisë “arrest në burg”, vonesa të cilat shkojnë deri në 3-5 ditë pas marrjes së masës së sigurimit të dhënë nga gjykata.
- Vonesat në transferime vijnë si rezultat i mospranimit nga IEVP-të të personave me masën e sigurisë “arrest në burg”, me argumentin se ka mbipopullim dhe mungesë të ambienteve për akomodim në IEVP, por edhe për shkak të mangësive në dokumentacionin shoqërues të përgatitur nga ana e Policisë.
- Në drejtim të bashkëveprimit ndërinstitutional me qëllim analizimin e zbatimit të marrëveshjes konstatohen mangësi, veçanërisht në dokumentimin e takimeve dhe komunikimeve dypalëshe për trajtimin e problematikave. Komunikimi ka qenë kryesisht në formë verbale dhe grupit nuk i janë vendosur në dispozicion dokumente shkresore në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu, nuk janë ngritur grupe të përbashkëta pune apo hartuar plane të përbashkëta veprimi për zbatimin e marrëveshjes dhe rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes.

Në drejtim të bashkëveprimit dhe komunikimit ndërinstitutional duket sikur DPB/IEVP-të dhe DPP/DVP-të punojnë të veçuara dhe veprojnë vetëm për të realizuar detyrat që marrëveshja i ka ngarkuar secilit. Qasja e ndjekur në komunikim, bashkëveprim dhe iniciativën për të kontribuar aktivisht në përmirësimin e zbatimit të marrëveshjes është më shumë reaktive se sa proaktive, pra më shumë e shtyrë nga rrethanat dhe faktorët e jashtëm se sa nga vullneti i palëve për të përmirësuar situatën.

6. SHTOJCAT


Shtojca nr. 1

Infografik nr. 1: Procedime penale të regjistruara ndër vite

Vepra penale	2017	2018	2019	2020	2021
Vrasje me dashje	120	126	137	128	117
Vrasje të mbetura në tentativë	43	52	28	35	48
Krime me dashje kundër shëndetit	862	908	903	861	823
Krime seksuale	102	113	158	136	158
Vjedhje (neni 134)	9.514	9.219	8.682	7.812	7.010
Vjedhja me dhunë	187	118	117	123	112
Vjedhja me armë	22	35	15	15	11
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	127	114	85	68	78
Mashtrime	1.060	872	745	627	752
Falsifikim monedhash	78	80	82	75	62
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.310	1.209	1.140	1.251	1.406
Krime në fushën e drogës	1.764	1.524	1.548	1.793	2.069
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	3.639	4.121	4.038	3.911	4.374
Tjetër	12.634	12.898	13.017	11.017	11.329
Gjithsej	31.462	31.389	30.695	27.852	28.349

Burim: INSTAT

Infografik nr. 3: Progresi i procedimeve penale 2019-2021



Burim: INSTAT/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Tabela nr. 1: Sasia e ushqimit të pa konsumuar në secilën IEVP, bazuar në përgjigjet e subjektit gjatë intervistës për konfirmimin e të dhënave zyrtare

IEVP-të që ofrojnë shërbim paraburgimi	Sasia e mbetur e ushqimit
1. IEVP Kukës	0 - 5%
2. IEVP Shkodër	30 - 35%
3. IEVP Burrel	5 - 10%
4. IEVP Fier	15 - 30%
5. IEVP Elbasan	15 - 20%
6. IEVP Tepelenë	20%
7. IEVP Fushë-Krujë	0 - 5%
8. IEVP Berat	10 - 20%
9. IEVP Korçë	0 %
10. IEVP Peqin	5 - 20%
11. IEVP Vlorë	20 - 30%
12. IEVP Durrës	15 - 20 %
13. IEVP Lezhë	20 - 30 %
14. IM Kavajë	0%
15. IEVP “Ali Demi”	15%
16. IEVP “Jordan Misja”	30 - 35%
17. IEVP “Mine Peza”	10 – 15%

Shtojca nr. 2

Tabela nr. 1 me të dhënat mbi rialokimet e Buxhetit 2019-2022

	Buxheti 01.01.2019	Shtesa	Pikësime	Buxheti Rishikuar 2019
Shpenzime Personeli	3,881,600,000	137,000,000	67,532,000	3,951,068,000
Shpenzime Operative	1,433,574,000	115,399,128	70,022,128	1,478,951,000
Shpenzime Kapitale	431,000,000	94,540,600	97,540,600	428,000,000
Viti 2020				
	Buxheti 01.01.2020	Shtesa	Pakesime	Buxheti Rishikuar 2020
Lloji i shpenzimit				
Shpenzime Personeli	3,983,342,000	39,356,000	41,553,200	3,981,144,800
Shpenzime Operative	1,313,574,000	131,438,477	125,438,477	1,319,574,000
Shpenzime Kapitale	340,374,000	71,393,000	91,393,000	320,374,000
Viti 2021				
	Buxheti 01.01.2021	Shtesa	Pakesime	Buxheti Rishikuar 2021
Lloji i shpenzimit				
Shpenzime Personeli	4,162,000,000	478,160,000	177,160,000	4,463,000,000
Shpenzime Operative	1,193,000,000	62,070,145	85,870,145	1,169,200,000
Shpenzime Kapitale	400,900,000	28,400,000	31,748,000	397,552,000
Korrik 2022				

Lloji i shpenzimit	Buxheti 01.01.2022	Shtesa	Pakesime	Buxheti Rishikuar Korrik 2022
Shpenzime Personeli	4,489,000,000	3,800,000	116,025,000	4,376,775,000
Shpenzime Operative	1,267,000,000	981,418	107,681,418	1,160,300,000
Shpenzime Kapitale	427,900,000	79,750,000	188,369,000	319,281,000

Burimi: Grupi i auditimit

Tabela nr. 2: Të dhëna mbi IEVP-të që trajtojnë të paraburgosur në Shqipëri

Nr.	2019				2020			2021			Korrik 2022		
	IEVP	Të dënuar	Të Paraburg	Totali	Të dënuar	Të Paraburg	Totali	Të dënuar	Të Paraburg	Totali	Të dënuar	Të Paraburg	Totali
1.	Durrës	87	210	297	73	189	262	79	186	265	65	207	272
2.	Peqin	306	144	450	298	116	414	317	113	430	320	193	513
3.	Lezhe		108	108	0	127	127	5	150	155	6	132	138
4.	Tepelene	21	64	85	22	78	100	3	117	120	1	106	107
5.	Burrel	103	67	170	85	70	155	74	68	142	93	82	175
6.	Kukës		23	23	0	40	40	0	30	30		33	33
7.	Korçë	257	130	387	228	252	480	207	243	450	213	196	409
8.	A. Demi	55	31	86	28	29	57	29	34	63	29	41	70
9.	Vlore	17	125	142	25	140	165	0	176	176	-	148	148
10.	Berat	38	74	112	31	95	126	34	105	139	24	86	110
11.	M. Peza	1	164	165	1	159	160	0	149	149	-	163	163
12.	J. Misja	5	456	461	7	382	389	11	434	445		435	435
13.	F. Kruje	234	145	379	200	173	373	67	308	375	71	288	359
14.	Kavaje	4	19	23	1	20	21	1	18	19	3	12	15
15.	Elbasan		147	147	0	151	151	0	171	171	0	162	162
16.	Fier	620	170	790	531	160	691	548	264	812	579	243	822
17.	Shkodër	508	137	645	367	121	488	316	173	489	369	232	601

Burimi: Grupi i auditimit

KONTROLI I LARTË I SHTETIT